

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë**  
**Departamenti i të drejtave të njeriut dhe sundimit të së drejtës**  
**Seksioni për monitorim të sistemit juridik**

**KOSOVË**  
**SHQYRTIM I SISTEMIT TË DREJTËSISË PENALE**  
**(PRILL 2003-TETOR 2004)**

**KRIMI, PARABURGIMI DHE DËNIMI**

**FJALORTH.....4**

**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....6**

**SFONDI .....7**

I.	MANDATI I SEKSIONIT PËR MONITORIM TË SISTEMIT JURIDIK.....	7
II.	MONITORIMI I SISTEMIT TË DREJTËSISË.....	8
III.	SHTRIRJA E KËTIJ SHQYRTIMI.....	8

**NJË PËRMBLEDHJE E SHKURTËR HISTORIKE E SISTEMIT GJYQËSOR  
NË KOSOVË.....10**

I.	HYRJE.....	10
II.	RITHEMELIMI I SISTEMIT GJYQËSOR.....	10
III.	FUTJA NË PËRDORIM E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NDËRKOMBËTAR ...	11
IV.	PAKICAT DHE GJYKATAT.....	12
V.	REFORMA E LEGJISLACIONIT PENAL.....	13
VI.	SISTEMI JURIDIK SOT.....	13

**PARABURGIMI.....15**

I.	HYRJE.....	15
II.	ARSYETIMI I PAMJAFTUESHËM I VENDIMEVE FILLESTARE PËR PARABURGIM	17
III.	ÇËSHTJET QË KANË TË BËJNË ME ZGJATJËN E PARABURGIMIT.....	19
IV.	ÇËSHTJET E KUNDËRSHTIMIT TË AKTVENDIMIT PËR PARABURGIM.....	25
V.	ÇËSHTJET LIDHUR ME KOHËZGJATJËN E PARABURGIMIT.....	32
VI.	REKOMANDIMET.....	34

**DËNIMI PENAL.....36**

I.	HYRJE.....	36
II.	STANDARDET NDËRKOMBËTARE DHE HEQJA E LIRISË.....	37
III.	BURGJET NË KOSOVË.....	38
IV.	SHQIPTIMI I DËNIMEVE.....	39
V.	PRAKTIKA E SHQIPTIMIT TË DËNIMEVE.....	40
VI.	LLOJET E DËNIMEVE.....	49
VII.	SHFRYTËZIMI I FORMAVE TË NDRYSHME TË DËNIMIT.....	52
VIII.	DËNIMI I TË MITURVE DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT.....	56

IX.	MASAT NË FUQI KUNDËR KRYESVE TË MITUR .....	57
X.	ZBATIMI I SANKSIONEVE DHE DËNIMEVE KUNDËR TË MITURVE .....	60
XI.	REKOMANDIMET .....	67

## **RASTET QË NDËRLIDHEN ME NGJARJET E MARSIT 2004 .....** **69**

I.	HYRJE .....	69
II.	LLOJET E RASTEVE .....	69
III.	PËRGJIGJA E POLICISË .....	69
IV.	PËRGJIGJA E GJYQËSISË .....	70

## **E DREJTA PËR MBROJTJE EFEKTIVE .....** **73**

I.	HYRJE .....	73
II.	E DREJTA PËR MBROJTJE EFEKTIVE NË PRAKTIKË .....	73
III.	REKOMANDIME .....	78

## **MBROJTJA E DËSHMITARËVE NË SISTEMIN E DREJTËSISË PENALE..** **79**

I.	HYRJE .....	79
II.	SISTEMI I MBROJTJES SË DËSHMITARËVE .....	79
III.	INCIDENTET E FRIKËSIMIT .....	79
IV.	TË METAT E SISTEMIT PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE .....	81
V.	ZHVILLIMET POZITIVE QË NGA SHQYRTIMI I PESTË .....	81
VI.	REKOMANDIMET .....	82

## **ZHVILLIMET E RËNDËSISHME NË SISTEMIN JURIDIK .....** **84**

I.	DISPOZITAT LIGJORE .....	84
II.	RREGULLORET .....	84
III.	URDHËRESAT ADMINISTRATIVE .....	85
IV.	LIGJET E KUVENDIT TË KOSOVËS .....	85

## FJALORTH

DAD	Departamenti administrativ i drejtësisë
DAGj	Departamenti i administratës gjyqësore
DD	Departamenti i drejtësisë
CPT(orig)	Komisioni evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimin ose ndëshkimin jonjerëzor dhe degradues
CRC(orig)	Konventa për të drejtat e fëmijës
ECHR(orig)	Konventa evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
LP i RFJ	Ligji penal i Republikës Federale të Jugosllavisë
LPP i RFJ	Ligji i procedurës penale të Republikës Federale të Jugosllavisë
ICCPR(orig)	Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike
KPK	Këshilli i përbashkët këshillëdhënës për emërimet e përkohshme gjyqësore
SIGj	Seksion për integrim gjyqësor
LPMK	Ligji penal për të mitur i Kosovës
KFOR(orig)	Forca e Kosovës
IGjK	Instituti gjyqësor i Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
QJK	Qendra juridike e Kosovës
LPK	Ligji penal i Kosovës
SHPK	Shërbimi i policor i Kosovës
LSMJ	Seksioni për monitorim të sistemit juridik
NATO(orig)	Aleanca veriatlantke
OMiK(orig)	Misioni i OSBE-së në Kosovë
OSBE	Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë

KPPK	Kodi i përkohshëm penal i Kosovës
KPPPK	Kodi i përkohshëm i procedurës penale i Kosovës
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
DUDNj	Deklarata universale për të drejtat e njeriut
KB	Kombet e Bashkuara
UNHCR(orig)	Komisionieri i lartë për refugjatë i Kombeve të Bashkuara
UNMIK(orig)	Misioni i administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
NjMD	Njësiti për mbrojtjen e dëshmitarëve

## KREU 1

### PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Sistemi i drejtësisë penale në Kosovë ka kaluar një rrugë të gjatë që nga ri-themelimi i tij në vitin 1999. Përpjekjet nga ana e akterëve vendor dhe ndërkombëtar, duke përfshirë këtu edhe futjen në fuqi të kodit të ri penal dhe atë të procedurës penale e kanë transformuar atë në një sistem funksional. Megjithatë, ka mbetur shumë punë për tu kryer.

Shqyrtimi aktual analizon një mori çështjesh problematike lidhur me paraburgimin dhe dënimin, që duket të jenë sistematike brenda sistemit juridik. Praktika e gjykatave lidhur me paraburgim dhe dënim por edhe mangësitë institucionale mund të qojnë deri tek shkeljet e të së drejtës për liri dhe siguri të personit dhe të drejtës për gjykim korrekt. Këto praktika mung të shërbejnë keqsisimit të problemit të stërngarkimit të burgjeve.

OSBE-ja ka vërejtur se, shumë shpesh vendimet mbi paraburgime janë të arsyetuara në mënyrë të gabuar dhe nuk e marrin parasysh aplikimin e masave alternative. Duket sikur në shumë raste personave të pandehur u është hequr liria përmes vendimeve të arsyetuara në mënyrë joadekuate, të cilat jo vetëm që vështirësojnë të drejtën për ankesë por gjithashtu e pengojnë shqyrtimin publik të administratës gjyqësore. Shpesh, autoritetet dhe agjencitë kompetente që marrin pjesë në procedurë penale kundër personave të paraburgosur nuk veprojnë me zell të duhur të veçantë, duke shkaktuar në këtë mënyrë zgjatje të paarsyeshme të paraburgimit.

Të meta të konsiderueshme janë vërejtur gjithashtu në lidhje me dënimet: në veçanti, aktgjyqimeve u mungon arsyetimi i duhur; gjykatat jashtë mase e përdorin masën e paraburgimit duke mos i konsideruar masat alternative; ka edhe mungesë të kapacitetit institucional në aplikimin e masave alternative. Mungesa e kapacitetit institucional është veçanërisht prezente në fushën e sanksionimit kundër delikuentëve të mitur.

Përqendrimi publik në sistemin e drejtësisë penale në Kosovë ka shënuar rritje pas trazirave të 17-19 Marsit, të cilat kanë vënë në pah brishtësinë e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë dhe kanë vënë në test gatshmërinë dhe efikasitetin e autoriteteve kompetente të përgjigjen kundrejt dhunës së përgjithshme me motiv etnik. Pas trazirave, OSBE-ja ka vëzhguar për së afërmi përgjegjen e autoriteteve kompetente lidhur me veprat penale. Deri më sot, një ndër fushat kryesore të shqetësimeve lidhet me sigurimin e dëshmive të dëshmitarëve.

Shqyrtimi aktual më tutje shiqon përbrenda dy çështjeve ripërsëritëse të cilat kanë qenë të adresuara edhe në shqyrtimet e mëparshme. OSBE-ja vazhdon të vërej veprime shqetësuse të mbrojtësve të cilët vazhdimisht dështojnë të veprojnë në të mirën e klientëve të tyre dhe t'i përfaqësojnë ata në mënyrë efektive. Kapitulli i fundit flet për situatën aktuale në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve brenda sistemit juridik dhe nënvizon përmirësimet të cilat kanë ndodhur që nga shqyrtimi i fundit i sistemit të drejtësisë penale.

Pas identifikimit të çështjeve problematike, OSBE-ja shpalos një numër rekomandimesh në secilin kapitull me qëllim të evitimit të të metave të përmendura. Autoritetet relevante inkurajohen të implementojnë këto rekomandime dhe të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm në rregullimin e defekteve të nënvizuara.

## KREU 2

### SFONDI

Ky raport është përgatitur nga Seksioni për monitorim të sistemit juridik (SMSJ), i cili është pjesë përbërëse e Departamentit për të drejtat e njeriut dhe sundimin e së drejtës, në kuadër të Misionit të OSBE-së në Kosovë (më tutje në tekst OMiK). OSBE-ja funksionon nën ombrellën e Administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), në rolin e Shtyllës për ndërtimin e institucioneve.

Kjo pjesë ka për qëllim të ofrojë një historik të shkurtë lidhur me raportin dhe të paraqesë kontekstin institucional të SMSJ-së dhe Departamentit.

#### I. MANDATI I SEKSIONIT PËR MONITORIM TË SISTEMIT JURIDIK

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 e autorizon sekretarin e përgjithshëm të KB, të themelojë praninë ndërkombëtare në Kosovë e cila do të siguronte një administratë të përkohshme. Njëra nga përgjegjësitë kryesore të pranisë ndërkombëtare është *“mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut”*<sup>1</sup>.

Sekretari i përgjithshëm i KB, në raportin e tij të paraqitur para Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, më 12 qershor 1999, ia caktoi OSBE-së rolin udhëheqës për ndërtimin e institucioneve në kuadër të UNMIK-ut, duke bërë me dije se, njëra nga detyrat e shtyllës për ndërtimin e institucioneve, duhet të përfshijë monitorimin e të drejtave të njeriut dhe ndërtimin e kapaciteteve. Ai gjithashtu e udhëzoi OSBE-në të zhvillojë mekanizma të koordinuar mirë me qëllim të lehtësimit të monitorimit të të drejtave të njeriut dhe funksionimin e duhur të sistemit gjyqësor:

“UNMIK-u do të ketë grupin e monitoruesve dhe këshilltarëve për të drejtat e njeriut të cilët do të kenë qasje të papenguar në të gjitha pjesët e Kosovës, për të bërë hetimet lidhur me cenimet e të drejtave të njeriut dhe për të siguruar se çështjet e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut, janë adresuar përmes aktiviteteve të gjithëmbarshme të misionit. Monitoruesit e të drejtave të njeriut, përmes zëvendës Përfaqësuesit Special për ndërtimin e institucioneve, ia konstatimet Përfaqësuesit Special. Konstatimet e monitoruesve të të drejtave të njeriut do të bëhen rregullisht publike dhe shkëmbehen, sipas nevojës, me mekanizmat e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, në konsultim me Zyrën e komisionerit të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut. UNMIK-u do të sigurojë raportim të bashkërenditur dhe aftësi të përgjigjes.”<sup>2</sup>

Në Letrën e marrëveshjes, të datës 19 korrik 1999, në mes të nën-Sekretarit të Përgjithshëm për operacione paqëruajtëse të Kombeve të Bashkuara dhe përfaqësuesit të Kryesuesit të Radhës së OSBE-së, thuhet se OSBE duhet të zhvillojë mekanizma për të siguruar se, gjykatat, tribunalet administrative dhe strukturat tjera gjyqësore, të veprojnë në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtën penale dhe të drejta të njeriut<sup>3</sup>. Në kuadër të OSBE-së, ky

<sup>1</sup> Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 12 qershor 1999, para. 11/j.

<sup>2</sup> Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të KB pranë Këshillit të Sigurisë, *për Administratën e përkohshme të KB në Kosovë*, S/1999/779, 12 korrik 1999, para. 87.

<sup>3</sup> Qarkorja e drejtësisë 2001/15 Qasja e monitoruesve të OSBE-së në proceset gjyqësore dhe dokumentacionin gjyqësor, 6 qershor 2001, e riafirmuar faktin se monitoruesit gjyqësor të SMSJ-së kanë qasje në të gjitha proceset penale si dhe dokumentacionin përkatës me disa përjashtime. Kjo është ndryshuar me qarkoren e drejtësisë nr. 2004/6, 30 shtator 2004, e cila e ka vërtetuar se SMSJ ka qasje edhe në proceset civile dhe administrative si dhe dokumentacionin gjegjës gjyqësor në pajtim me marrëveshjen në mes të Shtyllës së UNMIK-ut për polici dhe drejtësi dhe OSBE-së. Kjo qarkore kishte

departament e ka përgjegjësinë për monitorimin dhe raportimin për sistemin gjyqësor nga aspekti i të drejtave të njeriut dhe sundimit të së drejtës. Si seksion në kaudër të departamentit, LSMJ-së i është dhënë detyra e monitorimit të lëndëve në sistemin gjyqësor, vlerësimit të përshtatshmërisë së tyre me standardet ndërkombëtare dhe raportimin e çështjeve shqetësuese.

## **II. MONITORIMI I SISTEMIT TË DREJTËSISË**

Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut<sup>4</sup> janë pjesë e ligjit në fuqi në Kosovë përmes, në mes tjerash, Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 – e cila i obligon bartësit e funksioneve publike në Kosovë që t'i respektojnë standardet e pranuar ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut – por edhe përmes Kornizës Kushtetuese.<sup>5</sup> Së këndejmi, gjatë vlerësimit të përshtatshmërisë me standardet ndërkombëtare, OSBE-ja i shfrytëzon si bazë konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe interpretimet juridike të tyre.

Ky shqyrtim flet vetëm për sistemin e drejtësisë penale. Rastet penale janë përcjellur që nga momenti i arrestimit dhe/ose ndalimit deri te faza e hetimeve, gjykimit dhe ankesës. Analizat dhe shqyrtimet bëra në këtë dokument janë bazuar në të dhënat dhe informatat faktike të mbledhura gjatë periudhës raportuese të LSMJ. Monitoruesit e gjykimeve kryesisht i kanë mbuluar lëndët penale nëpër pesë gjykatat e qarkut të Kosovës, dhe ato raste të shqyrtuara sipas ankesës pranë Gjykatës Supreme të Kosovës (më tutje në tekst “Gjykata Supreme”). Gjithashtu janë përcjellur edhe disa lëndë pranë gjykatave komunale.

Informacionet janë mbledhur duke marrë pjesë në procedurë gjyqësore, duke shiqur dosjet e lëndëve gjyqësore dhe duke zhvilluar intervista me gjyqtarë, zyrtarë gjyqësor, prokurorë, avokatë mbrojtës dhe zyrtarë për zbatimin e ligjit. Gjatë kësaj periudhe raportuese, monitoruesit gjyqësor i kanë përcjellur mbi 400 lëndë, përfshirë dhe gjatë fazave paraprake të hetimeve dhe gjyqësore. SMSJ i ka dhënë prioritet të lartë lëndëve për:

- Krimet e luftës;
- Krimin e organizuar;
- Krimet me motive etnike, përfshirë edhe rastet e trazirave;
- Dhunën gjinore përfshirë viktimat e dhunës familjare dhe rastet e trafikimit;
- Paraburgimin;
- Trajtimin e të miturve.

## **III. SHTRIRJA E KËTLJ SHQYRTIMI**

Në dy shqyrtimet e para të sistemit të drejtësisë penale,<sup>6</sup> OSBE e ka paraqitur një pasqyrë të përgjithshme të sistemit të drejtësisë nga perspektiva e ligjit për të drejtat e njeriut. Shqetësimet e shprehura në ato shqyrtime i referoheshin rasteve specifike në të cilat, aktivitetet e gjyqësorisë, prokurorisë, administratorëve të tyre dhe organeve për zbatim të ligjit kanë dështuar t’ju përshtaten standardevë dhe garancioneve për gjykim të drejtë dhe proces të

---

për qëllim fuqizimin e të kuptuarit për gjyqësinë në lidhje me mandatin e OSBE-së dhe të sigurojë se monitoruesit gjyqësor mund t’i mbulojnë rastet në të gjitha proceset penale apo civile dhe administrative.

<sup>4</sup> Këto standarde ndërkombëtare përmenden hollësisht, në mes tjerash, në nenet 9, 10, 14 të Paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike (ICCPR) dhe nenet 5 dhe 6 të Konventës evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut (ECHR ose konventa evropiane).

<sup>5</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9 për Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme, e miratuar me 15 maj 2001, kreu 3, neni 3.3, thekson se “dispozitat për të drejtat dhe liritë të parapara me këto instrumente [instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut] janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë.”

<sup>6</sup> Shqyrtimi i sistemit të drejtësisë penale, 1 shkurt 2000 – 31 korrik 2000 (shqyrtimi i parë); Shqyrtimi i sistemit të drejtësisë penale, 1 shtator 2000 – 28 shkurt 2001 (shqyrtimi i dytë).



rregullt gjyqësor. Shqyrtimi i tretë i OSBE-së<sup>7</sup> e ka bartur shtrirjen në fushën e identifikimit shqetësimeve brenda sistemit gjyqësor në nivelin strukturor të tij. Me atë rast janë adresuar aspektet më specifike të sistemit të drejtësisë penale për të cilat konsiderohej se ngrisin çështjet më kyçe të të drejtave të njeriut. Çështjet siç janë, paraburgimi i paligjshëm, përfaqësimi i pamjaftueshëm nga mbrojtja dhe rastet e trafikimit – ishin adresuar për t'i nënvizuar mos-përputhjen me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Shqyrtimi i katërt i OSBE-së<sup>8</sup> ka raportuar për shqetësimet lidhur me pavarësinë e gjyqësisë, autorizimet e ushtruara nga organet ekzekutive ose ushtarake për të paraburgosur, si dhe paraburgosjet e vazhdueshme arbitrare në Kosovë të personave me sëmundje mentale, ndërsa shqyrtimi i pestë<sup>9</sup> e ka shqyrtuar çështjen e mbrojtjes së dëshmitarëve.<sup>10</sup>

Shqyrtimi i tanishëm fokusohet në paraburgimin dhe denimin e personave në kuadër të sistemit të drejtësisë penale të Kosovës dhe e vështron reagimin e gjyqësorit ndaj lëndëve penale të ndërlidhura me ngjarjet e dhunshme të marsit 2004. Gjithashtu e adreson një numër çështjesh të ngritura nga shqyrtimet e mëparshme, gjegjësisht, mbrojtjen e dëshmitarëve dhe qasjen në mbrojtës efektiv. Në secilën kaptinë, paraqiten rekomandimet gjegjëse me qëllim për të ndihmuar Shtyllën e UNMIK-ut për polici dhe drejtësi si dhe autoritetet tjera përgjegjëse për t'i zhvilluar politikat dhe praktikat e tyre.

Rastet të cilat i përkrahin ose ilustrojnë analizat dhe përfundimet e këtij shqyrtimi shfaqen në paragrafë të veçantë të tekstit. Kjo është bërë për ta orientuar lexuesin në dallim e shembujve nga rastet nga paragrafet analitike.

---

<sup>7</sup> Shqyrtimi i sistemit të drejtësisë penale, tetor 2001 (shqyrtimi i tretë).

<sup>8</sup> Shqyrtimi i sistemit të drejtësisë penale, shtator 2001-shkurt 2002 (shqyrtimi i katërt).

<sup>9</sup> Shqyrtimi i sistemit të drejtësisë penale, (mars 2002 – prill 2003) “Mbrojtja e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale” (shqyrtimi i pestë).

<sup>10</sup> Lexo raportin special të Departamentit për të drejtat e njeriut dhe sundim të së drejtës OSBE: raportin e 9-të të OSBE-së “Mbi administrimin e gjyqësisë” (mars 2002)(më tutje në tekst “OSCE HR/RoL raporti nr 9; raportin e OSBE-së për “Gjykimet e krimeve të luftës në Kosovë”: shqyrtimi ” (korrik 2002); dhe raportin e OSBE-së me titull “Administrimi i gjyqësisë nëpër gjykatat komunale” (March 2004).

## KREU 3

### NJË PËRMBLEDHJE E SHKURTËR HISTORIKE E SISTEMIT GJYQËSOR NË KOSOVË

#### I. HYRJE

Kjo përmbledhje historike për sistemin gjyqësor nuk i paraqet të gjitha zhvillimet që nga vitin 1999 – sepse ka pasur tepër më shumë të tilla. Gjithashtu nuk mëton t'i numërojë të gjitha shqetësimet e mbetura deri me sot. Para së gjithash, kjo pjesë është shkruar që lexuesve, veçanërisht atyre jashtë Kosovës, t'ju ofrohet një kontekst faktik dhe ligjor për çështje e paraqitura në këtë shqyrtim.

Me hyrjen e KB në Kosovë në vitin 1999, ende nuk ishte hequr pluhuri i konfliktit etnik i cili kishte pasuar pas sundimit komunist dhe dhjetë vite të represionit aktiv të brendshëm nga Beogradi. Krimi i organizuar ishte i përhapur ndërsa shërbimi policor ishte rrënuar. Nuk ekzistonte sistem gjyqësor funksional ndërsa sundimi i së drejtës thuajse mungonte fare. Shumica e gjyqtarëve dhe prokurorëve publik aktiv – para fillimit të fushatës së bombardimeve të NATO-s tani kishin ikur. Forca ndërkombëtare ushtarake, KFOR-i ishte përgjegjëse për ruajtjen e ligjit dhe rendit.

#### II. RITHEMELIMI I SISTEMIT GJYQËSOR

Njëra prej punëve të para të UNMIK-ut ishte ta rithemelojë sistemin e gjyqësisë penale. Përfaqësuesi i ri i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), si masë emergjente, e ka shpallur dekretin me të cilin themelohet Këshilli i përbashkët këshillëdhënës për emërimet e përkohshme gjyqësore (KPK). KPK ka rekomanduar emërimin e përkohshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve publik për një periudhë tremujore me mundësi vazhdimi – për sistemin emergjent gjyqësor; kryesisht për të zhvilluar seancat paraprake dëgjimore për personat e burgosur nga KFOR-i. Duke iu përgjigjur rekomandimeve të KPK-së, në mes të qershorit dhe shtatorit të vitit 1999, PSSP i ka emëruar gjithshejt pesëdhjetë e pesë gjyqtarë dhe prokurorë publik. Janë hapur gjykatat e qarkut dhe zyrat e përkohshme të prokurorit publik në Prishtinë/Priştina, Prizren, Mitrovicë/Mitrovica dhe Pejë/Peć. Njësitë mobile kanë operuar jashtë territorit të gjykatës së qarkut të Prishtinës/Priştina, për t'i mbuluar ato rajone të cilat nuk ishin mbuluar nga gjykatat tjera.

Gjatë kësaj kohe UNMIK-u ballafaqohej me dy pengesa të mëdha: ndërsa e para ishte të gjejë gjyqtarë me përvojë – shqiptarë të Kosovës. Një numër relativisht i vogël i shqiptarëve të Kosovës e kishte ushtruar këtë detyrë që nga viti 1989, ndërsa shqiptarët e Kosovës që kishin punuar gjatë viteve 1990 deri në luftë, komuniteti shumicë i kishte denoncuar ata si bashkëpunëtor. E dyta, për krijimin e një gjyqësie etnikisht të përzier – UNMIK-u ka bërë përpjekje të mëdha për rekrutimin e praktikantëve nga të gjitha etnitetet, dhe xhiroja e parë e rezultoi në punësimin e shtatë serbëve të Kosovës<sup>11</sup>. Mirëpo në korrik të vitit 1999, këta gjyqtarë dhe prokurorë - serbë të Kosovës, kanë dhënë dorëheqje duke cituar si shkaqe, mungesën e sigurisë, diskriminimin dhe shpërblimin e pamjaftueshëm<sup>12</sup>.

Deri me 15 dhjetor 1999, kishin përfunduar me qindra seanca për caktimin e paraburgimit dhe 35 gjykime. Mbi 200 lëndë ishin gati për gjykim. Krahas lëndëve të reja të iniciuara që nga qershori 1999, ishin trashëguar të pazgjidhura edhe me mijëra lëndë në procedurë penale dhe kontestimore nga periudha para intervenimit të NATO-s, duke e shtuar kështu numrin e madh

<sup>11</sup> Në fillim numrat e gjyqtarëve sipas përkatësisë etnike ishin: 42 shqiptarë të Kosovës, shtatë serbë të Kosovës, katër boshnjakë të Kosovës, një turk i Kosovës dhe një rom i Kosovës.

<sup>12</sup> Shqyrtimi i parë, fusnota e siperme 6, f. 12.

të lëndëve të pazgjidhura. Por, gjykata e vetme e cila kishte gjyqtarë porotë që ishin të nevojshme për lëndët penale ishte gjykata e qarkut në Prizren. Mungesa e resurseve materiale (siç janë, furnizimi me material të zyres dhe mobilet), pagat e ulta dhe vonesat e pagesës për personelin e gjykatës vetëm sa i kanë shtuar frustrimet në punë.

### **III. FUTJA NË PËRDORIM E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NDËRKOMBËTAR**

Dorëheqjet e gjyqtarëve serbë të Kosovës, bënë që të ketë një gjyqësi pothuajse një etnike. Nga këta gjyqtarë pritej që të merreshin me procese gjyqësore mjaft emocionuese, komplekse dhe për krime lufte. Brenda disa muajsh, kjo gjyqësi tregoi shenjat e animit etnik; për shembull, serbët e Kosovës të akuzuar për krime relativisht të vogla mbaheshin padrejtë në paraburgim në pritje të gjykimit, ndërsa shqiptarët e Kosovës që ishin kapur me duar të përgjakura gjatë kryerjes së akteve të dhunshme ndaj serbëve të Kosovës ishin liruar prë tu mbrojtur në liri. Rrjedhimisht, serbët e Kosovës e kishin humbur besimin në gjyqësi, me ç'rast edhe më tej u ashpërsuan tensionet ndëretnike.

Në shkurt të vitit 2000 eksplodoi dhuna etnike në qytetin e ndarë në vija etnike të Mitrovicës/Mitrovica. Për t'ju përgjigjur situatës, dhe për t'u marrë me personat e arrestuar gjatë përlëshjeve etnike, PSSP-ja e ka emëruar një gjyqtar dhe një prokuror publik ndërkombëtar për Mitrovicë/Mitrovica.<sup>13</sup> Disa muaj më vonë, në maj të vitit 2000, të burgosurit serb të akuzuar për krime lufte kanë hyrë në grevë urie për të protestuar kundër paraburgimit të tejjzgjatur; shumë prej tyre ishin mbajtur në paraburgim për më shumë se një vit ndërsa disa prej tyre edhe pa aktakuzë të ngritur. Grevistët kërkonin që këta dy ndërkombëtare t'i shqyrtojnë menjëherë rastet e tyre duke besuar se vetëm ndërkombëtarët mund t'ua siguronin atyre një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Por nuk ishin të mjaftueshëm vetëm një gjyqtarë dhe një prokuror. Rrjedhimisht me 29 maj 2000, PSSP e miratoi Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/34<sup>14</sup> e cila ua zgjati autorizimet(kompetencat) gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë për tërë territorin e Kosovës<sup>15</sup>. Deri në fund të vitit 2000 ishin 10 gjyqtarë ndërkombëtarë dhe tre prokurorë ndërkombëtarë të cilëve u ishin caktuar kryesisht rastet e krimeve të luftës ku të akuzuar ishin serbët e Kosovës.

Përkundër emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar, shumë shpejt u bë e qartë se problemi i animit mbi bazat etnike në gjyqësi ende nuk ishte zgjidhur. Në shumë raste ku involvohej dhuna etnike, gjyqtarët ndërkombëtarë ishin mbivotuar nga gjyqtarët shqiptarë të Kosovës, për shkak se ishte zakonisht vetëm një gjyqtar ndërkombëtar në kolegjin e të pestëve. Kjo ka rezultuar në aktgjykime dukshëm të diskutueshme kundër serbëve të Kosovës të akuzuar. Përfundimisht, UNMIK-ut e vuri në fuqi Rregulloren 2000/64,<sup>16</sup> e cila i mundësonte, çoftë prokurorit publik apo avokatit mbrojtës, të kërkoj nga Departamenti administrativ i drejtësisë (DAD), caktimin e gjyqtarëve ose prokurorëve ndërkombëtar atëherë kur kjo ishte "e nevojshme për sigurimin e pavarësisë dhe objektivitetit të gjyqësisë ose për administrimin e duhur të drejtësisë"<sup>17</sup>. Tani UNMIK-u posedonte kompetenca efektive për caktimin e trupit gjykues në përbërje prej tre gjyqtarëve profesional (në vend të dy profesionistëve dhe tre gjyqtarëve porotë), me së paku dy gjyqtarë ndërkombëtarë në kolegji. Kjo siguroi që gjyqtarët ndërkombëtarë të mos mund të mbivotoheshin nga ana e gjyqtarëve

<sup>13</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2000/6 për emërimin dhe shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, 15 shkurt 2000.

<sup>14</sup> Rregullorja 2000/34 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/6 për emërimin dhe shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, 27 maj 2000.

<sup>15</sup> Shqyrtimi i parë, fusnota e sipërme 6, f. 69.

<sup>16</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64 për caktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë dhe/ose ndërrimin e vendit, 15 dhjetor 2000. Për diskutim të mëtejme lidhur me Rregulloren 2000/64, lexo shqyrtimin e dytë, fusnota e sipërme 6, f. 75 ff (më tutje në tekst "ff").

<sup>17</sup> Në mungesë të kërkesës, DAD mund të veprojë sipas vetiniciativës. Lexo Rregulloren e UNMIK-ut 2000/64, neni 1(2).

vendës. Krahas kësaj, prokurorëve ndërkombëtarë u ishte dhënë autorizimi për rifillimin e lëndëve të cilat ishin ndërprerë nga homologët e tyre vendës. Kjo procedurë ende është në fuqi edhe sot në Kosovë.

#### IV. PAKICAT DHE GJYKATAT

Njëra prej pengesave drejt një sistemi gjithpërfshirës gjyqësor është qasja fizike nëpër gjykata për grupet e pakicave. Që nga vlerësimi i nëntë i situatës së pakicave etnike në Kosovë,<sup>18</sup> situata është përmirësuar, por ende dallon konsiderueshëm prej një regjioni në tjetrin. Shërbimet e transportit nganjëherë edhe ofrohen por objektet mbeten formale dhe mbizotëron ankthi i përgjithshëm i qytetarëve serb të Kosovës. Vështirësia për të pasë qasje në gjykatat e rregullta, i jepë jetë ekzistimit të struktrave paralele gjyqësore.<sup>19</sup>

OSBE ka rekomanduar për angazhime gjithpërfshirëse dhe të renditura për krijimin e gjyqësisë shumetnike në Kosovë dhe gjithashtu të sigurojë qasje efektive dhe të barabartë në drejtësi për pjesëtarët e bashkësive të pakicave.<sup>20</sup> Në përgjigjje të këtyre nevojave, në fillim të vitit 2002 Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut e ka krijuar Seksionin për integrim gjyqësor (SIGj) si pjesë e departamentit të drejtësisë të UNMIK-ut. Mandati i SIGj është të promovojë integrimin etnik të gjyqtarëve dhe prokurorëve në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës, të adresojë problemet e gjyqësorit që i prekin pakicat, të monitorojë trajtimin e pakicave nga sistemi gjyqësor dhe t'i adresojë rastet e diskriminimit. SIGj gjithashtu punon me Departamentin e Administratës Gjyqësore (DAGj)<sup>21</sup> për lehtësimin e integritit etnik të personelit teknik të gjykatës.

Që nga viti 1999 gjykatat e strukturave paralele, që u jepnin llogari Beogradit dhe jo UNMIK-ut, u zhvilluan në Kosovë dhe vazhdojnë të ekzistojnë kryesisht nëpër enkalvat serbe. Gjykatat paralele u zhvilluan në Kosovë për shkak të mosnjohjes së strukturave të UNMIK-ut nga ana e serbëve të Kosovës që kishin mbetur në Kosovë pas konfliktit. Strukturat paralele serbe veprojnë në regjionin e Mitrovicës/Mitrovica, Prishtinës/Pristina dhe Gjilanit/Gnjilane. Gjykata komunale paralele vepron në Mitrovicë/Mitrovica. Gjykata e qarkut në Kralevë (Serbi), përmes sistemit paralel e ushtron juridikcionin e vet edhe në regjionin e Mitrovicës/Mitrovica. Gjykata komunale në Lepinë/Lepina, e komunës së Lipjanit/Lipljan e ushtron juridikcionin për territorin e regjionit të Prishtinës/Pristina. Ankesat ndaj vendimeve të gjykatës në Lepinë/Lepina, ngriten pranë gjykatës së qarkut në Nish (Serbi). Për regjionin e Gjilanit/Gnjilane gjykata paralele komunale për Gjilan/Gnjilane është rivendosur në Vranjë (Serbi), ndërsa gjykata komunale për Shtërpçë/Štrpce vepron nga Leskovci (Serbi), me një zyre administrative në Shtërpçë/Štrpce. Nuk ka gjykata të shkallës së dytë të njohura që veprojnë në Pejë/Peć ose Prizren. Mirëpo gjykata komunale paralele për Pejë/Peć dhe Prizren veprojnë nga Leskovci, respektivisht Krushevc (Serbi). Si duket në Serbi veprojnë gjykata të cilat e mbajnë juridikcionin për secilin qark dhe komunë të Kosovës.

UNMIK-u ka punuar drejt shpërbërjes së gjykatave paralele duke hapur gjykatat shoqëruese të UNMIK-ut nëpër komunat veriore. Në këtë kontekst, më 9 korrik 2002 ishte nënshkruar deklarata e përbashkët në mes të ministrit të Drejtësisë të Republikës së Serbisë dhe zëvendësit të PSSP-së për shtyllën e UNMIK-ut për drejtësi dhe polici, për të lehtësuar edhe

<sup>18</sup> UNHCR-OSCE vlerësimi i nëntë i “gjendjes së pakicave kombëtare në Kosovë (shtator 2001-prill 2002), f. 16. Shiko më tej, Raporti i OSBE mbi Aktivitetin Paralel Gjyqësor në Kosovën Veriore (nëntor 2001), UNHCR dhe OSBE, Vlerësimi i Dhjetë i Situatës së Minoriteteve Etnike në Kosovë (mars 2003) dhe Raportin e OSBE i titulluar: Strukturat Paralele në Kosovë (tetor 2003)

<sup>19</sup> Lexo, raportin e OSBE-së për “Aktivitetet e gjykatave paralele në Kosovën Veriore, dhe lexo vlerësimin e dhjetë të OSBE-së dhe UNHCR-së për “Gjendjen e pakicave kombëtare në Kosovë, të publikuar në mars 2003 (maj 2002-dhjetor 2002), f. 31.

<sup>20</sup> Lexo raportin e OSBE-së 9, fusnota e sipërme 10.

<sup>21</sup> Departamenti i Ministrisë për Shërbime Publike.

më tej procesin e rekrutimit të prokurorëve dhe gjyqtarëve serb të Kosovës në kuadër të gjykatave të UNMIK-ut.<sup>22</sup> Pas procesit të aplikimit, UNMIK-u i ka hapur gjykatat komunale dhe ato për kundërvajtje në komunat e populluara kryesisht nga serbët, gjegjësisht në Leposaviq/Leposavic dhe Zubin Potok. Katër gjyqtarë në gjykatë komunanle dhe tre në gjykatë për kundërvajtje të përkatësisë etnike serbe të Kosovës e kanë dhënë betimin para PSSP-së, duke filluar efektivisht detyrën me 13 janar 2003. shumica e gjyqtarëve dhe personelit teknik kanë punuar më heret në kuadër të sistemit paralel ndërsa gjykatat e reja janë hapur në objektet e gjykatave paralele, me kuptimin se gjykatat paralele ishin paraparë të shpërbëheshin.

Gjatë kohës së përpilimit të shqyrtimit, në Kosovë detyrën e ushtronin 313 gjyqtarë, 86 prokurorë dhe 543 gjyqtarë porotë.<sup>23</sup> Në sistemin gjyqësor të UNMIK-ut janë të angazhuar 16 gjyqtarë dhe tre prokurorë serb të Kosovës, 16 gjyqtarë dhe gjashtë prokurorë të pakicave tjera.<sup>24</sup> Edhe pse gjëndja është përmirësuar që nga viti 2000 dhe përpjekje të jashtëzakonshme janë bërë për ta lehtësuar gjyqësinë etnikisht të përzier, pjesëmarrja e pakicave në kuadër të sistemit gjyqësor mbetet ende sfidë për UNMIK-un.

## **V. REFORMA E LEGJISLACIONIT PENAL**

Para datës 6 prill 2004, ligji në fuqi ishte një kombinim hutues në mes të ish-ligjeve federale të Jugosllavisë, atyre republikan, dhe ligjeve të Kosovës, rregulloreve të UNMIK-ut, dhe instrumenteve të emëruara ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Si ushtruesit vendës ushtu edhe ata ndërkombëtarë në mënyrë të ngjajshme kanë bërë mundime për arritjen e një konsistence në zbatimin e nganjëherë ligjeve kundërtëhënëse dhe rregullisht kanë dështuar.

Pas disa vite të hartimit dhe rihartimit, hyn në fuqi një pako tërësisht e reviduar e kodeve penale më 6 prill 2004.<sup>25</sup> Kodet i kanë edhe problemet e veta për nga aspekti i stilit të përpilimit, jokonsistencës dhe ngathtësisë, por megjithatë paraqet një zhvillim të mirëpritur. Gjithësesi, theksi i kodeve lidhur me zbatueshmërinë e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përcjellë një porosi të rëndësishme. Me ndihmën e vendimeve gjyqësore me të cilat interpretohet dhe zbatohet ligji, shpresohet se kodet e reja përfundimisht do të shndërrohen në instrumente më të rafinuara gjyqësore.

Ndryshimi kryesor sipas kodit të ri të procedurës penale është roli më i madh i prokurorit publik i cili merr për sipër më shumë përgjegjësi që i kanë takuar më parë gjyqtarit hetues. Ky ndryhim e shtyen ndjekjen penale dhe mbrojtjen në një rol më shumë kontardikator në mënyrë që provat të vlerësohen tërësisht. Futja e procedurës së konfirmimit të aktakuzës – e cila u mundëson gjyqtarëve që ta zbarsin aktakuzën me të meta para se të shkojë në gjykim, dhe i lejon të akuzuarit të deklarohet i fajshëm – është gjithashtu një hap i rëndësishëm. Këto risi kanë për qëllim ta rrisin ekspeditivitetin e gjykimeve duke iu mundësuar gjykatave ta kursejnë kohën e tyre për rastet e dobëta ose që të mos gjykojnë rastet në të cilat të akuzuarit deklarohen të fajshëm.

## **VI. SISTEMI JURIDIK SOT**

Para katër vitesh më parë, sistemi gjyqësor ishte i rrënuar. Që prej asaj kohë është transformuar në një sistem funksional, i cili ngërthen shumë norma dhe instrumente juridike

<sup>22</sup> “Deklarata e përbashkët për rekrutimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të etnicitetit serb në kuadër të sistemit shumetnik gjyqësor të Kosovës.”

<sup>23</sup> DoJ raporti javor (5-11 tetor 2004).

<sup>24</sup> DoJ raporti javor, ibid.

<sup>25</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25 për Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26 për Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK).

moderne dhe progresive. Këto përmirësime janë produkt i përpjekjeve të jasthëzakonshme të bëra nga akterët vendës dhe ata ndërkombëtar, përfshirë, gjyqtarët, prokurorët, avokatët mbrojtës si dhe ata të angazhuar në organe të ndryshme gjyqësore. Mirëpo, sistemin e drejtësisë penale në mënyrë të vazhdueshme e trazojnë shqetësimet që ndërlidhen me standardet për sundimin e së drejtës dhe ato për të drejtat e njeriut: sikur gjyqtarët vendës ashtu edhe ata ndërkombëtarë bëjnë shkelje të rregullta të ligjit në fuqi, përfshirë edhe dispozitat e të drejtave të njeriut; avokatët mbrojtës nuk i përfaqësojnë si duhet klientët e vet; Oda e Avokatëve nuk ka kontrollë mbi anëtarët e vet; pagesa për avokatët e caktuar sipas detyrës zyrtare si dhe për ekspertët dukshëm është e vonuar; procesi i punësimit të personelit teknik duhet urgjentisht të rishikohet,<sup>26</sup> mungojnë objektet e përshtatshme për të miturit dhe kryesit e sëmurë psiqikisht; frikësimi i dëshmitarëve është i shprehur ndërsa gjykatave ju mungojnë pajisjet për zbatimin e masave mbrojtëse; dhe ndoshta ajo më brengosëse nga të gjithat, UNMIK-u vetëm sa ka filluar të implementoj strategjinë e tranzicionit në të cilat kompetencat për punët gjyqësore do të barten tek akterët dhe institucionet vendëse.

---

<sup>26</sup> Në maj 2004, shumica e kryetarëve dhe kryeprokurorët e gjykatave komunale e kanë informuar OSBE-në se metoda e punësimit të personelit teknik është problematike. Ata punësohen nga Departamenti i administratës gjyqësore (DAGj) i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike (MSHP). Siç raportohet, këta punëtorë përzgjedhen dhe angazhohen pa nonjë konsultim efektiv me kryetarët/kryeprokurorët e gjykatave (edhe pse shpesh një gjyqtarë është anëtar i këshillit përzgjedhës, ose ai ose ajo në mënyrë të vazhdueshme mbivotohet nga të tjerët nga DAGj dhe MSHP) duke rezultuar kështu me angazhimin e personave joadekuat. Si duket, në DAGj ka luajtur rol të rëndësishëm familjarizmi dhe bindjet politike në përzgjedhjen dhe angazhimin e personelit teknik të gjykatave.

## KREU 4

### PARABURGIMI

#### I. HYRJE

Sipas standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ekziston prezumimi në favor të lirimit të të pandehurit në pritje të gjyqimit. Paraburgimi është masa e fundit për sigurimin e rrjedhës së suksesshme të procedurës penale.<sup>27</sup> Ky standard është pjesë e parimit fundamental të prezumimit të pafajsisë<sup>28</sup> dhe të drejtës për liri dhe siguri të personit.<sup>29</sup> Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike (PNDKP) thotë se privimi nga liria duhet të kryhet duke u mbështetur në bazat dhe procedurën e përcaktuar me ligjin vendës (parimi i ligjshmërisë).<sup>30</sup> Ngjashëm, Konventa evropiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ) kërkon që privimi nga liria të bëhet në pajtim, dhe për arsytet që shprehimisht përmenden në ligj.<sup>31</sup> Për më shumë, privimi nga liria nuk duhet të jetë arbitrar, në kuptim që paraburgimi duhet të jetë i arsyeshëm dhe i domosdoshëm sipas rrethanave.<sup>32</sup> Për shkak se paraburgimi konsiderohet si përjashtim, standardet ndërkombëtare parashohin se lirimi mund të kushtëzohet me garanca për tu paraqitur në gjykim.<sup>33</sup>

Në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si ligji i vjetër ashtu edhe kodi i ri e parashohin paraburgimin si mjetin më të rëndë për sigurimin e prezencës së të akuzuarit dhe për rrjedhën e suksesshme të procedurës penale, dhe që i njëjti të mos caktohet kur me masë më e lehtë mund të arrihet i njëjti qëllim.<sup>34</sup> Në pajtim me këtë, paraburgimi duhet të mbahet për kohën sa më të shkurtër të domosdoshme, përderisa të gjitha organet pjesëmarrëse në procedurën penale detyrohen të veprojnë me nguti të posaçme nëse i pandehuri është në paraburgim.<sup>35</sup>

Ligji i vjetër parashihte mundësinë e caktimit të paraburgimit, nëse ekzistonte dyshimi i bazuar se i dyshuari kishte kryer veprë penale, nëse ekzistonte mundësia e fortë e ikjes apo frika e bazuar e pengimit të hetimeve apo frika nga vazhdimësia e kriminalitetit apo, për raste të veçanta të veprave të rënda, mundësia e shqetësimit të qytetarëve.<sup>36</sup>

Ligji i vjetër gjithashtu numëronte masat tjera, si alternativa ndaj heqjes së lirisë.<sup>37</sup> Megjithatë, këto masa kishin të bënin vetëm për sigurimin e pranisë të të akuzuarit në gjykim, e nuk ishin parashikuar të mbulojnë edhe bazat tjera për të cilat mund të caktohej

<sup>27</sup> Rregulli 6.1 i Rregullave Standarde Minimale për Masat Jo-Burgimore, të Kombeve të Bashkuara (“Rregullat e Tokios”), të cilat parashohin se “paraburgimi do të përdoret si mjet i fundit në procedurat penale, me qëllim të hetimit të veprës së raportuar dhe mbrojtjes së shoqërisë dhe viktimës”. Shiko gjithashtu *B. Hill. V. Spanja*, Komiteti për të Drejtat e Njeriut, (2 prill 1997), KB dok. GAOR, A/52/40 (Vëll. II), f. 17, para. 12.3.

<sup>28</sup> Neni 6(2) KEDNJ, Neni 14(2)KNDCP.

<sup>29</sup> Neni 5(1) KEDNJ dhe Neni 9(1)KNDCP.

<sup>30</sup> Neni 9(1)KNDCP.

<sup>31</sup> Neni 5(1) KEDNJ.

<sup>32</sup> Neni 9(1)KNDCP. Shiko gjithashtu *A.W.Mukong v. Kameruni*, Komiteti për të Drejtat e Njeriut (21 korrik 1994), në dok. E KB GAOR, A/49/40 (Vëll. II), f. 181, para. 9.8, dhe *Steel dhe të tjerët v. Britania e Madhe*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm “Gjykata Evropiane”), 23 shtator 1998, para. 54.

<sup>33</sup> Neni 5(3) KEDNJ dhe Neni 9(3)KNDCP.

<sup>34</sup> Neni 182(2) i Ligjit të Procedurës Penale të Republikës Federale të Jugosllavisë, Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr. 26/86 (LPP RFJ) DHE Neni 268 (1-2) KPPP.

<sup>35</sup> Neni 190(2) LPP RFJ dhe Neni 5(3) dhe 279 (2) KPPP.

<sup>36</sup> Neni 191 (2) LPP RFJ.

<sup>37</sup> Respektivisht ftesat, obligimi të paraqitet, premtimi se nuk do të mshifet dhe nuk do të largohet nga vendbanimi, dhe dorëzania, siq numërohen në nenin 182 (1) LPP RFJ.

paraburgimi.<sup>38</sup> Mbase për shkak të faktit se masat jo-izoluese kanë pasur zbatim të kufizuar, mbajtja në paraburgim më parë ishte bërë rregull se sa përjashtim.

Sipas kodit të ri, paraburgimi caktohet me plotësimin e kushteve kumulative si në vijim:

- Së pari, kur ka dyshimi të bazuar se një person ka kryer veprë penale;
- Së dyti, kur ekziston frika nga ikja, ndërhyrja me provat, apo përsëritja e veprës penale; dhe,
- Së treti, kur masat alternative të ofruara me kodin e ri janë të pamjaftueshme për të siguruar prezencën e të akuzuarit, rrjedhën e suksesshme të procedurës dhe pengimin e përsëritjes së veprës.<sup>39</sup>

Me qëllim të minimizimit të përdorimit të paraburgimit, kodi i ri i procedurës parashikon masat alternative plotësuese. Procedura në fuqi gjithashtu i lejon gjykatës që t'ia ndalojë të pandehurit që t'i afrohet vendit apo personit të caktuar, e obligon atë që të paraqitet në stacionin policor, apo ta vendosë atë në paraburgim shtëpiak. Për më tepër, kodi i ri parashikon mundësinë e lejimit të dorëzimit për ta zvogluar rrezikun e vazhdimin të kriminalitetit, si dhe të minimizoj rrezikun e ikjes.<sup>40</sup> OSBE ka vërejtur se gjyqtarët ndërkombëtar sikurse edhe ata vendës e kanë shpeshtuar përdorimin e këtyre masave, edhe pse përdorimi i tyre më i gjërë duhet të nxitet edhe më shumë, ashtu siç e demonstroi edhe ky kapitull.<sup>41</sup> Përkundër faktit se janë vërejtur disa probleme të caktuara në aplikimin e masave alternative,<sup>42</sup> nuk ka pasur shumë shembuj që do të mund t'i kualifikonin këto probleme si probleme gjithëpërfshirëse në fazën e tanishme, andaj edhe nuk janë përmendur në këtë shqyrtim.

Ky kapitull adreson disa praktika problematike të cilat janë vërejtur në tërë Kosovën përkitazi me paraburgimin, si para ashtu edhe pas 6 prillit 2004. Çështjet e ngritura konsistojnë si në vijim:

- Së pari, dështimi i gjykatave që t'i arsyetojnë vendimet fillestare për paraburgim dhe ta marrin në konsiderim zbatimin e masave alternative;
- Së dyti, çështjet e caktuara përkitazi me vazhdimin e paraburgimit, respektivisht mungesën e njëtrajtësisë në caktimin e kohës kur fillojnë këto vazhdime, mungesa e arsyetimeve ndaj këtyre vendimeve, dhe dështimin për të shpjeguar mos zbatimin e masave alternative;
- Së treti, çështjet përkitazi me vendimet mbi ankesat kundër urdhërave për paraburgim; respektivisht dështimi i gjykatave të apelit që në mënyrë të duhur t'i arsyetojnë vendimet e tyre, fakti se vendimet e tyre janë marrë me vonesë të konsiderueshme dhe vërejtjet se procedura ankimore mund të mos jetë vertetë kontradiktore. Për më shumë, duket se gjykatat nuk e kuptojnë si duhet se si t'i shqyrtojnë kërkesat *habeas corpus*; dhe,

<sup>38</sup> Nenet 183 (1), 184(1), 185(1) dhe 186 LPP RFJ.

<sup>39</sup> Neni 281(1) nënpara. (1-3) KPPP.

<sup>40</sup> Shiko nenet 272, 273, 278 KPPP dhe 274 (1 dhe 2).

<sup>41</sup> Mund të jetë me interes se më 8 shkurt 2004 nga gjithsej 1.092 persona në objektet përmirësuese në Kosovë, 441 ishin në paraburgim (37 %). Më 31 tetor 2004 nga gjithsej 1.193 persona, 425 ishin në paraburgim (35,6%). Statistikat janë ofruar nga Divizioni i Menagjimit të Burgjeve të DD.

<sup>42</sup> Për shembull, duket se ekziston konfuzion përkitazi me mbikqyrjen e implementimit të paraburgimit shtëpiak.



- Së fundi, dështimi i autoriteteve kompetente që t'i kushtojnë vëmendje të posaçme rasteve të ndryshme të personave të paraburgosur dhe t'i ekzekutojnë menjëherë urdhërat për lirim.

Sa i përket qështjes së arsytimit joadekuat të vendimeve për paraburgim, duhet të theksohet se ekziston një vijë e jurisprudencës në dispozicion ku vendimet janë të arsyetuara në mënyrë të duhur dhe në pajtim me me standardet ndërkombëtare. Këto vendime janë dhënë të shumtën nga kolegjet apo gjykatësit ndërkombëtar si në nivelin e Gjykatave të Qarkut ashtu edhe në atë të Gjykatës Supreme. Megjithatë, shumica e vendimeve për paraburgim nga gjykatat në Kosovë nuk i përmbushin kërkesat e arsytimit të duhur. Ky kapitull ka të bëjë me shqetësimet përkitazi me vendimet e kësaj kategorie të fundit.

## II. ARSYETIMI I PAMJAFTUESHËM I VENDIMEVE FILLESTARE PËR PARABURGIM

Sipas ligjit të vjetër dhe kodit të ri, paraburgimin e cakton gjyqtari pas dëgjimit të palëve.<sup>43</sup> Standardet ndërkombëtare dhe praktika gjyqësore kërkon që gjykatat t'i arsyetojnë vendimet dhe aktgjykimet e tyre.<sup>44</sup> Vendimi i arsyetuar u demonstroi palëve se ata janë dëgjuar si dhe administrimin e drejtësisë e vendosë në syrin e publikut.<sup>45</sup>

Si ligji i vjetër ashtu edhe kodi i ri i procedurës penale kërkojnë që aktvendimet mbi paraburgimet të jenë plotësisht të arsyetuara.<sup>46</sup> Në veçanti, kodi i ri kërkon të shpjegohen që të gjitha faktet materiale që e diktojnë paraburgimin, e kjo përfshinë gjithashtu edhe shpjegimin mbi shkakun se pse nuk mjaftojnë masat alternative për paraburgim.<sup>47</sup> Për më tepër, Qarkorja e gjyqësisë 27/2000<sup>48</sup> thotë se, të gjitha vendimet mbi paraburgimin duhet të bëhen në bazë të vendimit me shkrim të arsyetuar plotësisht, që detajizon bazat për paraburgim si dhe çdo provë mbi të cilën është bazuar në mbështetje të këtyre bazave. Mungesa e arsytimit në një vendim për paraburgim apo parafrazimi i thjeshtë i ligjit si arsyetim, përbën shkelje esenciale të procedurës penale, dhe rrjedhimisht, paraqet bazë për ankesë.<sup>49</sup>

<sup>43</sup> Nenet 192(2) dhe 193(4) LPP RFJ, dhe 282 KPPP.

<sup>44</sup> Për shembull shiko *Hood v. Britania e Madhe*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 18 shkurt 1999, para. 60, dhe *Smirnova v. Rusia*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 24 tetor 2003, para. 71.

<sup>45</sup> Shiko *Suominen v. Finlanda*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 1 korrik 2003, para. 34-37.

<sup>46</sup> Neni 192(2) LPP RFJ thotë se paraburgimi do të urdhërohet me vendim me shkrim i cili do të përmbajë, mes tjerash, "bazat ligjore për paraburgim...(dhe) një shpjegim të shkurtër, në të cilën bazat ligjore për urdhërimin e paraburgimit do të shpjegohen në mënyrë specifike." Neni 283(1) KPPP parasheh se paraburgimi duhet të urdhërohet me vendim me shkrim, i cili duhet të përmbajë, në mes tjerash, "bazat ligjore për paraburgim...(dhe) shpjegimin mbi të gjitha faktet materiale të cilat diktuan paraburgimin, përfshirë edhe shkaqet për dyshimin e bazuar se personi ka kryer vepër penale dhe faktet materiale sipas nenit 281(1) nënparagrafet (2) (KPPP)."

<sup>47</sup> Neni 281 (1) nënparagrafi (30) KPPP. Ndonëse kodi i ri në mënyrë eksplicite nuk përmend se ky kusht duhet të arsyetohet në vendimin mbi paraburgim, është e qartë nga formulimi i nenit 283(1) KPPP se vendimi duhet të shpjegojë në mënyrë specifike të gjitha faktet materiale, në bazë të të cilave gjykata konsideron se masat jo-burgimore nuk ishin të mjaftueshme në rastin specifik. Ligji i vjetër nuk kërkonte në mënyrë specifike që kjo të shpjegohet në vendimin mbi paraburgimin, ndonëse komentaret thonë se vendimi mbi paraburgimin duhet gjithashtu të përmbajë shkaqet që shpjegojnë se pse masat më të lehta nuk mjaftojnë; shiko *Branko Petric, Komentari i Ligjit mbi Procedurën Penale* (Beograd, edicioni I 2-të, Gazeta Zyrtare e RSFJ, 1986), për nenin 192 (II) (në tekstin e mëtejshëm "*Komentari*")

<sup>48</sup> Shiko Qarkoren Gjyqësore 2000/27 mbi Vendimet për Paraburgim, 19 dhjetor 2000.

<sup>49</sup> Shiko nenin 435 KPPP në lidhje me nenin 401 (1) nënpara (2) dhe 402 KPPP. Për ligjin e vjetër, shiko *Branko Petric, Komentari*, fusnota e sipërme 47, dhe neni 398 91) në lidhje me nenet 362 (1) pika (2) dhe 363 LPP RFJ.

Në shumicën e rasteve të monitoruara, OSBE ka vërejtur me shqetësim se, përkundër kërkesave ligjore, ka ekzistuar mungesë e arsytimit të duhur në vendimet fillestare për paraburgim. Si model i përgjithshëm, në vendimi thjeshtë theksohej se, bazuar në dosjen e lëndës (kryesisht dokumentacioni nga policia) dhe deklaratën e të dyshuarit, ekzistonte dyshimi i bazuar se i dyshuari ka kryer veprën penale.<sup>50</sup> Në vend që të ofrojnë shpjegim se si rrethanat specifike kërkojnë privimin nga liria e të dyshuarit, gjykatësi hetues thjeshtë do të parafrizonte dispozitat procedurale dhe/ose përdorte fjalitë standarde. Argumentet e paraqitura nga i dyshuari apo avokati mbrojtës gjatë dëgjimeve paraprake rrallë herë do të përmendeshin. Më poshtë janë shembujt e zgjedhur të praktikave relevante të vërejtura në gjykatat komunale dhe të qarkut, të cilat janë tipike për tërë Kosovën:

Në një rast sipas ligjit të vjetër, para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë/Priştina, paraburgimi ishte caktuar më 21 janar 2004 në lidhje me dy të dyshuar, të ngarkuar me vjedhje të rëndë dhe armëmbajtje pa leje, me arsytimin si vijon: “ndaj të pandehurve caktohet paraburgimi konform nenit 191(2), pika 1 dhe 2 të LPP RFJ, ngase ekzistojnë rrethanat që tregojnë frikën e bazuar se po të gjendeshin të pandehurit në liri do të arratiseshin, si dhe do të ndikonin në dëshmitarë...” (përkthim jozyrtar). Asnjë specifikë nuk ishte dhënë përkitazi me këto rrethana.

Gjykatësi hetues i Gjykatës Komunale në Gjilan/Gnjilane, më 21 mars 2004 ia caktoi paraburgimin një personi të dyshuar për kryerjen e veprës “shkaktim të rrezikut të përgjithshëm”, mbi këto baza: “ekzistonte frika e bazuar se, po qe se i njëjti do të gjindej në liri, mund të arratiset dhe të pengojë zhvillimin e hetimeve duke ndikuar në dëshmitarë, si dhe të përsërisë veprën penale. Këto konstatime nuk ishin në relacion me faktet specifike të rastit.

Në një masë të madhe, mungesa e arsytimit në aktvendimet për caktimin e paraburgimit qëndron edhe pas hyrjes në fuqi të kodeve të reja. Për më tepër, përkundër faktit se kodi i ri në mënyrë specifike kërkon që paraburgimi të caktohet vetëm kur masat tjera nuk mjaftojnë, shumica e vendimeve nuk e diskutojnë (madje as përmendin) shkakun se pse këto masa janë jo-adekuate. Më poshtë janë dhënë shembujt tregues të kësaj dukurie gjithëpërfshirëse:

Në një rast para Gjykatës Komunale në Prishtinë/Priştina, dy të pandehur ishin ngarkuar me tentim vjedhje, pas propozim akuzës më 6 gusht 2004. Në aktvendimin e tij të 6 gushtit 2004 për caktimin e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake gjeti se: “nëse të pandehurit do të lirohen, ata mund të ikin, mund të pengojnë rrjedhën e procedurës penale dhe ekzistonte rreziku i përsëritjes së veprave të ngjashme penale”(përkthim jozyrtar). Përveç asaj se nuk është dhënë asnjë shkak për të besuar se ekzistojnë këto baza të paraburgimit, gjykatësi i procedurës paraprake nuk ka marrë në konsiderim ndonjë alternativë ndaj paraburgimit dhe nuk ka demonstruar se të njëjtat ishin të pamjaftueshme në këtë rast.

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Prizren, dy të pandehur ishin ngarkuar me shitblerje të paligjshme, posedim, shpërndarje dhe shitje të narkotikëve të rrezikshëm, si dhe armëmbajtje pa leje. Pas dëgjimit më 4 korrik 2004, gjykatësi i procedurës paraprake vendosi për caktimin e paraburgimit “sepse ekzistonte dyshimi se i pandehuri mund të arratiset, se do ta pengoj rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, të asgjësoj provat e veprës penale si dhe duke pasur parasysh peshën e veprës penale, caktimi i paraburgimit është i arsyeshëm dhe i domosdoshëm” (përkthim jozyrtar). Në aktvendim nuk shpjegoheshin rrethanat e veçanta për secilin të akuzuar, të cilat mbështesnin këtë vendim. Krahas kësaj, atij aktvendimi i

---

<sup>50</sup> Në praktikë, vendimet fillestare për paraburgim të marra në pajtim me nenin 191(2) LPP RFJ nuk e ekzaminojnë nëse dyshimi i bazuar ka ekzistuar kundër të akuzuarit, pasi që, në përgjithësi kjo tashmë ishte bërë në vendimin për fillimin e hetimeve, i cili menjëherë i paraprinte urdhërit për paraburgim.

mungonte referenca për masat jo-izoluese dhe shpjegimi se pse këto ishin jo-adekuate.

Këta shembuj ilustron trendin se bazat për vendimet për paraburgim nuk mbështeten nga provat dhe rrethanat specifike. Për më shumë, shumica e vendimeve fillestare nuk shpjegojnë shkaqet për të cilat gjykata konsideron se masat alternative të paraburgimit nuk mjaftojnë. Edhe në rastet kur vendimet për paraburgim mund të jenë substancialisht korrekte, kjo mungesë e arsytimit të duhur cenon ligjin e aplikueshëm dhe, për shkak se është vështirë të vërtetohen arsyet për caktimin e paraburgimit, e cungon të drejtën për ankesë.

### III. ÇËSHTJET QË KANË TË BËJNË ME ZGJATJËN E PARABURGIMIT

Sipas standardeve ndërkombëtare, vazhdimësia e dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri ka kryer një veprë është një kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e paraburgimit të vazhduar.<sup>51</sup> Autoritetet gjyqësore duhet gjithashtu t'i theksojnë bazat relevante dhe ato të mjaftueshme, të cilat vazhdojnë ta arsyetojnë heqjen e lirisë, dhe duhet të shfaqin kujdes të posaçëm gjatë zhvillimit të procedurës.<sup>52</sup>

Ligji vendës përcakton një sistem sipas të cilit paraburgimi shqyrtohet periodikisht nga gjykata, si para ashtu edhe pas ngritjes së aktakuzës deri në shpalljen e aktgjykimit të shkallës së parë.<sup>53</sup>

#### A. Mungesa e uniformitetit në caktimin e kohës së llogaritur për zgjatjen e paraburgimit

Zakonisht, sipas ligjit të vjetër dhe kodit të ri, zgjatja e paraburgimit të të dyshuarit ishte shqyrtuar nga kolegji kompetent në ditën kur vendimi paraprak mbi paraburgimin ishte duke skaduar ose disa ditë më parë. Si ligji i vjetër ashtu edhe kodi i ri janë të paqartë përkitazi me pikën fillestare aktuale të zgjatjes së paraburgimit.<sup>54</sup> OSBE ka vërejtur se, zakonisht, gjykatat marrin vendime për zgjatjen e paraburgimit, por llogarisin pikën fillestare prej datës kur vendimi i mëparshëm do të duhej të skadonte (në tekstin e mëtejshëm “praktika e parë”),<sup>55</sup> përderisa herëve tjera ata llogarisnin fillimin e zgjatjes së paraburgimit prej datës kur është marrë vendimi i tyre (në tekstin e mëtejshëm “praktika e dytë”).<sup>56</sup>

<sup>51</sup> Shiko *Stogmuller v. Austria*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 10 nëntor 1969, Sweria A nr. 9, f. 40, para. 4.

<sup>52</sup> Shiko *B. v. Austria*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 28 mars 1990, para. 42.

<sup>53</sup> Për sistemin e ligjit të vjetër shiko nenet 197, 199 dhe 265 LPP RFJ, si dhe Rregulloren e UNMIK-ut 1999/26 Mbi Vazhdimin e Kohëzgjatjes së Paraburgimit Para-Gjyqësor, 22 dhjetor 1999. Për sistemin e kodit të ri shiko nenet 282-287 dhe 306 KPPP.

<sup>54</sup> Neni 197 LPP RFJ i referohej vetëm maksimumit kohor për të cilin gjykata kompetente mund të zgjasë paraburgimin. Neni 285 KPPP i referohen maksimumit kohor për të cilin vazhdimet e paraburgimeve mund të urdhërohen nga gjykata kompetente, ndonëse potencon se mbrojtja do të jetë e informuar mbi parashtresat e prokurorit për vazhdimin e paraburgimit jo më pak se tri ditë para skadimit të vendimit të tanishëm mbi paraburgimin.

<sup>55</sup> Për shembull, në një rast para Gjykatës së Qarkut në Pejë, i akuzuari ishte ngarkuar për pjesëmarrjen në grupin që kryen dhunë, pengimin e personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës, shantazh dhe armëmbajtje pa leje. I pandehuri ishte arrestuar më 5 maj 2004, dhe më 6 maj 2004 gjykatësi para-gjyqësor urdhëroi paraburgimin e tij për një muaj deri më 4 qershor 2004. Më 1 qershor 2004, kolegji tre-anëtarësh vendosi ti zgjasë paraburgimin për një muaj ashtu që i njëjti u vazhdua prej 4 qershorit 2004 deri më 4 korrik 2004.

<sup>56</sup> Për shembull, në një rast para Gjykatës së Qarkut në Prizren, sipas kodeve të reja, i pandehuri i ngarkuar për lëndime trupore ishte arrestuar me 1 korrik 2004. Me 4 korrik 2004, gjykatësi para-gjyqësor urdhëroi paraburgimin e tij të zgjasë deri më 1 gusht 2004. Sidoqoftë, me 9 gusht 2004, vetëm pesë ditë pas vendimit të gjykatësit para-gjyqësor, kolegji tre-anëtarësh vendosi të zgjasë paraburgimin e të pandehurit për dy muaj të tjerë, dhe potenco i njëjti do të zgjasë deri më 9 shtator 2004.

OSBE është e qëndrimit se gjykata duhet të merr vendime bazuar në rrethanat ekzistuese e jo në ato të ardhme. Pasiqë vendimet e gjykatave për zgjatjen e paraburgimit kanë efekt të menjëhershëm, praktika e parë aktualisht rezulton në tejkalim të autorizimeve nga ana e gjykatave duke e zgjatur paraburgimin për një periudhë esencialisht më të gjatë se ajo që parashikohet me ligj.<sup>57</sup> “Praktika e dytë” jo vetëm që është më logjike dhe e ligjshme - pasi që ajo vlerëson situatën në kohën e marrjes së vendimit - por është gjithashtu në pajtim me parimin që gjykata ta minimizojë përgjithësisht caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurve..

## **B. Mungesa e arsytimit në aktvendimet për zgjatjen e paraburgimit**

Sikurse vendimet fillestare mbi paraburgimet, edhe vendimet mbi zgjatjen e paraburgimit duhet gjithashtu të jenë të arsyetuara në mënyrë të duhur.<sup>58</sup> OSBE ka vërejtur se shumica e konsiderueshme e vendimeve për zgjatjen e paraburgimit nuk ishin të arsyetuara plotësisht. Gjatë shqyrtimit të bazave për paraburgim, gjykatat dështuan të bëjnë analiza serioze përkitazi me qëndrueshmërinë apo ekzistimin e bazave ligjore për paraburgim. Mungesa e specifikimit në këto vendime demonstroi një shqyrtim të pamjaftueshëm të rrethanave të rastit në një fazë relevante të procedurës, e cila e çënon ligjin procedural dhe pengon mundësinë e ankesës.

### **i) Dështimi për ta arsyetuar vazhdimësinë e “dyshimit të arsyeshëm”**

Siç është përmendur më heret, standardet ndërkombëtare theksojnë se vazhdimësia e “dyshimit të arsyeshëm”<sup>59</sup> se i pandehuri ka kryer veprë penale është një kusht *sine qua non* për ligjshmërinë e paraburgimit të zgjatur.<sup>60</sup> Duhet pasur parasysh se provat e caktuara të cilat fillimisht mund ta mbështesin dyshimin e arsyeshëm në fazat e hershme të procedurës penale mund të bëhen më pak relevante me kalimin e kohës, posaçërisht nëse nuk mbështeten me ndonjë material tjetër provues.<sup>61</sup> Andaj gjykatat duhet të vlerësojnë se dyshimi i arsyeshëm vazhdon të ekzistoj, kurdo që duhet të vendosin për ndonjë çështje të paraburgimit.

OSBE ka vërejtur se në shumë raste gjykatat nuk i kanë vërtetuar faktet të cilat rezultojnë në vazhdimësinë e ekzistimit të dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri ka kryer veprë penale, por janë kënaqur thjeshtë me vendimin për fillimin e hetimeve.<sup>62</sup> Kjo praktikë mund të sjellë gjer

<sup>57</sup> Për shembull, në rastin e përmendur në futnotën e mësipërme përkitazi me rastin në Gjykatën e Qarkut në Prizren, kolegji po të kishte aplikuar “praktikën e parë” të llogaritjes së fillimit të vazhimit të paraburgimit nga data e skadimit të vendimit paraprak, do të rezultonte në një situatë evidente kundërligjore të vazhimit të paraburgimit për përafërsisht dy muaj e tri javë.

<sup>58</sup> As ligji i vjetër e as kodet e reja nuk potencojnë në mënyrë eksplicite se çfarë lloj arsytimi duhet të përmbajnë vendimet për vazhdimin e paraburgimit. Sidoqoftë, vendimet mbi paraburgimet duhet të mbulohen nga fushëveprimi i Qarkores Gjyqësore 2000/27, fusnota e mësipërme 48, i cili parasheh që të gjitha vendimet mbi paraburgimet të bëhen në bazë të vendimit me shkrim plotësisht të arsyetuar që detajizon bazat për paraburgim dhe çdo provë mbështetëse në përkrahje të këtyre bazave.

<sup>59</sup> Shiko *Fox, Campbell dhe Hartley v. Britania e Madhe*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 30 gusht 1990, para. 32, i cili thotë se: “me pasë “dyshimin e arsyeshëm” presupozon ekzistimin e fakteve apo informatave të cilat mund të kënaqin një observues objektiv se personi në fjalë mund të ketë kryer veprën.”

<sup>60</sup> Shiko *Stogmuller v. Austria*, fusnota e sipërme 51.

<sup>61</sup> Shiko *Labita v. Italia*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 6 prill 2000, para. 157 ff, ku Gjykata adresoi paraburgimin e të pandehurit mbi bazat e deklaratës së pambështetur nga provat tjera.

<sup>62</sup> Kjo praktikë mund të rrjedhë nga seanca e pestë e përbashkët e Gjykatës Federative, Gjykatave Supreme të republikave dhe krahinave dhe Gjykatës Supreme Ushtarake më 28/12/1976, e cila është adoptuar si Pikëqëndrim Themelor në seancën e 18-të të datës 25 dhe 26/06/1981. Teksti është cituar në Komentarin e Branko Petriqit, fusnota e sipërme 47, mbi nenin 197 LPP RFJ dhe thotë si në vijim: “Kur Gjykata Supreme vendos mbi vazhdimin e paraburgimit, si dhe kur gjykata e shkallës së dytë vendos mbi ankesën e personit të paraburgosur kundër vendimit të kolegjit nga neni 23 (6) LPP RFJ, gjatë vendosjes për paraburgimin apo vazhdimin e afatit, nuk është i autorizuar të vlerësoj ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm se a e ka kryer i paraburgosuri veprën penale.”

te situatat ku personat vazhdojnë të mbahen të paraburgosur edhe kur dyshimi i arsyeshëm ka pushuar të ekzistojë. Rasti në vijim ilustron se sa ekstreme mund të jenë dështimet e gjykatave të qarkut dhe Gjykatës Supreme përkitazi me çështjet e paraburgimit, dhe sa prejudikuese mund të jenë këto për të pandehurin:

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Prizren që përfshinte dymbëdhjetë të akuzuar, të ngarkuar, sipas ligjit të vjetër, me vjedhje të rëndë dhe plaçkitje, një i akuzuar ishte paraburgosur me 12 maj 2001 dhe ishte mbajtur në paraburgim deri më 26 janar 2004, gati gjithsejt dy vite e tetë muaj. Kjo ndodhi përkundër faktit se i pandehuri kishte alibi, respektivisht se ai kishte qenë në paraburgim në ditën e plaçkitjes, të cilën gjë ai e prezantoi kur u dëgjua nga gjyqtari hetues. Edhe pse kjo informatë ishte e mbështetur nga dokumentacioni i Qendrës për paraburgim të Prizrenit, si duket asnjëherë nuk u mor në konsiderim as nga gjykata, e cila e zgjati paraburgimin 15 herë, e as nga gjykata e apelit, e cila e refuzoi katër herë ankesën e mbrojtjes. Për më tepër, gjykata e refuzoi edhe një shqyrtim të jashtëzakonshëm të paraburgimit. Në fillim të seancës kryesore më 26 janar 2004, kolegji gjykues më në fund konsideroi se i akuzuari duhet të lirohet, sepse bazat për mbajtjen e tij në paraburgim kishin pushuar së ekzistuari.

Është e vlefshme të citohet një pjesë nga aktgjykimi i këtij rasti, i datës 4 mars 2004, i cili flet për padrejtësitë e shkaktuara nga dështimet e gjykatës së qarkut dhe asaj supreme:

*“Ne jemi të detyruar që të përmendim disa çështje të tjera që ne mendojmë se duhet t’i përmendim para se të shkëputemi nga kjo çështje pasi që ato tregojnë padrejtësitë e mëdha që janë shkaktuar mbi disa persona në këtë lëndë, dhe të cilat ne shpresojmë nuk do të përsëriten.[...] Kur [njëri nga personat e akuzuar] u paraqit para gjyqtarit hetues më 24 gusht 2001 i akuzuar për pjesëmarrje në kryerjen e veprës penale të grabitjes në bashkëpunim, më 31 korrik 2000 [...] ai i tha gjyqtarit hetues se ai ishte në paraburgim nga data 25 maj 2000 deri më 18 gusht 2000, në Qendrën e paraburgimit në Prizren dhe rrjedhimisht nuk mund të ketë kryer veprën penale të paraqitur kundër tij.*

Gjyqtari hetues ia caktoi paraburgimin dhe rrjedhimisht u zgjat edhe nga kolegji penal dhe nga Gjykata Supreme deri sa shqyrtimi i tij filloi më 19 janar 2004. Nuk ishte bërë asnjë përpjekje që të vërtetohet në Qendrën e paraburgimit të Prizrenit, e cila është e ngjitur me ndërtesën e gjykatës, nëse deklarata e të akuzuarit ishte e vërtetë, dhe nëse do të ishte e vërtetë, a do të kishte pasur ai mundësi që ta kryej veprën që i ngarkohej. Vërtetimi i këtij fakti ishte i rëndësishëm për të konstatuar nëse ekzistonte apo nuk ekzistonte dyshimi i bazuar se i akuzuari kishte marrë pjesë në kryerjen e veprës penale kundër tij. Gjyqtari hetues dhe prokurori e kishin për detyrë që ta zgjidhnin këtë çështje, dhe ishte shumë e theksueshme për të bërë një gjë të tillë, duke pasur parasysh afërsinë e zyrave me policinë, prokurorinë, qendrën e paraburgimit dhe gjykatën. Nuk ishte bërë asnjë përpjekje për ta sqaruar këtë. Prapëseprapë paraburgimi i të akuzuarit u zgjat si zakonisht sikur të ekzistonte dyshimi i bazuar se i akuzuari kishte kryer veprën penale të paraqitur kundër tij. Në shqyrtim prokurori nuk kishte prova për të paraqitur kundër të akuzuarit, dhe në mënyrë jo bindëse, në përfundimin e shqyrtimit, pranoi se i akuzuari [...], kishte qenë në paraburgim në atë kohë, dhe për pasojë nuk mund të kishte kryer veprën penale në fjalë. Ai i hodhi poshtë akuzat kundër tij.

Pas dështimit të qartë gjatë hetuesisë ne jemi të tronditur që prokurori ka mundur ta ngrisë aktakuzën kundër personit i cili shumë qartë nuk mund të kishte kryer veprën penale në fjalë [...]

*Padrejtësia e shkaktuar mbi [të akuzuarin] në këtë lëndë që rezulton me dy vjet e gjysëm paraburgim bën thirrje për korrigjim nga administrata pa prituri për një veprim të mundshëm nga [i akuzuari]. [I akuzuari] nuk duhet të ishte paraburgosur kurrë qoftë edhe për një ditë për një krim që ai nuk mund ta kishte kryer.[...]*

Në fjalën e tij përfundimtare prokurori publik, në përgjigje të kritikës që këto akuza duhet të mos ishin paraqitur nga pikëpamja e provave të zbehta, deklaroi se ishte faji i avokatëve të të

akuzuarve të cilët nuk e kundërshtuan aktakuzën, dhe i trupit gjykues që kishte vazhduar procedurën e gjykimit. Ne me keqardhje vërejmë se se prokurori publik u paraqit krejtësisht i pavëmendshëm gjatë ushtrimit të detyrës së prokurorit për mbrojtjen e interesit publik dhe individual, siç theksohet në nenet 15 dhe 17 (3) të LPP.

*Ne dëshirojmë të theksojmë se përveç padrejtësisë së dukshme që e kanë përjetuar viktimat e këtij lloji të ndjekjes penale, palëve të dëmtuara u janë shkaktuar edhe më tej dëme të panevojshme, [...] Besimi publik në sistemin e drejtësisë është zbehur. Gjykatat, dhe çdonjëri i përfshirë në proces, personat e akuzuar, shteti, dëshmitarët dhe palët e dëmtuara janë shpenzuar në kuptimin material dhe të kohës, e cila do të kishte mundur të shpenzohej diku tjetër për një të mirë më të rëndësishme publike dhe individuale se sa në lëndën me akuza me të meta fatale” (theksi i shtuar)*

OSBE-ja është e mendimit se, sa herë që mirret ndonjë vendim mbi paraburgim, gjykatat duhen ta shqyrtojnë rastin në mënyrë që të sigurojnë se dyshimi i arsyeshëm vazhdon të qëndrojë, dhe jo të mbështetën vetëm në faktin se është marrë vendimi për kreytjen e hetimeve.

### ***ii) Mungesa e arsytimit adekuat për ekzistimin e vazhdueshëm të bazave tjera për paraburgim dhe për pamjaftueshmërinë e masave alternative***

Pasi të konstatohet vazhdimësia e dyshimit të arsyeshëm, në mënyrë që të zgjatet paraburgimi, gjykata gjithashtu duhet të gjejë se vazhdojnë të ekzistojnë një apo më shumë baza për paraburgim. Gjykata gjithashtu mund të gjejë se bazat e reja ose ato plotësuese e arsyetojnë paraburgimin, të cilat ajo duhet veçanërisht t’i sqaroj.<sup>63</sup>

OSBE-ja ka vërejtur se, ngjajshëm me aktvendimet fillestare për paraburgim, në shumicën e aktvendimeve për zgjatjen e paraburgimit gjykatat dështojnë të spjegojnë rrethanat specifike të cilat shfaqin frikën se i pandehuri do të arratisë, asgjësoi provat, kryej ose persërisë veprën penale, ose, sipas ligjit të vjetër, shqetësoj qytetarët. Për më tepër, gjykatat në përgjithësi dështojnë t’i arsyetojnë ose sqarojnë arsyet për të cilat masat alternative janë të pamjaftueshme në atë fazë të procedurës. Në vazhdim janë të dhëne shembujt të cilët ilustronë mungesën e arsytimit të duhur në aktvendimet mbi zgjatjen e paraburgimit, siç janë vërejtur në të gjitha gjykatat e Kosovës. Në mënyrë që t’i ndihmohet lexuesit, teksti është ndarë në seksione që kanë të bëjnë me secilën nga bazat për paraburgim, përveç faktit se shumë nga shembujt mund të bien në më shumë se një seksion.

#### **a) Rreziku nga arratisja**

Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut ka theksuar se ikja nuk mund të mirret si bazë për caktimin e paraburgim vetëm mbështetur mbi bazën e ashpërsisë së dënimit të kërcënuar, por duhet të shqyrtohet mbështetur në një numër faktorësh tjerë relevant.<sup>64</sup> Gjykata evropiane shprehet se, - që kjo arsye të jetë e besueshme, gjykatat vendëse duhet të jepin shpjegime se përse ekziston rreziku për arratisje dhe jo thjeshtë të konfirmojnë paraburgimin në një “formulim identik të mos themi stereotipik fjalësh, pa sqaruar në asnjë mënyrë arsyet për ekzistimin e rrezikut të arratisjes” ose pse ky rrezik nuk është parandaluar përmes masave tjera alternative karshi masës së paraburgimit.<sup>65</sup> OSBE-ja ka vërejtur se shumë shpesh gjykatat nuk e kanë konstatuar në mënyrë të mjaftueshme rrezikun për arratisje, duke cenuar me këtë rast ligjin vendës dhe atë ndërkombëtar.

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë/Priština, sipas ligjit të vjetër, të akuzuarit i ngarkohej vepra “armëmbajtje pa leje”. Ai ishte paraburgosur më 28 dhjetor 2002 mbi bazën e rrezikut nga arratisja, frikën e ndikimit në dëshmitarë dhe mundësinë e shqetësimit të qytetarëve, pa cituar asnjë rrethanë që ndërlihet me to. Më 17 janar 2003, kolegji tre

<sup>63</sup> Shih Branko Petriç, Komentari, fusnota e sipërme 47, në Nenin 197 LPJ

<sup>64</sup> Shih *Yagci dhe Sargin vs Turqisë*, Gjykata Evropiane Për Të Drejtat e Njeriut, 09 Korrik 1995, par.52

anëtarësh ia zgjatë paraburgimin sepse “ekziston frika e bazuar se po të gjendej i akuzuari në liri, do të arratisej dhe do të ishte i paarritshëm për organet e ndjekjes. Kolegji gjithashtu gjeti se ekzistonte mundësia e shqetësimit të qytetarëve, megjithatë nuk citoi asnjë rrethanë që do të mbështeste këtë mendim.

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Gjilan/Gnjilane, i pandehuri ishte ngarkuar me “armëmbajtje pa leje”. Aktakuza ishte ngritur pas hyrjes në fuqi të kodit të ri dhe nuk përfshinte propozimin për paraburgim. Më 23 prill 2004, kolegji i përbërë prej tre anëtarëve vendosi *ex-officio* që ta zgjasë paraburgimin, sepse konstatoi se: “ ekzistojnë ende rrethanat e tilla të cilat e arsyetojnë frikën e bazuar se po qe se i kuzuari do të ndodhej në liri, duke analizuar peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat se si ajo është kryer, [kolegji] vlerëson se ai do të mund të arratisej apo të përsërisë veprën penale”. Përveç mosarsyetimit të duhur të rrezikut nga ikja ose frikës nga përsëritja e krimit, ky urdhër nuk referoi mundësinë e aplikimit të masave alternative karshi masës së paraburgimit. Më 07 qershor 2004, i akuzuari u dënua me dy muaj e pesëmbëdhjetë ditë burg, që plotësisht i përgjigjet kohës së kaluar në paraburgim, dhe u urdhërua lirimi i tij i menjehershëm.

## **b) Rreziku i ndikimit në dëshmitarë apo asgjësimit të dëshmitarëve**

Sa i përket rrezikut të ndikimit në dëshmitarë apo të bashkakuzuar, Gjykata evropiane ka gjetur se, edhe pse ky rrezik mund të jetë i vërtetë në fillim të paraburgimit, ai mund të zvogëlohet gradualisht apo të zhduket fare.<sup>66</sup> Sa i përket legjislacionit vendës, të dyja ligjet, si ai i vjetri ashtu edhe ky i ri, e lejojnë caktimin e paraburgimit në qoftë se ka baza për të besuar se i pandehuri mund t'i asgjësoi dëshmitë ose nëse ekzistojnë rrethana specifike të cilat tregojnë se mund të ndikohet në dëshmitarë dhe palë tjera.<sup>67</sup> Paraburgimi i caktuar mbi këto baza, do të duhej ndërprerë sapo të jetë marrë ose siguruar prova në bazë të të cilës është caktuar paraburgimi në rend të parë.<sup>68</sup> Për këtë shkak, në mënyrë që të merret kjo si bazë për caktimin e paraburgimit ose zgjatjen, gjykata do të kënaqet se rrethanat e caktuara flasin për rrezikun e asgjësimit të provave, dhe t'i përmendin ato në vendimet e tyre për zgjatjen e paraburgimit. OSBE-ja ka vërejtur se në shumicën e aktvendimeve për zgjatjen e paraburgimit thjeshtë citohet teksti i dispozitës ligjore dhe mungojnë referencat për çfarëdo rrethane specifike.

Në një rast të gjykuar sipas ligjit të vjetër pranë Gjykatës së Qarkut në Gjilan/Gnjilane, i pandehuri ishte ngarkuar për tentim dhunimi dhe ishte paraburgosur më 10 prill 2003 mbi bazën e rrezikut nga ikja, rrezikut të asgjësimit të dëshmitarëve dhe ndikimit në dëshmitarë. Më 10 maj 2003, kolegji tre anëtarësh ia zgjati paraburgimin sepse, për shkak të “arsyeve objektive”, dy dëshmitarë (të emruar) nuk ishin dëgjuar dhe nuk ishte kryer analiza e gjakut e palës së dëmtuar. Gjykata shtoi se “po qe se i dyshimti do të ndodhej në liri ai do t'i pengonte hetimet duke ndikuar në dëshmitarë ende të padëgjuar”. Gjykata gjithashtu përmendi se ekzistonte frika nga ikja dhe përsëritja e veprës penale. Do të mund të shënohej se më 12 maj 2004 ankesa e mbrojtësit ka përmendur se dy dëshmitarët e “padëgjuar” kanë qenë të propozuar nga ana e mbrojtjes. Në fakt, provat nga lënda tregojnë se dëshmitarët faktikisht ishin dëgjuar më 07 maj 2003, tri ditë para se të merrej vendimi mbi zgjatjen e paraburgimit. Është interesante se Gjykata Supreme me vendim e ka refuzuar ankesën më 19 maj 2003 duke e ritheksuar konstatimin e gabuar se dëshmitarët nuk janë dëgjuar.

Në një rast para Gjykatës Komonale në Gjilan/Gnjilane i akuzuari ishte ngarkuar me vjedhje të rëndë dhe ishte paraburgosur më 21 mars 2004. Pas ngritjes së aktakuzës më 09 prill 2004 në bazë të kodit të ri, kolegji tre anëtarësh e ka rishqyrtuar paraburgimin e të pandehurit në mungesë të propozimit nga prokurori dhe e ka zgjatur atë për dy muaj sepse “ende ekzistojnë arsytet nga neni 281 (2) pikat 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, sipas të cilit ekziston frika e arsyeshme

<sup>66</sup> Shih parimin në rastin *Tomasi vs Francës*, ibid, paragrafët 92-95

<sup>67</sup> Paragrafët 191(2) pika (2) LPPJ dhe 281 (1) nënpar. (2)(ii) KPPP

<sup>68</sup> Paragrafët 191(3) LPPJ dhe 281 (2) KPPP.

se i dyshimti do t'i shmangej procedurës penale dhe ta përsërisë veprën penale duke e penguar në këtë mënyrë zhvillimin normal të procedurës penale". Aktvendimi nuk ka përmendur ndonjë rrethanë të veçantë që do të mbështeste ndonjëherë nga këto baza, përderisa bëri vetëm një referencë numerike për frikën lidhur me ndikim në dëshmitarë. Për më shumë, në aktvendim as që është bërë ndonjë referencë për zbatimin e masave alternative kundrejt paraburgimit.

### c) Frika nga kryerja e veprave tjera penale

Në lidhje me rrezikun e vazhdimin të kriminalitetit si bazë për paraburgim në krimet serioze, Gjykata evropiane ka gjetur se, krahas kushteve tjera, rreziku duhet të jetë i arsyeshëm dhe masë adekuate sa i përket rrethanave të rastit dhe në veçanti historikun dhe personalitetin e personit për të cilin bëhet fjalë.<sup>69</sup> Megjithatë, OSBE-ja ka vërejtur se gjykatat dështojnë t'i vërtetojnë bazat e dhëna.

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Pejë/Peć, sipas ligjit të vjetër, i akuzuari ishte ngarkuar me rrezikimin e sigurisë së personave dhe posedim illegal të armëve. Më 15 maj 2003, kolegji i gjykatës së qarkut e zgjati paraburgimin e tij për shkak të frikës së ndikimit në dëshmitarë dhe shtoi se: "pasi që vepra penale ka mbetur në tentativë, frika e bazuar ekziston se, po që se i pandehuri do të ndodhej në liri, ai do ta përfundonte veprën". Prapseprapë, kolegji nuk ka dhënë asnjë shpjegim, madje as për veprën për të cilën qëndronte frika se do të përfundohej. Më 23 korrik 2003, i pandehuri u shpall fajtor për dy pikat, u dënua me një masë dënimi prej një viti heqje lirie dhe u lirua nga paraburgimi.

Në një rast para Gjykatës Komonale në Gjiilan/Gnjilane, të gjykuar sipas kodit të ri, i akuzuari ishte arrestuar më 30 qershor 2004 dhe ishte ngarkuar me blerje, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të substancave narkotike dhe psikotropike. Pas ngritjes së aktakuzës e cila nuk propozonte zgjatjen e paraburgimit, kolegji i përbërë nga tre anëtarë, ia zgjati paraburgimin më 05 korrik 2004, duke "konstatuar *ex-officio* se ekzistojnë arsytet ligjore nga neni 281 (1) pika 2 (iii) të KPPPK-së në bazë të së cilave ekziston frika e bazuar se i pandehuri do të përsëriste veprën penale dhe në këtë mënyrë do të pengonte zhvillimin e mëtutjeshëm normal të procedurës penale. Pas administrimit të provave dhe dokumentacionit në lëndën penale, kolegji i kësaj gjykate konstatoi se zgjatja e paraburgimit edhe për dy muaj ishte e arsyeshme ..." aktvendimi mbi zgjatjen e paraburgimit nuk përmendi asnjë rrethanë specifike për ta arsyetuar thirrjen në bazat e paraburgimit. Gjithashtu, nuk i referohet aplikueshmërisë së masave alternative kundrejt paraburgimit ose nuk shpjegon pse këto masa nuk do të mjaftonin. I akuzuari u shpall fajtor, u dënua me një vit burgim dhe u lirua nga paraburgimi sepse bazat për paraburgim pushuan së ekzistuari.

Siç mund të shihet nga shembujt më lart, gjykatat shpesh e zgjatën paraburgimin pa u referuar në rrethanat e veçanta të cilat i nxisin ata të vendosin se paraburgimi vazhdon të jetë i domosdoshëm. Në shumicën e rasteve gjykatat dështojnë madje edhe të përmendin pse nuk janë aplikuar masat alternative.<sup>70</sup> Veçanërisht kur ka pasur ndryshime në rrethanat e ndonjë rasti, gjykata do të duhej që në aktvendimin e vet të shpjegojë se si këto rrethana mund të kenë efekt në paraburgimin e të akuzuarit e veçanërisht a do të mund të aplikoheshin masat alternative kundrejt paraburgimit. Me mosarsyetimin e duhur të vendimeve të tyre, gjykatat dështojnë ti përmbushin standardet e gjykimit të drejtë dhe procesit të duhur, edhe në rastet kur vendimet për vazhdimin e paraburgimit parajyqësor janë me vend sipas rrethanave aktuale.

<sup>69</sup> Shih *Clooth v. Belgjikës*, Gjykata Evropiane për Të Drejtat e Njeriut, 12 Dhjetor 1991, par. 40

<sup>70</sup> Është paradoksale se në raste të numërta, para shpalljes së aktgjykimit, derisa i pandehuri konsiderohet i pafajshëm, paraburgimi lehtë mund të gjindet si i bazuar, ndërsa pasi që i njeiti i pandehur shpallet fajtor, Gjykata konsideron se bazat për mbajtjen e tij në paraburgim pushojnë së ekzistuari.



#### IV. ÇËSHËTJET E KUNDËRSHTIMIT TË AKTVENDIMIT PËR PARABURGIM

Standardet ndërkombëtare e parashikojnë të drejtën e secilit person të cilit i është hequr liria, që gjykata në mënyrë të shpejtë ta shqyrtojë ligjshmëria e mbajtjes së tij/saj në burg<sup>71</sup>. Në mënyrë që kjo e drejtë të jetë efektive kërkohet që i paraburgosuri të informohet mbi arsyet për mbajtjen e tij/saj në burg.<sup>72</sup>

Legjislacioni vendës parashikon të drejtën e ankesës kundër aktvendimeve për paraburgim<sup>73</sup> dhe të drejtën që të parashtrimit në çdo kohë të propozimit për shqyrtimin e ligjshmërisë së paraburgimit (të njohur gjithashtu si propozimi/kërkesa *habeas corpus*).<sup>74</sup> Aktvendimi mbi ankesë merret në seancë të udhëhequr nga kolegji ankimor, ndërsa vendimi mbi propozimin *habeas corpus* mund të kërkojë edhe dëgjimin e palëve.

Kjo pjesë i trajton çështjet si në vijim:

- Mungesa e arsytimit në vendimet mbi ankesat kundër aktvendimeve për paraburgim; në menyrë më specifike, vendimet mbi ankesat:

- i) nuk i marrin parasysh në mënyrë adekuate argumentet e mbrojtjes,
- ii) dështojnë t'i adresojnë individualisht argumentet e të bashkakuzuarve,
- iii) dështojnë ta sqarojnë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm si kusht për paraburgim, dhe
- iv) dështojnë ta pranojnë (ta bëjnë të njohur) mungesën e arsytimit në vendimet e ankuara;

- vonesat për marrjen e vendimit mbi ankesat kundër aktvendimeve për paraburgim;
- faktin se procedura ankimore mund të shkelë barazinë e armëve
- problemet e caktuara lidhur me kërkesën/propozimin *habeas corpus*.

##### A. Mungesa e arsytimit në vendimet mbi ankesat kundër aktvendimeve për paraburgim

Sikurse aktvendimi i parë për caktimin e paraburgimit, për zgjatjen e tij si dhe aktvendimi mbi ankesën duhet të jenë të arsyetuara në mënyrë të duhur<sup>75</sup>. Megjithatë, OSBE-ja ka vërejtur se në vend se të funksionojë si garancë për të akuzuarin që ta kundërshtoj ligjshmërinë e aktvendimeve të mëparshme për paraburgim, është gjë e zakonshme në praktikën e vendosjes sipas ankesë të gjykatave që t'i "bijnë vulë" aktvendimeve të atakuara dhe që t'i ripërsërisin frazat stereotipe. Këtë dukuri e ilustron edhe më tej kategoritë e shembujve të paraqitur si më poshtë.

<sup>71</sup> Neni 5 (4) KEDNJ.

<sup>72</sup> Gjykata Europiane gjithmonë ka urdhëruar që: "është primare për autoritetet vendëse juridike të sigurojnë se, në rastin e dhënë, paraburgimin i personit të akuzuar të mos e tejkalojë kohën e arsyeshme. Në këtë rast ata duhet t'i shqyrtojnë të gjitha faktet që argumentojnë për ose kundër ekzistimit të nevojës së vërtetë të interesit publik duke justifikuar se, me gjithë konsideratë ndaj parimit për supozimin e pafajshmërisë, një nisje nga rregulli i respektit për lirinë e individit dhe t'i vendosin ato në vendimet e tyre duke i shkarkuar aplikacionet për lirim. Është parimisht bazuar në arsyet e dhëna në këto vendime dhe në faktet e vërteta të përmendura nga aplikanti në ankesat e tij së Gjykata është e thirrur të vendos nëse apo jo ka pasur shkelje të Nenit 5(3) të Konventës." Shih *Labita vs Italisë*, fusnota e sipërme 61, par.152

<sup>73</sup> Nga Kodi i vjetër, shih *Nenet 192,197,199 (3), 395 (2) dhe 394 (4) të LPPJ-së*. Nga Kodi i ri, shih *Nenet 283 (3), 285(5) dhe 287 KPPP*.

<sup>74</sup> Neni 286 (2-4) KPPP

<sup>75</sup> Shih *Qarkoren Gjyqësore 2000/27*, fusnota e sipërme 48.

### *i) Mos dëgjimi i argumenteve të mbrojtjes*

Shpesh, kolegjet ankimore nuk i arsyetojnë në mënyrë të duhur vendimet mbi ankesat kundër paraburgimit dhe madje nuk i përmendin argumentet e paraqitura nga paraqitësi i ankesës.

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Pejë/Peç , të gjykuar sipas ligjit të vjetër, i akuzuari ishte ngarkuar me rrezikim të sigurisë së personave dhe posedim apo përdorim ilegal të armëve. Pas ngritjes së aktakuzës, paraburgimi ishte zgjatur më 20 qershor 2003 vetëm mbi bazën se, po qe se do të gjendej në liri, i akuzuari do të shkaktonte shqetësim tek qytetarët. Kjo bazë ishte paraqitur në këtë fazë për të parën herë. Më 23 qershor 2004 mbrojtja u ankua kundër urdhërit gjithashtu duke potencuar se arsyetimi për këtë bazë nuk ishte i përshtatshëm, veçanërisht pasi që marrëveshja mbi pajtim ishte arritur në mes të akuzuarit dhe palës së dëmtuar i cili për më shumë kërkoi lirimin e të paraburgosurit dhe kjo ekzistonte në dokumentacionin e lëndës. Vendimi i Gjykatës Supreme mbi ankesën, i datës 27 qershor 2004, as që e përmend këtë fakt, refuzoi ankesën dhe përsëriti arsyetimin e aktvendimit të Gjykatës së Qarkut.

Në një rast para Gjykatës Komunale në Prishtinë/Pristina, i akuzuari ishte ngarkuar për veprën e mashtrimit sipas kodit të ri. Rasti u gjykua me procedurë të shkurtër në bazë të padisë private.<sup>76</sup> Më 10 shtator 2004 gjyqtari i procedurës paraprake urdhëroi paraburgimin e tij për pesëmbëdhjetë ditë. Më 23 shtator 2004, kolegji i përbërë prej tre gjyqtarëve në propozim të prokurorit ia zgjati paraburgimin edhe për një muaj për shkak të rrezikut të arratisjes dhe ndikimit në dëshmitarë. Më 24 shtator 2004, mbrojtja është ankuar ndaj aktvendimit të kolegjit duke potencuar në mënyrë eksplicite, *në mes tjerash*, se në rastet e tilla ligji nuk parashikonte zgjatjen e paraburgimit më tepër se pesëmbëdhjetë ditë, para ngritjes së propozim akuzës (e cila nuk ishte ngritur në atë kohë); kështu që aktvendimi për zgjatjen e paraburgimit ishte i kundërligjshëm dhe i pavlefshëm. Gjykata e Qarkut e refuzoi ankesën më 07 tetor 2004 thjeshtë duke e përsëritur se ekziston rreziku i arratisjes dhe ndikimit në dëshmitarë. Propozim akuza është dorëzuar në gjykatë më 08 tetor 2004.

Në një shembull të mëvonshëm, paraburgimi i të akuzuarit ishte vazhduar nga kolegji për një muaj, pa marrë parasysh faktin se deri në atë kohë nuk ishte ngritur propozim akuza dhe pa pasur në konsideratë faktin se kishte kaluar maksimumi i kufirit kohor prej pesëmbëdhjetë ditësh paraburgim. Si pasojë, jo vetëm që propozimi i prokurorit ishte i papabazë, por edhe kolegji nuk kishte të drejtë ta zgjaste atë. Çka është edhe më tepër për t'u vërejtur është ajo se mbrojtja e kundërshtoi urdhërinë e përmendur duke demonstruar se ai ishte dukshëm i paligjshëm por gjykata duket se ose dështoi ta lexoj ankesën apo totalisht e injoroi faktin se ky rast do të vazhdohej me procedurë të shkurtuar.

### *ii) Dështimi i gjykatës ankimore që individualisht (ndarazi) t'i shqyrtojë argumentet e të bashkakuarve*

Në rastet me më shumë se një të pandehur të paraburgosur, kur mbrojtja e tyre ankohej kundër urdhërave për paraburgim, Gjykatat ankimore zakonisht i merrnin në konsideratë të gjitha ankesat në një vendim unik duke i përmendur bazat e përgjithshme dhe abstrakte për ta arsyetuar paraburgimin; argumentet dhe rrethanat e veçanta të secilit akuzuar nuk ishin paraqitur veç e veç. Praktika gjyqësore ndërkombëtare thotë se kur bazat për paraburgim janë të dhëna në këtë kontest, ato janë të pamjaftueshme ta arsyetojnë vazhdimin e paraburgimit.<sup>77</sup> Në vijim janë të dhënë shembujt e zgjedhur që reflektojnë këtë praktikë e cila ekziston në tërë Kosovën.

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Gjilan/Gnjilane, personat e akuzuar ishin ngarkuar me ligjin e vjetër për vrasje, pjesëmarrje në grup që kryen vrasje dhe marrëveshje për të kryer

<sup>76</sup> Procedura e shkurtuar aplikohet para Gjykatës Komunale për krimet ku dënimi i kërcënuar është gjoba apo burg prej tre vjetësh; shih Nenet 461 ff KPPP.

<sup>77</sup> Shih *Labita vs Italisë*, fusnota e sipërme 61, par.163

vrasje. Mbrojtësit e të katër akuzuarve parashtruan ankesa të veçanta kundër aktvendimit të kolegjit për zgjatje të paraburgimit të marrë me 04 qershor 2004. Ankesat dhanë një llojllojshmëri argumentesh dhe veçuan rrethana të ndryshme personale për secilin të akuzuar, për shembull, njëra prej këtyre ankesave, datuar më 18 qershor 2004, gjerësisht kundërshtoi vazhdimin e paraburgimit për shkak të përcaktimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkëljes së procedurës penale.<sup>78</sup> Gjykata Supreme, me një vendim të shkurtër, datuar më 12 korrik 2004, refuzoi të gjitha katër ankesat si të pabazuara dhe përsëriti arsyet e njejtë të përgjithësuara siç ishin ato në aktvendimin për vazhdim.

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Pejë/Peć, dy të pandehur u arrestuan më 02 maj 2004 dhe sipas kodit të ri u ngarkuan për veprat penale të pjesëmarrjes në grup që kryen vepra penale, që nxisin urrejtje nacionale, racore, fetare dhe etnike, grindje dhe jotolerancë, derisa njëri prej tyre ngarkohej edhe me posedim ilegal armësh. Më 31 maj 2004, kolegji prej tre anëtarësh vendosi që të vazhdoi paraburgimin e të dyshuarve edhe për dy muaj tjerë.<sup>79</sup> Mbrojtësit e dy të akuzuarve parashtruan ankesa të veçanta kundër këtij vendimi, duke ngritur llojllojshmëri argumentesh disa prej të cilave dallonin njëra nga tjetra.<sup>80</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, datuar më 22 qershor 2004 tha se pajtohej me vendimin e kolegjit tre anëtarësh se: “ende ekziston rreziku i vazhdueshëm se të dyshuarit do të mund të arratiseshin po që se lirohen në këtë fazë të procedurës. Kolegji e bazoi konkluzionin e tij në ekzistimin e rrezikut nga ikja, në dëshmi dhe fakte specifike dhe të mjaftueshme”. Veç kësaj, Gjykata Supreme konkludoi se kolegji ka gjetur drejtë se ekzistonte rreziku nga ndikimi në dëshmitarë dhe të tjerë, dhe e përfundimit të veprave penale në fjalë.<sup>81</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme nuk i ka përfshirë argumentet e mbrojtjes. Për më shumë, në mënyrë paradoksale mendoi se Kolegji tre anëtarësh në dëshmi të mjaftueshme e mbështeti mendimin e vet në rrezikun nga ikja, edhe pse ky i fundit as që e përmendi rrezikun nga ikja, e si pasojë del se Gjykata Supreme as që e morri parasysh vendimin e atakuar.

### *iii) Dështimi për ta ekzaminuar ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm si kusht për caktimin e paraburgimit*

Vendimet mbi ankesat vazhdimisht dështuan të konsiderojnë ekzistimin ose vazhdueshmërinë e “dyshimit të arsyeshëm” ndaj të akuzuarit të paraburgosur, përkundër faktit që shumë ankesa prezentuan fakte konkrete mbi këtë. Gjykatat sikur vazhdonin me supozimin se, pasi që ekzistonte vendimi valid mbi zhvillimin e hetimeve, kolegji i ankesës nuk (apo nuk duhej të)

---

<sup>78</sup> Kjo ankesë argumentoi se vendimi për të vazhduar paraburgimin nuk i morri parasysh rrethanat personale she karakterin e të akuzuarit në fjalë, se bazat e dhëna për vazhdimin e paraburgimit ishin shumë abstrakte dhe të përgjithësuara, se supozimi i pafajësisë ishte shkëlur me zgjedhjen e fjalëve në vendimet e mëparshme, dhe se autoritetet nuk treguan kujdes në prodecimin me gjykim. Për më shumë, veçanërisht kritikoi se vendimi për vazhdimin e paraburgimit u morr duke aplikuar bazat për paraburgim përgjithësisht për të gjithë të akuzuarit, në shkëlje të ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriu

<sup>79</sup> Kolegji prej tre anëtarësh as që bëri referencë numerike për asnjërën nga bazat për paraburgim, por tha se “bazat mbi të cilat paraburgimi ishte mbështetur në vendimet e mëparshme të Gjyqtarit Hetues dhe Kolegjit tre anëtarësh nuk pushuan së ekzistuari [!].” Pas kësaj, kolegji bëri disa komente abstrakte në ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm, në udhëheqjen e shpejtë të hetimeve, dhe deklaroi se e ruajti arsyetimin e vendimeve të mëparshme për shkak të rrezikut nga ndikimi në dëshmitarë dhe përsëritja e veprave penale.

<sup>80</sup> Për shembull, njëra prej ankesave argumentoi gjerësisht se vendimit mbi vazhdimin e paraburgimit i mungonte arsyetimi i duhur, i cili vetëm ishte abstrakt, se kolegji nuk duhej t'i shmangej vlerësimit të vazhdimësisë së dyshimit të bazuar, se nuk kishte rrethanat që do tta justifikonin frikën nga ndikimi në dëshmitarë, se i pandehuri më parë nuk ishte i dënuar dhe se nuk kishte rrethana që tregonin rrezikun nga përsëritja e veprës penale, përderisa ankesa i referohej edhe disa rrethanave tjera specifike. Ankesa tjetër përqendrohej në mungesën e dyshimit të arsyeshëm në bazë të dëshmitëve të prezantuar, pohonte se dëshmitë nuk e kërcnonin rrezikun e përsëritjes së veprës, dhe gjithashtu përmendi fakte specifike sa i përket rastit të të akuzuarit në fjalë.

<sup>81</sup> Në të vërtetë, vendimet e mëparshme i referoheshin rrezikut të përsëritjes së veprave penale dhe jo të përfundimit të veprave në fjalë siq u përmend nga Gjykata Supreme.

shqyrton dyshimin e arsyeshëm, sepse ajo çështje është vendosur më parë.<sup>82</sup> Në raste të caktuara gjykatat refuzuan të ekzaminojnë vazdueshmërinë e dyshimit të arsyeshëm si kusht për vazhdimin e paraburgimit pa dhënë arsytim konkret për këtë refuzim, edhe pse mbrojtja në mënyrë specifike e ka sfiduar dyshimin e arsyeshëm në ankesat e tyre. Rasti i mëposhtëm shërben si shembull i kësaj praktike:

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Gjiilan/Gnjilane sipas ligjit të vjetër, personat e akuzuar kanë qenë të ngarkuar me vrasje, pjesmarrje në grup që bën vrasje dhe për marrëveshje për të vrarë. Mbrojtësit e të katër akuzuarve parashtuan ankesë kundër vendimit mbi zgjatjen e paraburgimit të pandehurve të datës 4 qershor 2004. Në mes të argumenteve të tjera, mbrojtja sfidoi ekzistimin e vazdueshëm të dyshimit të arsyeshëm kundër klientëve të saj; mbrojtësit pretendonin që ky ishte i bazuar vetëm në deklaratën e një bashkë-akuzuari, i cili më vonë e tërhoqi atë deklaratë, derisa kjo deklaratë nuk ishte e mbështetur me asnjë prove tjetër. Më 12 korrik 2004, Gjykata Supreme refuzoi ankesat dhe tha: “Sa për argumentet e mbrojtjes të paraqitura në ankesë lidhur me gjendjen faktike, këto nuk mund të jenë subjekt i shqyrtimit në këtë fazë të procedurës” (përkthim jo zyrtar).

Është e paqartë pse kolegjet që shqyrtojnë ankesat mbi paraburgimin nuk i ekzaminojnë argumentet e mbrojtjes ndaj ekzistimit të dyshimit të arsyeshëm. Gjykata evropiane ka gjetur se garancat e nenit 5 (4) të KEDNJ do të humbin substancën e tyre nëse gjyqtari i trajton si irrelevante, ose nuk i përfill, faktet konkrete të paraqitura nga i paraburgosuri dhe i aftë për të vënë në dyshim kushtet qenësore për “ligjshmërinë” e privimit nga liria.<sup>83</sup>

***iv) Dështimi për ta njohur (pranuar) mungesën e arsytimit të vendimit të atakuar me ankesë***

Një numër i madh i ankesave sfidoi vendimet mbi paraburgimin me bazë që vendimi nuk ka qenë i arsyetuar në mënyrë të rregullt, gjë që paraqet shkelje qenësore të procedurës. Mirëpo, gati asnjë gjykatë ankimore as nuk e muar në konsiderim këtë argument në vendimet e saj, e le më ta pranojë. Më saktë, gjykatat ankimore thjeshtë përsëritnin ekzistimin e bazave substanciale për paraburgim.

Në një rast, sipas kodit të vjetër, pranë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, më 13 Janar 2004 mbrojtësi parashtroi ankesë kundër vendimit mbi paraburgim të datës 12 janar 2004. Ankesa ceku shkelje qenësore të procedurës penale, në esencë mungesën e arsytimit konkret të vendimit dhe vërtetimin e gabuar të gjendjës faktike. Më 14 Janar 2004, në vendimin me të cilin refuzoi ankesën, gjykata e qarkut dështoi të marrë në konsideratë argumentin se ka patur mungesë të arsytimit.

Në një rast pranë Gjykatës së Qarkut në Pejë/Pec, i akuzuari ishte arrestuar më 27 janar 2004. Pas parashtimit të aktakuzës, dhe sipas procedurës së re, më 26 korrik 2004 kolegji i treve e vazhdoi paraburgimin e të akuzuarit për dy muaj sepse ekzistonte frikë e bazuar që i akuzuari mund të arratiset për ti shmangur procedurës penale dhe dënimit [të lartë]. Më 29 korrik mbrojtësi parashtroi ankesë për shkak të aplikimit të gabuar të ligjit dhe mungesës së arsytimit konkret. Më 4 gusht 2004, kolegji i Gjykatës Supreme refuzoi ankesën pa konsideruar fare argumentin se vendimit i mungonte arsytimi i duhur.

<sup>82</sup> Për arsyën e mundshme të këtij fenomeni, shih më sipër futnotën 62.

<sup>83</sup> Shih rastin *Ilijkov kundër Bullgarisë*, Gjykata Evropiane e Drejtave të Njeriut, 26 Korrik 2001, para.94 ff.

Si shihet nga rastet e mësipërme, gjykatat ankimore dhe Gjykata Supreme dështuan të adresojnë çështjen e arsytimit jo të rregullt të vendimit mbi paraburgimin, edhe në rastet kur kjo çështje u ngrit nga ankuesi<sup>84</sup>.

Ne përfundim, sa i përket paraburgimit vendimet e gjykatës ankimore- pa marrë parasysh se ato mund të jenë substancialisht korrekte- në përgjithësi, të arsyetuara në mënyrë jo adekuate. Duke patur parasysh që shumica e ankesave ndaj vendimeve mbi paraburgimin refuzohen derisa edhe vendimet mbi ankesën janë të arsyetuara në mënyrë të duhur, duket sikur argumentet e mbrojtjes nuk janë duke u marrë parasysh në mënyrë të rregullt. Për më tepër, duke dështuar të marrin në konsideratë argumentet e mbrojtjes lidhur me ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm, gjykatat ankimore mund të përjetësojnë situatat e paraburgimit jo të ligjshëm. Së fundi, duke mos e kritikuar mungesën e arsytimit të vendimeve mbi paraburgimin të gjykatave të ulta, Gjykata Supreme nuk e përmbush rolin e saj të udhëzimit të tyre dhe në këtë mënyrë mund të kontribuojë praktikës së nxjerjes së vendimeve jo të arsyetuara mbi paraburgimin. Kjo praktikë përfundimisht mund të shpiej në cenimin e të drejtës në liri.

## **B. Vonesat në vendosjen mbi ankesat kundër vendimeve për caktimin e paraburgimit**

Çdonjeri i privuar nga liria ka të drejtë të ndërmarrë procedurë me të cilën ligjshmëria e paraburgimit të tij ose saj do të “vendoset shpejtë” nga gjykata<sup>85</sup>. Për dallim prej kodit të vjetër<sup>86</sup>, procedura e re penale në mënyrë eksplicite parasheh që ankesat kundër vendimeve mbi caktimin e paraburgimit, si dhe të atyre mbi zgjatjen e tij, “do të vendosen brenda dyzet e tetë orëve nga momenti i parashtrimit të ankesës”<sup>87</sup>. Pavarësisht nga këto dispozita, OSBE-ja ka regjistruar raste, në të cilat afati për vendosjen mbi ankesat kundër vendimit mbi paraburgimin nuk është respektuar:

Në një rast pranë Gjykatës së Qarkut në Pejë/Peć, dy të pandehur, të arrestuar më 2 maj 2004, u ngarkuan me pjesmarrje në grupin që kryen veprë penale, nxitje të urrejtjes kombëtare, racore, fetare, mosdurimit dhe jo tolerances, deri sa njeri nga ata ishte ngarkuar edhe me posedim të paligjshëm të armëve. Më 31 maj 2004, kolegji tre anëtarësh vendosi të zgjasë paraburgimin e të dyshuarve edhe për dy muaj. Ditën e njejtë, njeri nga mbrojtësit parashtroi ankesë kundër vendimit, deri sa të tjerët e bënë këtë më 2 qershor 2004.<sup>88</sup> Më 4 qershor 2004, prokurori publik i qarkut u përgjegj në njerën nga ankesat. Edhe pse Gjykata Supreme duhej të vendoste mbi ankesat brenda

<sup>84</sup> Duhet të përmendet që gjatë vendosjes mbi ankesat kundër *aktgjykimeve*, gjykata ankimore është e obliguar të shqyrtojë edhe *ex officio* disa çështje, përfshirë ato që a janë bazat e aktgjykimit të mbështetura nga provat materiale; shih nenin 415 (1) KPPP.

<sup>85</sup> Shih Nenin 9 (4) KNDCP dhe 5 (4) KEDNJ. Gjykata Europiane ka sqaruar se kur instanca e dytë ka kompetencë për ankesat kundër paraburgimit, Shteti duhet në princip ti japë të paraburgosurve garancat e njëjta për ankesë sikurse edhe instanca e parë; shih *Toth kundër Austrisë* Gjykata Europiane e Drejtave të Njeriut, 12 Dhjetor 1991, para.84

<sup>86</sup> Kodi i vjetër në mënyrë specifike parashihte drejtën e ankesës kundër vendimit të parë mbi paraburgimin mbrenda 24 orëve prej pranimit të vendimit, derisa mbi ankesën duhej të vendosej mbranda 48 orëve. Ankesa mbi vendimet mbi zgjatjen e paraburgimit mund të parashtrohej mbrenda tre ditëve prej pranimit të tij, përderisa nuk ka patur afat kohor të caktuar mbrenda të cilit duhej të vendosej mbi këtë ankesë. Ankesa nuk ishte e lejuar kundër vendimeve mbi zgjatjen e paraburgimit të marra nga Gjykata Supreme. Shih Nenet 192, 197, 199 (3), 395 (2) dhe 394 (4) LPP.

<sup>87</sup> Sipas procedurës së re, ankesa kundër vendimit mbi paraburgimin duhet të parashtrohet mbrenda 24 orëve pas pranimit të njejtut. Ankesa duhet ti dorëzohet edhe palës tjetër, e cila mbrenda 24 orëve pas pranimit mund ti parashtrojë argumentet e saj para gjykatës. Mbi ankesën duhet të vendoset mbrenda 48 orëve nga parashtrimi i saj; shih Nenet 283 (3), 285 (5) dhe 287 KPPP.

<sup>88</sup> Datat e cekura janë të marra nga ankesat. Megjithatë, Gjykata Supreme në vendimin e saj i referohet këtyre sipas datës 3 Qershor 2004.

48 orëve pas parashtrimit të tyre,<sup>89</sup> ajo këtë nuk e bëri deri më 22 qershor 2004, përafërsisht 20 ditë pas parashtrimit të ankesës.

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Prizren, të dyshuarit u ballafaquan me akuzat e nxitjes së urrejtjes kombëtare, raciale, religjioze dhe etnike, mos-durimit dhe jotolerancës, të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm dhe të pjesëmarrjes në grupin që kryen veprën penale. Ata ishin arrestuar me 5 prill 2004. Me 4 maj 2004 kolegji tre-anëtarësh vazhdoi paraburgimin e tyre për dy muaj të tjerë, përderisa në të njëjtën date, njëri prej avokatëve mbrojtës të njërit prej të pandehurve u ankua kundër këtij vendimi. Gjykata Supreme muar vendimin e vet mbi ankesën tek me 12 maj 2004, gjashtë ditë pas afatit, duke e kthyer dosjen tek kolegji tre-anëtarësh për të rishqyrtuar çështjen e paraburgimit. Më 17 maj 2004, kolegji tre-anëtarësh vendosi sërish për të vazhduar paraburgimin e të dyshuarit. I njëjti avokat mbrojtës u ankua përsëri kundër vendimit të fundit më 18 maj 2004, por Gjykata Supreme nuk muar vendim deri më 27 maj 2004, shtatë ditë pas afatit.

Në rastin e përmendur më lart, Gjykata Supreme nuk iu përmbajt afatit të përcaktuar për vendosjen mbi ankesat kundër paraburgimit, dhe nuk veproi me urgjencën e domosdoshme e cila duhet ti ofrohet rasteve të personave të paraburgosur.

### C. Cënimi i parimit të barazisë së armëve në procedurën sipas ankesës

OSBE ka vërejtur se në raste të ndryshme të ankesave kundër vendimeve për paraburgim, dispozitat e aplikueshme të kodit të ri dhe praktika gjyqësore pasuese nuk e respektojnë parimin e barazisë së armëve.<sup>90</sup> Kjo është sepse prokuroria ka dy mundësi për të paraqitur argumentet – së pari perms prokurorit të qarkut dhe së dyti perms prokurorit public të Kosovës – përderisa mbrojtja e ka vetëm një mundësi të tillë.<sup>91</sup> Shembulli në vijim e ilustron këtë praktikë:

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Pejë/Peć, më 31 maj 2004, kolegji tre anëtarësh vendosi që ta vazhdojë paraburgimin për dy të dyshuarit për dy muaj të tjerë. Të dy avokatët mbrojtës u ankuan kundër këtij vendimi.<sup>92</sup> Më 4 qershor 2004, prokurori publik i qarkut iu përgjigj njëres prej ankesave. Gjykata Supreme gjithashtu kërkoi edhe mendimin e Zyres së Prokurorisë Publike të Kosovës e cila më 21 qershor 2004 propozoi refuzimin e të dy ankesave. Mbrojtja nuk kishte qasje ndaj këtyre parashtrësive andaj nuk mund t'i komentonte të njëjtat. Më 22 qershor 2004 Gjykata Supreme mori vendim për refuzimin e ankesave.

OSBE është e mendimit se praktikat e mësipërme mund të çënojnë parimin e barazisë së armëve në dëm të mbrojtjes. Mbrojtja duhet të ketë të drejtë që të shikoj të gjitha parashtrësirat nga prokuroria dhe të përgjigjet në të njëjtat.

---

<sup>89</sup> Neni 285 (5) KPPP.

<sup>90</sup> Parimi i barazisë së armëve në mes të palëve, prokurorit dhe të paraburgosurit, përfshin nocionin se si ndjekjes ashtu edhe mbrojtjes duhet ti ipet mundësia që të kenë dijeni dhe të komentojnë për observimet e parashtruara dhe provat e nxjerra nga pala tjetër; për aplikimin e parimit të barazisë së armëve në kontekstin e ankesave kundër paraburgimit shiko, mes tjerash, *Garcia Alva v. Gjermania*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 13 shkurt 2001, para. 39.

<sup>91</sup> Në praktikë, nëse mbrojtja ankohet kundër vendimit mbi paraburgimin, prokurori publik i qarkut mund të parashtror një përgjegje me shkrim kundër argumenteve të mbrojtjes (neni 283 (3) KPPP). Sidoqoftë, gjykata gjithashtu i dërgon dosjen prokurorit publik të Kosovës për komente (neni 409 KPPP). Mbrojtjes nuk i ofrohen parashtrësirat e prokurorit publik të Kosovës, e këto siq duket as nuk është të përfshira në shkresat e lëndës, andaj nuk ka mundësi të përgjigjet.

<sup>92</sup> Ankesat në vehte citojnë datat 31 maj 2004 respektivisht 2 qershor 2004, ndonëse vendimi i Gjykatës Supreme referohet në datën e tyre 3 qershor 2004.

#### D. Çështjet lidhur me propozimin/kërkesën Habeas Corpus

Përveç ofrimit të mundësive për palët, për t'i kundërshtuar vendimet mbi paraburgimet, kodi i ri i procedurës i ofron mbrojtjes gjithashtu mundësinë e parashtrimit, në çdo kohë, të një kërkesë gjykatësit në procedurë paraprake apo kryetarit të kolegjit, me qëllim që ky i fundit të përcaktojë ligjshmërinë e paraburgimit.<sup>93</sup> Kërkesa që drejtëpërdrejtë sfidon paraburgimin faktik është gjithashtu e njohur si *habeas corpus*. Gjykatësi kompetent mund të mbajë seancë dëgjimore nëse kërkesa *habeas corpus* indikon *prima facie* në rastin e paraburgimit të kundërligjshëm<sup>94</sup> OSBE ka vërejtur se kjo kërkesë është përdorur shumë rrallë nga mbrojtësit që nga paraqitja e saj në kod, ndonëse kanë qenë disa raste të caktuara në të cilat mbrojtja me të vërtetë mund të kishte përfituar nga kjo e drejtë.

Në rastin vijues, sidoqoftë, kur avokati mbrojtës bëri parashtrësia duke kërkuar nga gjykata për të urdhëruar lirimin e menjëhershëm të të pandehurit pasi që nuk ekzistonin baza ligjore për paraburgimin e tij, duket se gjykata nuk kishte reaguar.

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Prizren, avokati i një të pandehuri u ankua kundër vendimit mbi vazhdimin e paraburgimit të datës 4 maj 2004. Gjykata Supreme e aprovoi ankesën më 12 maj 2004, e anuloi vendimin mbi vazhdimin dhe e ktheu rastin për ri-vlerësim tek kolegji-tre-anëtarësh. Megjithatë, Gjykata Supreme nuk vendosi se a do të vazhdoj I pandehuri të qëndroj në paraburgim apo do të lirohet në pritje të vendimit të kolegjit; sidoqoftë, I akuzuari mbeti në paraburgim. Më 13 maj 2004 avokati mbrojtës paraqiti parashtrësia duke kërkuar në mënyrë specifike lirimin e menjëhershëm të klientit të tij, sepse nuk ekzistojnë baza ligjore për paraburgimin e tij. Gjykata nuk ndërmori asnjë veprim në lidhje me këtë parashtrësia. I pandehuri mbeti në paraburgim derisa kolegji tre-anëtarësh vendosi sërish që të vazhdoj paraburgimin e të pandehurit, më 17 maj 2004.

Në këtë shembull, pasi që nuk kishte vendim valid mbi paraburgimin në mes të 12 dhe 17 majit 2004, i akuzuari ishte paraburgosur në mënyrë të kundërligjshme për këtë periudhë. Gjykata nuk mori parasysh parashtrësien e datës 13 maj 2004<sup>95</sup> ose duke mbajtur seance dëgjimore ose duke liruar të pandehurin drejtëpërdrejtë. Është e paqartë se a kishte dështuar gjykata të ekzaminoj këtë kërkesë për shkak të mosdijes së ligjit apo për shkaqe të tjera.

Si përfundim, shembujt e sipër-përmendur në mënyrë të mjaftueshme demonstrojnë se gjykatat ankimore dështojnë të shqyrtojnë në mënyrë të duhur argumentet e mbrojtjes në vendimet e tyre mbi ankesat. Shumica e vendimeve të gjykatave ankimore janë arsyetuar në mënyrë jo të duhur dhe duken thjeshtë si “vulosje” e vendimeve të ankuara. Për më tepër, gjykatat ankimore shpesh nuk i përfillin afatet e parashikuara me ligj për vendosjen mbi ankesat kundër paraburgimeve, përderisa procedura ankimore mund të çënojë parimin e barazisë së armëve. Në fund, përkundër faktit se ka pasur disa raste ku avokatët kanë përdorur kërkesën e re *habeas corpus*, është vërejtur se gjykatat mund të jenë të painformuara se si ti adresojnë kërkesat e tilla.

<sup>93</sup> Nenet 286 (2-4) KPPP. Duhet të theksohet se alinea e parë e nenit 286 gjithashtu jep mundësinë për gjykatësin para-gjyqësor apo kryetarin e kolegjit që të ndërpresë paraburgimin *ex officio* në çdo kohë gjatë hetimeve.

<sup>94</sup> Neni 286 (3) KPPP.

<sup>95</sup> Kjo parashtrësia përmbushte kushtet themelore të kërkesës *habeas corpus*, ndonëse formulimi mund të kishte qenë më i qartë.

## V. ÇËSHTJET LIDHUR ME KOHËZGJATJËN E PARABURGIMIT

E drejta ndërkombëtare thekson se çdonjëri i arrestuar apo i paraburgosur do të ketë të drejtë në një gjykim brenda kohës së arsyeshme apo lirim në pritje të gjykimin.<sup>96</sup> Në raste të ndryshme Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut ka vendosur se edhe nëse bazat “relevante dhe të mjaftueshme” vazhdojnë të arsyetojnë paraburgimin gjatë tërë periudhës paragjyqësore, neni 5(3) i KEDNJ mundet prapëprap të çenohet nëse paraburgimi i të pandehurit prolongohet përtej “kohës së arsyeshme”, pasi që procedura nuk është zhvilluar me ekspeditivitetin e kërkuar.<sup>97</sup> Faktorët që merren në konsiderim gjatë vlerësimit se a është mbajtur një gjykim brenda një kohe të arsyeshme janë kompleksiteti i rastit, sjellja e të akuzuarit dhe efektiviteti i autoriteteve kombëtare.<sup>98</sup> Konventa Evropiane gjithashtu thekson se çdonjëri i cili ka qenë viktimë e paraburgimit të kundërligjshëm apo arrestimit do të ketë të drejtë të ekzekutueshme për kompenzim.<sup>99</sup>

Në pajtim me standardet ndërkombëtare, legjislacioni vendës në mënyrë eksplicite thotë se Gjykata duhet pa vonesë të drejtojë procedurën. Kur i akuzuari mbahet në paraburgim, ligji më tutje parasheh që kohëzgjatja e paraburgimit duhet të jetë sa më e shkurtër që është e domosdoshme, dhe i obligon të gjitha agjencitë dhe organet pjesëmarrëse në procedurë të veprojnë me emergjencë të veçantë.<sup>100</sup> Përfundimisht, në bazë të Kodit të ri, çdokush i mbajtur në paraburgim illegal ka të drejtë në “rehabilitim të plotë” dhe “kompenzim të rregullt prej burimeve bugjetore.”<sup>101</sup>

### A. Vonesat e pajustificuara gjatë paraburgimit

Edhe përkundër dispozitave vendëse dhe standardeve ndërkombëtare të cilat kërkojnë që paraburgimi të zgjat sa më shkurtër që është e domosdoshme, OSBE-ja ka vërejtur praktikat që mund të shkelin të drejtën në liri dhe siguri të personave të akuzuar:

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, i akuzuari, i ngarkuar me vrasje dhe vrasje në tentativë, ishte paraburgosur më 07 maj 2001. Hetimet u kryen shpejtë dhe aktakuza u ngrit më 03 gusht 2001. Megjithatë, gjykimi nuk filloi deri më 11 nëntor 2002, përafërsisht një vit e tre muaj pas ngritjes së aktakuzës. Kjo vonesë nuk ishte e favorshme për të pandehurin. Për më tepër, gjatë shqyrtimit kryesor, gjykata, më 05 maj 2003 urdhëroi Klinikën neuro-psikiatrike në Prishtinë/Pristina, që ta kontrollojë të pandehurin dhe ta lëshojë një ekspertizë. Kjo ekspertizë ishte dorëzuar përfundimisht më 07 maj 2004, një vit më vonë. As kjo vonesë nuk shkonte në favor të të pandehurit.

OSBE-ja ka vërejtur një numër rastesh tjera, ku e drejta e të paraburgosurit në gjykim të shpejtë ishte shkelur për shkak të sigurimit të ekspertizave.<sup>102</sup> Në shumë instanca, ekspertët e caktuar ishin nën jurisdiksion të huaj, siq demonstronjë shembujt në vijim:

<sup>96</sup> Neni 5(3) KEDNJ. Garanca “koha e arsyeshme” përputhet me atë të nenit 6 (1) KEDNJ, por Gjykata Evropiane ka gjetur se neni 5(3) ka të bëjë me procedurat prej fazës së arrestit e deri në marrjen e vendimit të shkallës së parë; shiko *B v. Austria*, Gjykata Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, fusnota e sipërme 52, para 33 ff.

<sup>97</sup> Shiko *Tomasi v. Franca*, fusnota e sipërme 65 para. 99 dhe 102.

<sup>98</sup> Shiko *Abdoella v. Holanda*, Gjykata Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, 25 nëntor 1992, para. 14.

<sup>99</sup> Neni nenin 5 (5) KEDNJ dhe 9(5) KNDCP.

<sup>100</sup> Neni 190 (2) LPP RFJ dhe Nenet 5 (3) dhe 279 (2) KPPP.

<sup>101</sup> Nenet 16 dhe 534-538 KPPP.

<sup>102</sup> Praktika e Gjykatës Evropiane ka gjetur në raste të shumta ku vonesat e ekspertizave janë të përfshira se, pasi që ekspertët vepronin në kontest të procedurave gjyqësore të mbikqyrura nga Gjykatësi, ky i fundit mbeti përgjegjës për përgatitjen e rastit dhe shpejtësinë e udhëheqjes së gjykimin. Për më tepër, sa i përket sanksionimit të cilit Gjykata mund ta vendoste kundër ekspertit, Gjykata përkujtoi se në ratifikimin e Konventës qeveritë e morrën përsipër obligimin e organizimit të sistemeve të veta juridike në mënyrë që ato të



Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë/Priština, i akuzuari ngarkohej me akte të panatyrshme seksuale me person nën 14 vjet. I akuzuari ishte paraburgosur më 02 shtator 2002, derisa më 25 shtator 2002 një pjesë e dëshmisë u dorëzua për ekzaminim forensik në një institut relevant në Bullgari. Gjykimi filloi më 03 mars 2003, dhe më 26 mars 2003 u shty për kohë të pacaktuar për derisa ekspertiza nga Bullgaria të dorëzohet në gjykatë. I pandehuri qëndroi në paraburgim deri më 06 shtator 2003, kur ai u lirua me kaucion. Ekspertiza u dorëzua në gjykatë në korrik 2004 dhe gjykimi rifilloi më 26 gusht 2004.<sup>103</sup>

Në këtë shembull, kryetari i trupi gjykues gojarisht komunikoi me zyrtarin ndërlidhës bullgar, në mënyrë që ta bën kërkesën për ekspertizë, e cila u dorëzua përafërsisht 20 muaj pas urdhëresës. Çka është më me rëndësi, i pandehuri në pritje të ekspertizës kaloi gjysmën e totalit të paraburgimit të tij njëvjeçar.

Në raste të numërta autoritetet nuk kanë vepruar me emergjencë të veçantë, gjë që kërkohet në rastet me persona të paraburgosur. Vonesat janë shkaktuar gjithashtu në raste të ndryshme të monitoruara, ku përveç arsyeve tjera gjykata mbajti seanca të rralla gjykimi, ose lehtësisht i shtyri seancat për shkak të mungesës së dëshmitarëve,<sup>104</sup> apo vetëm për shkak se gjyqtarët e kolegjit shkuan në pushim të gjatë rreshtazi e jo njëkohësisht. Të gjitha këto praktika të vonesave të pajustificuara apo atyre që mund të evitohen mund të qojnë deri te shkelja e të drejtës së të pandehurit të gjykohet brenda kohës së arsyeshme ose të lirohet në pritje të gjykimit.

## **B. Vonesat e paarsyeshme në zbatimin e udhëresave për lirim**

Vonesat në zbatimin e udhëresave për lirim edhe më tej acaron problemet. Praktika ndërkombëtare thotë se, edhe pse pak vonesë në zbatimin e vendimit që urdhëron lirimin e të paraburgosurit është e kuptueshme, vonesat që mund të evitohen do të qonin drejt paraburgimit arbitrar. Gjykata evropiane ka gjetur se fakti që i pandehuri ka qëndruar në paraburgim për 11 orë pasi që vendimi i cili urdhëronte që ai të lirohej drejtpërdrejtë shkeli të drejtën e tij në liri dhe siguri.<sup>105</sup> Përkundër dispozitave të qarta vendëse të cilat specifikojnë emergjencën në rastet që kanë të bëjnë me paraburgim,<sup>106</sup> OSBE-ja ka vërejtur praktika të karakterit mospërfillës.

Në një rast sipas ligjit të vjetër, para Gjykatës Komonale në Mitrovicë/Mitrovica, i akuzuari ishte arrestuar për vjedhje më 28 shkurt 2004 dhe u paraburgos në pritje të gjykimit. Pas ngritjes së aktakuzës, kolegji tre anëtarësh vendosi ta liroi të akuzuarin më 16 prill 2004. Megjithatë, i akuzuari nuk ishte liruar nga Qendra e paraburgimit në Lipjan deri më 19 prill 2004.

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Pejë/Peć, sipas kodit të ri, më 12 prill 2004, gjyqtari i procedurës paraprake refuzoi parashtresën e prokurorit të vazhdoi paraburgimin e të pandehurit, dhe urdhëroi që ai të lirohej me kaucion. Pasiqë kushtet për lirim me kaucion u përmbushën, gjykata më 13 prill 2004 e urdhëroi lirimin e menjëhershëm të të pandehurit.<sup>107</sup>

---

përputhen me kërkesat e Nenit 6 (1) KEDNJ, duke përfshirë aty edhe gjykimin brenda kohës së arsyeshme: *Capuno vs Italisë*, Gjykata Evropiane e Drejtave të Njeriut, 25 Qershor 1987, par.30

<sup>103</sup> Në të njëjtën datë, Kryetari i Kolegjit, konstatoi se ekspertiza Bullgare nuk ishte e pranueshme dhe gjykimi u shty prapë për kohë të pacaktuar, në mënyrë që të sigurohet ekspertiza e kërkuar.

<sup>104</sup> *Shih Cevizovic vs Gjermanisë*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 29 Korrik 2004, par.51, ku Gjykata gjeti se “gjykata nuk veprroi me zell duke mbajtur më pak se katër dëgjime gjyqësore në muaj pa u përpjekur në mënyrë më efektive të thërras ekspertët dhe dëshmitarët [...] Gjykata gjeti se Gjykata kompetente është dashur të caktoj një orar më të ngushtë në mënyrë që ta përshpejtoi procedurën.”

<sup>105</sup> *Shih Quinn vs Francës*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 22 mars 1995, par.42, dhe parimi i përfshirë në *Labita vs Italisë*, fusnota e sipërme 61, paragrafët.166 ff.

<sup>106</sup> Neni 190 (2) LPP RFJ dhe Neni 5 (3) dhe 279 (2) KPPP

<sup>107</sup> I dyshuari u urdhërua t'i deponojë 35.000 Euro dhe të jap deklaratë më shkrim në bazë të së cilës ai u zotua që nuk do ta përsërisë veprën penale dhe do të përgjigjej në thirrje të Gjykatës.

Megjithatë, i dyshuari nuk u lirua menjëherë.<sup>108</sup> Më 14 prill 2004 kolegji ankimor aprovoi ankesën e prokurorit dhe urdhëroi që i dyshimti të mbahet në paraburgim për një muaj.<sup>109</sup> Pavarësisht nga vendimi ankimor i dyshimti është mbajtur ilegalisht në paraburgim prej datës 13 deri më 14 prill.

Në të dy rastet e sipër-përmendura, përkundër urdhëresave të gjykatës për lirim të menjëhershëm, të pandehurit qëndruan në paraburgim.<sup>110</sup> Disa vonesa në zbatimin e urdhëresave për lirim mund të bëhen pjesërisht për shkak të procedurës së aplikueshme,<sup>111</sup> edhe pse vonesat në shembujt e mësipërm nuk do të ishin të justifikueshme.

## VI. REKOMANDIMET

- Të gjitha gjykatat duhet të ofrojnë dhe të arsyetojnë në mënyrë adekuate gjatë dhënjes së vendimeve për paraburgim, qofshin ato vendimet e para, për vazhdim ose vendimet mbi ankesën.
- Gjykatat ankimore, dhe posaqërisht Gjykata Supreme duhet që në mënyrë të qëndrueshme të jep vendime me të cilat i udhëzon gjykatat e ulta se vendimet që kanë të bëjnë me paraburgim – qofshin ato vendimet e para, vazhdimet dhe vendimet mbi ankesa – duhen të jenë të arsyetuara në mënyrë të duhur në përputhje me ligjin. Në veçanti, gjykatat duhen të:
  - citojnë prova materiale relevante dhe rrethana faktike individuale të rastit, të cilat qojnë te përfundimi se paraburgimi është i nevojshëm;
  - ekzaminojnë ekzistimin e vazhdueshëm të dyshimit të arsyeshëm kundër të pandehurit kurdo që përcaktimi për paraburgim të është bërë;
  - dëshmojnë përcaktimin se masat alternative kundrejt paraburgimit nuk janë të përshtatshme në rastin përkatës;
  - demonstrojnë se argumentet e mbrojtjes janë marrë parasysh; dhe,
  - Në ankesat e bashke-kryesve, gjykatat ankimore duhet të paraqesin rrethanat individuale të personave të akuzuar veç e veç.
- Si plotësim, pasi që ekziston një vijë e tërë e vendimeve të cilat e kanë adresuar në mënyrë të duhur qështjen e paraburgimit, të gjitha gjykatat duhet ti përmbahen kësaj praktike. Në këtë drejtim, Departamenti i Drejtësisë duhet që këto vendime ti vë në dispozicion (në mënyrë anonime nëse është e nevojshme) për të gjitha gjykatat në Kosovë.

<sup>108</sup> Arsyet për këtë janë të paqarta. Duket sikur vendimi i Gjykatës të liroi të dyshimtin ishte ndalur në pritje të ankesës nga ana e Prokurorit Publik. Nëse kjo ka qenë arsyeja, atëherë është në kundërshtim me Nenin 283 (3) KPPP

<sup>109</sup> Më 10 Maj 2004, përkundër parashtresës së Prokurorit për vazhdim të paraburgimit, Kolegji i Gjyqtarëve i Gjykatës së Qarkut në Pejë urdhëroi lirin e të dyshuarit me dorëzani.

<sup>110</sup> Fakti se vendimi për mbajtjen e të akuzuarit në paraburgim është marrë më pas, sikur që është vendimi mbi ankesë në shembullin e dytë, nuk e bën legale periudhën e paraburgimit ilegal.

<sup>111</sup> Procedura e komunikimit të urdhëresave gjyqësore në qendrat e paraburgimit është themeluar në Qarkore Gjyqësore 2001/17 Komunikimi i Urdhëresave Gjyqësore në Qendrat e Paraburgimit dhe Vizita e Gjyqtarëve, 17 Qershor 2001. në lidhje me vendimet që urdhërojnë lirin e të akuzuarit, Pika 12 e Qarkore Gjyqësore parasheh se dokumentet origjinale duhet t'i dërgohen qendrave të paraburgimit, para se të zbatohet vendimi. Është e thënë në mënyrë eksplicite se asnjë vendim nuk mund të mirret me faks apo me telefon. Duke marrë parasysh rrethanat praktike të çështjeve administrative dhe orarin e punës së Gjykatave, nëse urdhëri për lirim është dhënë në orët e vonshme të ditës, praktikisht mund të thuhet se i paraburgosuri do të qëndroj në paraburgim për një ditë më shumë.

- Gjykata Supreme duhet të jep mendime ligjore<sup>112</sup> që t'i udhëzoj gjykatat të adoptojnë një qasje uniforme sa i përket vendimeve për kohën fillestare për urdhërat e vazhdimt të paraburgimit, ku periudha vazhduese e paraburgimit fillon në datën e vendimit të gjykatës.
- Gjykatat ankimore, e në veçanti Gjykata Supreme e Kosovës, duhet të siguroj që vendimet e tyre mbi ankesat kundër vendimeve për paraburgim të bihen brenda afatit prej 48 orëve nga koha e parashtrës së ankesës
- Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet të ofrojë më shumë trajnime për gjyqtarët mbi ligjin që ka të bëjë me institutin *habeas corpus* dhe dispozitën që i mundëson gjyqtarit të procedurës paraprake që *ex-officio* ta inicioj ndërprerjen e paraburgimit në çfarëdo kohe gjatë hetimeve.
- Në shkallën sipas ankesës, mbrojtja do të duhej të pajiset me të gjitha parashtrësat që i bën Zyra e Prokurorit Publik të Kosovës.
- Gjykatat do të duheshin të sigurojnë se ato dhe të gjitha agjencitë pjesëmarrëse – siç janë institutet e mjekësisë ligjore, qendrat për punë sociale etj – të veprojnë me emergjencë të veçantë në procedurat që përfshijnë të pandehurit e paraburgosur dhe t'i evitojnë vonesat e paarsyeshme
- Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet të ofroj trajnim për gjyqtarët dhe prokurorët mbi përdorimin e dispozitave të kodit të ri të cilat janë të dizajnuara të sigurojnë që ekspertizat të dorëzohen me kohë. Kjo mund të përfshijë këtu edhe mundësinë e vendosjes së afateve për dorëzimin e ekspertizave dhe aplikimin e sanksioneve financiare kur ekspertët nuk i respektojnë këto afate pa ndonjë arsytim.
- Departamenti i Drejtësisë do të duhej t'i ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm të siguroj se të gjitha agjencitë pjesëmarrëse veprojnë menjëherë në urdhër të gjykatës për lirim të akuzuarit nga paraburgimi.

---

<sup>112</sup> Shiko nenin 31 (7) të Ligjit mbi gjykatat e rregullta.

## KREU 5

### DËNIMI PENAL

*“Ekzistojnë dy arsyetime për dënime. Ajo që e quajmë arsyeja ndëshkuese mbështetet në arsyetimin se e keqja e kryer meriton dënimin përkatës. Është morale që personi i cili bën keq, të vuaj në përpjestim me të keqën që e ka bërë [...]*

*Ajo se çka ne mund ta quajmë si pikëpamje utilitariste është se mbështetet në parimin se e kaluara është e kaluar dhe se vetëm pasojat e të ardhmes paraqesin material për vendimin konkret, ndëshkimi është i arsyeshëm vetëm duke u mbështetur në pasojat e mundshme të konsiderimit të tij se një nga mjetet e rendit shoqëror. [...]*<sup>113</sup>

#### I. HYRJE

Qëllimi i dënimit mund të ndahet në katër grupe: ndëshkues, frenues, rehabilitues dhe pajtues.<sup>114</sup> Ndëshkimi para së gjithash, ekziston për të siguruar që kryesi i veprës penale të durojë së paku aq sa ai i ka shkaktuar viktimës me veprën penale. Tre bazat tjera utilitariste kanë qasje pro të ardhmes, dhe kanë për qëllim të zvogëlojnë gjasat e përsëritjes së veprës penale. Rrjedhimisht dënimi i kryesve të veprave penale i kontribuon mbrojtjes së individëve duke deklaruar se kryerja e krimeve nuk është e pranuar në shoqëri dhe duke i frenuar personat që të kryejnë vepra penale.<sup>115</sup>

Ky kapitull i referohet se si legjislacioni vendor dhe praktika gjyqësore për dënime në Kosovë ndërlidhet me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. OSBE-ja nëpërmjet monitorimit të gjerë kishte vërejtur disa mangësi të të theksueshme në përdorimin e formave të ndryshme të dënimeve. Këto mangësi gjithashtu mund të ndahen në tre fusha kryesore të shqetësimit:

- E para është mungesa e arsyeve të duhur. Kur gjykatat vendosin për dënime, ato në të gjitha shkallët dështojnë që t'i mbështesin arsyetimet e tyre, ose të merren me rrethanat specifike të rastit;
- e dyta është përdorimi i tepruar i masave izoluese (heqjes së lirisë) si dhe mos marrja parasysh e alternativave; dhe,
- e treta ka të bëjë me mungesën e kapaciteteve institucionale të cilat, në praktikë, e zvogëlojnë numrin e mundshëm të masave alternative.

<sup>113</sup> John Rawls, *Dy koncepte të së drejtës*, Shqyrtimi filozofik, Vol. 64, 1955, f. 3 13. ky është një revizion i një shkrese të dorëzuar në Klubin filozofik të të Harvardit më 30 prill 1954.

<sup>114</sup> Shih Lawrence M. Hinmen, lektorë mbi moralin në Universitetin e San Diegos, një ligjëratë e shkurtë mbi qëllimet e dënimeve, 13 mars 2001.

<sup>115</sup> Në Kosovë, e drejta zakonore që buron nga Kanuni i Lekë Dukagjinit, përndryshe i njohur si Kanun, ende mund të ndikojë në përcaktimin e dënimeve nga ana e gjykatësve kosovarë. Emri i referohet një princi shqiptar të quajtur Lekë Dukagjini (1410- 1481) të cilit i referohet ky ligj. Kanuni jepë rregulla të detajuara për udhëheqjen e jetesës së përditshme dhe përshkruan rregulla, obligime, detyra, taksa dhe dënime. Dhe ndoshta çka është më me famë, ky Kanun parasheh parimin e hakmarrjes të “gjaku do të mirret nga tregohet gisht” ose *lex talonis*; “syri për sy.” OSBE ka vërejtur se gjykatësit në disa raste ende i referohen kushteve të parashtruara me Kanun; për shembull, gjykatësi mund të kërkojë edhe të pyet se a janë pajtuar palët”. Megjithatë, ndikimi më i madh në dënime dhe në praktikën e shqiptimit të dënimeve burojnë nga dispozitat e kodit të mëparshëm të ish RSFJ- së, që e ka bërë ligjin e zbatueshëm që nga viti 1977. [Kodi penal i RSFJ- së, Gazeta zyrtare Nr. 44/ 76 që përmbanë edhe ndërrimet në RSFJ 36/ 77 (kodi penal i RFJ- së)]. Kodet e reja të vitit 2004 paraqesin kornizën e ligjeve të RFJ- së dhe si shtesë, ofron një numër të konsiderueshëm të amendmenteve.

## II. STANDARDET NDËRKOMBËTARE DHE HEQJA E LIRISË

Dënimi mund t'i kuizojë seriozisht të drejtat dhe liritë e personave të dënuar. Për të siguruar se këto kufizime nuk zbatohen në mënyrë jo të ligjshme dhe arbitrare, standardet ndërkombëtare për të drjetat e njeriut ngërthejnë një varg masash mbrojtëse të cilat e rregullojnë procedurën penale dhe përdorimin e dënimeve.<sup>116</sup> Megjithëse ka shumë forma të dënimeve, heqja e lirisë (burgimi) është ende ai më i zakonshmi.<sup>117</sup> Megjithatë, pasi që burgimi paraqet kufizim serioz të njërës nga të drejtat më të vlefshme të njeriut, të drejtës për të qenë i lirë, kjo çështje është rregulluar në mënyrë të veçantë nga disa konventa mbi të drejtat e njeriut.<sup>118</sup> Parimi i intervenimit minimal dhe i respektimit të të drejtës për liri, kanë sjellur deri te krijimi i standardeve ndërkombëtare me të cilat promovohet shfrytëzimi i masave jo-izoluese dhe kufizimi i përdorimit të heqjes së lirisë.<sup>119</sup>

Krahas efekteve rehabilituese, burgimi mundet gjithashtu të ketë edhe efekte negative në kryesit e veprave. Kjo e përkeqëson situatën edhe më tej përmes stërpopullimit të burgjeve. Mund të jetë vështirë në një burg të stërpopulluar të zbatohen standardet adekuate për trajtimin e të burgosurve, gjë që si rezultat mund të shpie në shkelje të rëndë të të drjetave të personave të dënuar. Një mënyrë e shmangies së ngarkesës së tepërt të burgjeve është përdorimi i dënimit me burg vetëm si masë e zgjedhjes së fundit. Mu për këtë, Rregullat standarde minimale (rregullat e Tokios) theksojnë se “alternativat ndaj burgimit mund të jenë mjete efikase për trajtimin e kryesve brenda komunitetit që kjo të shkojë në dobi të kryesit dhe shoqërisë.”<sup>120</sup> Mund të pritët që kjo krahinë e administruar nga KB, tu përmbahet këtyre parimeve. Më tej, Këshilli i Evropës ka theksuar se burgimi duhet të përdoret vetëm atëherë kur “serioziteti i veprës penale do ta bënte cilindo sanksion ose masë tjetër, qartazi joadekuate”.<sup>121</sup> Duhet të theksohet se zgjerimi i kapaciteteve të burgjeve rrallë herë ofron zgjidhje afatgjate të problemit të stërpopullimit.<sup>122</sup> Për këtë arsye duhet bërë përpjekje për të ulur numrin e shqiptimit të masave izoluese dhe të përdoren në vendë të kësaj masat jo-izoluese (alternative).<sup>123</sup>

<sup>116</sup> Siç janë parimet *nullum crimen sine lege* (s'ka krim pa ligj) [neni 11 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), neni 15 KNDKP dhe neni 7 KEDNJ], dhe *ne bis in idem* (rrezikueshmëria e dyfishtë) [neni 14 (7) KNDKP dhe neni 4 Protokoli Nr. 7 i KEDNJ]. Shih gjithashtu të drejtën për gjykim të drejtë në nenet 10 dhe 11 të DUDNJ, neni 14 KNDKP dhe neni 6 KEDNJ.

<sup>117</sup> Shih Qendra ndërkombëtare për reformat në të drejtën civile dhe politika e drejtësisë penale, *Politika ndërkombëtare e zhvillimit të instrumenteve të burgimi*, (korrik 2001), edicioni i parë, që thekson se “thjeshtë në botë besohet se burgimi preferohet për çdo alternativë; kështu, elementi ndëshkues që karakterizon këtë sanksion mbetet gurthemel i sistemit modern të përmirësimit dhe dënimit. Edhe përkundër efikasitetit të dëshmuar të alternativave tjera jo me burgim, prapë vazhdohet që të zbatohen dënimet e rënda të burgimit afatgjatë.”

<sup>118</sup> Nenet 9, 10 (3) dhe 11 KNDKP dhe neni 5 KEDNJ.

<sup>119</sup> Njëra nga gjëja më e rëndësishme e këtyre standardeve është përfshirë në rregullat Tokios.

<sup>120</sup> Preambula, rregullat e Tokyos.

<sup>121</sup> Këshilli i Europës, Rekomandimi nr. R (99) 22 i Komisionit të ministrave të shteteve anëtare që mirren me çështjen e stërngarkimit të burgjeve dhe krekosjes së të burgosurve. [më tutje rekomandimi nr R (99) 22] shtojca, para. 1.

<sup>122</sup> Komisioni europian për parandalimin e torturës dhe trajtimin dhe degradimit çnjerëzor ose ndëshkues ka theksuar se duke iu referuar raportit ndërmjet kapacitetit të stërmbushur të burgjeve dhe që është në rritje; “me të vërtetë një numër i konsiderueshëm i shteteve të Europës kanë filluar me programet zgjeruara për ndërtimin e burgjeve, vetëm e vetëm që të përgjigjen në situatën e rritjes së numrit të popullatës së burgjeve në tandem me kapacitetet në rritje të kërkuara të burgjeve. Dhe në kundërshti, ekzistimi i politikave për të kufizuar ose moduluar numrin e personave që futen në burg kanë bërë një kontribut të madh në disa shtete që ato t'ia dalin mbarë me numrin e popullatës nëpër burgje.” e nxjerrë nga raporti i përgjithshëm i shtatë [CPT/ Inf (97) 10], para. 14.

<sup>123</sup> Këshilli i Europës, Rekomandimi nr. R (99) 22. shtojca, para. 14.

### III. BURGJET NË KOSOVË

Para vitit 1999, në Kosovë kanë ekzistuar pesë burgje, nga një për secilin qark, dhe një institucion korrektues në Dubravë, me degën e këtij institucioni në Gjurakoc. Ka ekzistuar gjithashtu një institucion përmirësues edhe në Smrekovnicë (për burgim afatshkurtë) si dhe institucioni edukativo-përmirësues në Lipjan (për të mitur). Personat me të meta psiqike nën masat e masave të sigurimit janë vendosur në institucionin përmirësues të Dubravës.<sup>124</sup>

Sot, Divizioni i administratës së burgjeve / Shërbimi përmirësues i Kosovës, që operon në kuadër të DD, tani për tani funksionon nëpërmjet shtatë lokacioneve përmirësuese: Qendra e paraburgimit në Prishtinë/Priştina, ajo në Prizren, Mitrovicë/Mitrovica, Pejë/Peć, Gjilan/Gnjilane, burgu i Dubravës dhe i Lipjanit. Pas operacioneve ushtarake të NATO-s të kryera në mes të marsit dhe qershorit 1999, këto institucione janë vënë nën administrimin e autoriteteve të UNMIK-ut.

Përderisa në janar të vitit 2002, numri i përgjithshëm i të burgosurve ka qenë më pak se 800,<sup>125</sup> më 31 tetor 2004 ka pasur mëse 1193 persona që mbaheshin nëpër burgjet në tërë Kosovën.<sup>126</sup> Ky numër në ngritje i personave nëpër burgje (të dyshuarit/ të akuzuarit/ të dënuarit) nëpër shtetin përmirësues, ka rezultuar në stërpopullimin e burgjeve dhe objekteve tjera për mbajtje në paraburgim. Stërpopullimi i burgjeve mund të rezultojë në keqësimin e kushteve higjienike; mungesën e vazhdueshme të jetës private; më pak aktivitete të lira jashtë qelisë së burgut si dhe mungesë të shërbimeve mjekësore. Këto, si rezultat mund të shpiejnë në ngritjen e tensioneve dhe dhunës ndërmjet të dënuarve të vendosur në të njëjtën qeli dhe në mes të burgosurve tjerë dhe personelit të burgut.<sup>127</sup> Në këto situata gjasat janë më të mëdha që të ndodhin shkeljet e të drejtave të njeriut.

Më 4 shtator 2003, problemet dhe të metat nëpër burgjet e Kosovës janë bërë evidente pas okupimit dhe barrikadimit të bllokut 2 nga ana e të dënuarve në burgun e Dubravës, në shenjë proteste për shkak të kushteve të jetës aty brenda. Pas disa orë negociatash, gardianët e burgut kishin tentuar të hynin në këtë bllok të barrikaduar. Disa të burgosur kishin reaguuar duke i ndezur disa dyshekë, e që u zgjërë me shpejtësi të madhe. Pesë të burgosur kishin vdekur dhe 16 të tjerë ishin lënduar.<sup>128</sup>

Ishte ngritur një komision i pavarur për të hetuar rrethanat që kishin sjellur deri te kjo revoltë, dhe për të vlerësuar ragimin e Divizionit të administratës së burgjeve si dhe të bëjë rekomandime për të adresuar të metat dhe për të parandaluar ngjarjet e ngjajshme në të ardhmen. Komisioni kishte gjetur se edhe pse burgu i Dubravës i kishte pasur 804 të burgosur në ditën e trazirës, niveli i stërpopullimit nuk kishte qenë arsyeja e vetme pas këtij incidenti.<sup>129</sup> Megjithatë, komisioni kishte cekur disa çështje të cilat do të kishin lidhje të ngushtë me rritjen rapide të numrit të të burgosurve që është zhvilluar gjatë viteve të fundit dhe e ka vënë në pah qenë mungesën e kapaciteteve t'i plotësoj nevojat e të gjithë të burgosurve. Si njëra nga arsyet kryesore të kësaj revolte, komisioni kishte gjetur se ishte mungesa e aktiviteteve të burgosurve. Komisioni, gjithashtu e kishte theksuar edhe mungesën

<sup>124</sup> Kjo informatë ishte siguruar nga DD, Shërbimet statistikore.

<sup>125</sup> Misioni i monitorimit të burgjeve të Kosovës OJQ, Raporti i projektit finlandez për të drejtat e njeriut, 4 janar 2002.

<sup>126</sup> Numri i të burgosurve kishte mbërritur numrin më të lartë në prill të vitit 2004, kur 1397 persona ishin mbajtur në burgim; shih raportin javor të DD (2- 8 prill 2004). Arsyeja për ngritjen e theksueshme të numrit të të burgosurve në vitet e shkuara ishte kryesisht për shkak të rritjes së numrit të popullit dhe pjesërisht për shkak të disa faktorëve siç janë se duhte të ketë një sistem më efikas të drejtësisë.

<sup>127</sup> CPT, e nxjerrë nga raporti i përgjithshëm i shtatë, para. 13.

<sup>128</sup> Raporti Sekretarit të përgjithshëm mbi Administratën e përkohshme të KB në Kosovë, 15 tetor 2003, S/ 2003/ 996, para. 21.

<sup>129</sup> Raporti komisionit të Dubravës për trazirat dhe për zjarrin 4 shtator 2003 (më pas raporti i komisionit të Dubravës), faqe 15- 16.

e personelit të trajnuar mirë si dhe mungesën e ujit.<sup>130</sup> Komisioni kishte shtuar krahas kësaj se, ka pasur mundësi shumë të kufizuara për liriminn me kusht që janë ofruar deri me atë datë dhe ka rekomanduar që Komisioni për liriminn me kusht të fuqizohet dhe të bëhet më efikas për ta përshpejtuar procedurën e aplikacionit.<sup>131</sup>

#### IV. SHQIPTIMI I DËNIMEVE

Gjatë shqiptimit, gjykata duhet të sigurojë që dënimi të përbëjë masën e individualizuar, e që është në përputhje me qëllimin e përgjithshëm të dënimit, gjegjësisht parandalimin, rehabilitimin, dhe frenimin (dëbimin).<sup>132</sup> Gjkata gjatë caktimit të dënimit duhet t'i merr parasysh rrethanat specifike për të akuzuarin dhe për veprën penale të kryer.<sup>133</sup> Për më shumë, gjykata duhet ta arsyetojë plotësisht dhe në mënyrë të hollësishme vendimin e vet.<sup>134</sup>

##### A. Shqiptimi i dënimit sipas LP të RFJ

LP i RFJ i përcakton parimet e përgjithshme për shqiptimin e dënimit, duke deklaruar se gjykatat duhet të vendosin dënimin në suaza të kufizimeve të parapara me ligj, duke marr parasysh qëllimin e dënimit dhe të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese.<sup>135</sup> Sipas ligjit, qëllimi i dënimit ishte ta parandalojë të pandehurin që të kryej veprë penale, ta rehabilitojë dhe të ketë ndikim rehabilitues në të tjerët.<sup>136</sup> Krahas kësaj, në ligj përmendet se me dënim kërkohet forcimi i moralit socialist të shoqërisë vetëqeverisëse dhe të ndikohet në zhvillimin e përgjegjësisë dhe diciplinës sociale të qytetarëve. Rrjedhimisht, gjykata ishte e obliguar që të ketë parasysh aspektet e parandalimit, rahabilitimit dhe frenimit (dëbimit) për secilin rast konkret.<sup>137</sup>

Nuk ka pasur udhëzime të detajuara sa i përket përdorimit të llojeve të dënimeve dhe vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe atyre rënduese. Megjithatë, udhëzimet e përgjithshme mund të gjinden në komentet e ligjit, të cilat theksojnë se riedukimi i kryesit ishte arritur përmes heqjes së lirisë ose konfiskimit të pasurisë përderisa parandalimi ose frenimi ishte arritur me heqje të lirisë.<sup>138</sup> Përveç caktimit të çështjeve dhe rrethanave që duhet marrë parasysh gjatë caktimit të dënimit, ligji thot gjithashtu se aktgjykimi me shkrim duhet të

<sup>130</sup> Raporti Komisionit të Dubravës, ibid, fq. 12- 13.

<sup>131</sup> Menjëherë pas trazirave në gusht 2003, komisioni për lehtësime të kushteve ka para veti 112 raste të parashtruara që presin për vendimin e komisionit. Shih raportin e komisionit të Dubravës, ibid, fq. 17-22.

<sup>132</sup> Neni 34 KPP.

<sup>133</sup> Rregullat e Tokyos theksojnë se autoritetet gjyqësore duhet të marrin parasysh nevojat rehabilituese të të pandehurit, mbrojtjen e shoqërisë dhe interesin e viktimës. Shih nenin 8. 1.

<sup>134</sup> Këshilli i Europës, Rekomandimi nr R (92) 12 i komitetit të Ministrave për shtetet anëtare që mirren me qëndrueshmërinë e dënimit: “1. Gjkatat duhet që në përgjithësi, të theksojnë arsyet konkrete për shqiptimin e dënimit. Në veçanti, arsyet specifike duhet të ipen kur të shqiptohet dënimi me burgim. 2. Çka mirret si ‘arsye’ është motivim i cili ka të bëjë me dënimet e posaçme me shkallën normale të dënimit për llojin e krimit dhe për deklarimin e dënimeve racionale.”

<sup>135</sup> Neni 41 KP RFJ- së i numëron faktorët vijues: shkallën e përgjegjësisë penale, motivin, shkallën e rrezikut ose lëndimeve të objektit të mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, sjellja e të pandehurit në të kaluarën, gjendja personale e të pandehurit, sjellja e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale, si dhe rrethanat tjera që kanë të bëjnë me personalitetin e të pandehurit.

<sup>136</sup> Neni 33 i KP RFJ- së. Shiko gjithashtu edhe nenin 6 Ligji Penal i KSAK, GZ KSAK, Nr. 20/ 77, (KPP) i cili shton se gjatë ekzekutimit të dënimit, nuk duhet të shkaktohen lëndime fizike në personin e dënuar, dhe as që lejohet ofendimi i dinjitetit tij/ saj njerëzor.

<sup>137</sup> Si shënim, ndëshkimi nuk është i përfshirë si njëri nga qëllimet. Komentimi sugjeron se ligji kishte më shumë për qëllim parandalimin; shih Dr. Franjo Bacic, Ljubo Bavcon, Miroslav Gjorgjeviq, Bozhidar Kraus, Lubisha Llazareviq, Momir Lutovac, Nikolla Sërzhentiq dhe Aleksandar Stajiq, *komentimi i ligjit penal të RSFJ- së*, (Beograd, Administrata moderne, 1978), për nenin 33, para. 2.

<sup>138</sup> Ibid.

përfshijë arsyetim të hollësishëm mbi atë se si i ka vlerësuar gjykata rrethanat për rastin konkret, veçanërisht kur gjykata ka vendosur për dënimin i cili e ka tejkaluar minimumin ose maksimumin e caktuar për dënim.<sup>139</sup>

## **B. Shqiptimi i dënimeve sipas KPP**

Dispozitat e KPP për dënimet si dhe për llogaritjen e dënimeve, në thelb janë të njëjta sikur ato të LP të RFJ. KPP thekson se qëllimi i dënimit është parandalimi, rehabilitimi dhe frenimi, e njëjtë sikur se në legjislacionin e mëparshëm.<sup>140</sup> Për më shumë, thotë se gjykatat duhet të vendosin për dënimet bazuar në ligj, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit dhe duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.<sup>141</sup> Ndryshimi kryesor në ligjin e ri është mundësia e të akuzuarit që ta deklarojë fajësinë ose pafajësinë e tij. Nëse i akuzuari deklarohet fajtor, kjo duhet të merret si rrethanë lehtësuese.<sup>142</sup>

## **C. Përfundimet**

Është, dhe ka qenë obligim i gjykatës që të merrë vendim të individualizuar mbi dënimin si dhe t'i deklarojë dhe vlerësojë rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese që kanë të bëjnë me secilin të akuzuar. Kjo është me rëndësi jo vetëm të përmbushë kërkesat formale të kodit procedural, por edhe të sigurohet se i akuzuari dhe shoqëria në përgjithësi ta kuptojë qëllimin e dënimit dhe të sigurohet konsistenca në caktimin e dënimeve në tërë Kosovën. Megjithatë, mungojnë udhëzimet për shqiptimin e dënimeve për gjykatat për shfrytëzimin e llojeve të ndryshme të dënimeve. Kjo mund të rregullohet përmes arsytimit të hollësishëm nga ana e gjykatave të shkallës më të lartë të cilat mund të shfrytëzohen si udhëzime për gjykatat e shkallës më të ultë.

## **V. PRAKTIKA E SHQIPTIMIT TË DËNIMEVE**

Edhe përkundër kërkesave ligjore, OSBE-ja ka monitoruar një numër të madh të rasteve të cilat kishin vënë në pah mangësi sa i përket dënimeve të shqiptuara nga ana e gjykatave, gjegjësisht:

- Shkelje të normave për parashkrimin e veprës penale;
- arsyetimet jo të mjaftueshme; dhe,
- përdorimi jo adekuat i rrethanave lehtësuese dhe rënduese.

Të njëjtat probleme janë vërejtur në e rastet e gjykuara sipas ligjit të vjetër sikurse ato të kryera sipas ligjit të ri. Prandaj, diskutimi vijues vlenë për të dyja rastet.

## **A. Dënimet në kundërshtim me kufinj të caktuar ligjor**

Në mënyrë që dënimi izolues i zbatuar të jetë në përputhje me standardet ndërkomëtare për të drejtat e njeriut, ai duhet të jetë i ligjshëm, pra në pajtim me ligjin vendës.<sup>143</sup> Ligji parasheh një sërë dënimesh që janë të zbatueshme për secilin krim duke definuar minimumin dhe

<sup>139</sup> Neni 357 i KPP të RFJ- së. Shih gjithashtu Branko Petriq, *Komentimi*, fusnota e sipërme 47 për nenin 357 para. VII(1), i cili thekson se rrethanat që ndikojnë në dënime duhet të themelohen, të vlerësohen, dhe të arsyetohen në çdo rast. Kështu, arsyetimi i akuzës duhet të përfshijë individualizimin e dënimit.

<sup>140</sup> Neni 34 KPP. KPP, megjithatë nuk përfshinë ndonjë referencë për rforcimin e moralit të shoqërisë vetëqeverisëse socialiste, etj.

<sup>141</sup> Neni 64 KPP.

<sup>142</sup> Neni 314 dhe 358 KPPP dhe neni 64 (1) KPP.

<sup>143</sup> Neni 9 KNDKP dhe neni 5 (1) (a) KEDNJ.



maksimumin e dënimit me ç'rast kufizohet kompetenca diskrecionale e gjykatave gjatë vendimit për shqiptimin e dënimit të caktuar. Megjithatë, janë përcjellur disa raste kur gjykatat kanë dështuar që t'i respektojnë këto kufizime.

Në veçanti, kjo është vërejtur në rastet e trafikimit, për të cilat OSBE-ja kishte raportuar më parë.<sup>144</sup> Edhe përkundër faktit se dënimi minimal për trafikim me persona është dy vite burgim, në të shumtën e rasteve gjykatat i kanë shqiptuar dënime më të ulta se ky kufizim. Dy rastet në vijim mund të shërbejnë si shembuj.<sup>145</sup>

Në rastin e parë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë/Priština, më 12 dhjetor 2003 dy të akuzuar janë shpallur fajtor për kalim ilegal të paautorizuar të kufirit dhe për trafikim me qenie njerëzore. Që të dy të akuzuarit ishin dënuar me nga 2 muaj burgim për kalim të paautorizuar të kufirit, dhe me nga një vit e pesë muaj për trafikim me njerëz. Atyre u ishte dhënë dënimi i përbashkët prej një viti e gjashtë muaj heqje lirie. Gjykata nuk e kishte arsyetuar vendimin e saj për shqiptimin e këtij dënimi i cili nuk ishte në përputhje me normat për minimumin e dënimit dhe se as që e kishte përmendur këtë të dhënë.<sup>146</sup>

Në rastin e dytë, në Gjykatën e Qarkut në Prizren, më 19 dhjetor 2003, tre të akuzuar ishin shpallur fajtor për trafikim me njerëz. Dy prej të akuzuarëve ishin dënuar me nga dy vite e gjashtë muaj burgim, gjë që bie në shkallën e kërkuar ligjore. Megjithatë personi i tretë i akuzuar ishte dënuar me një vit e gjashtë muaj. Në arsyetimin e saj, gjykata iu ishte referuar rrethanave lehtësuese dhe rënduese por kishte dështuar që të përmendi (ose të arsyetojë) se kishte shqiptuar dënimin nën shkallën më të ultë të caktuar.<sup>147</sup>

Ndëshkimi i çfarëdo vepre penale luan një rol të rëndësishëm në shoqëri dhe paraqet balansimin në mes të interesave të të akuzuarit, palës së dëmtuar dhe shoqërisë në përgjithësi; një balans i cili nuk mund të mbahet kur shkellet ligji. Krahas kësaj, në rastet që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave, siç është trafikimi me njerëz, autoritetet kanë obligim që të ofrojnë mjete efikase juridike<sup>148</sup> që janë në përputhje me rregullat procedurale.<sup>149</sup> Në këto raste të përmendura ligji vendës nuk ishte respektuar, i cili kishte shpjer në shkeljen e të drejtave të viktimës për mjete efikase juridike.

## **B. Arsyetimi i pamjaftueshëm**

Edhe përkundër kërkesave legjitime për dënim dhe për arsyetim të individualizuar, OSBE-ja ka vërejtur se gjykatat, në të gjitha shkallët, rrallë ndodhë të bëjnë arsyetime të hollsishtme për

<sup>144</sup> Shih shqyrtimin e OSBE- së të sistemit juridik penal (mars 2002– prill 2003) “Mbrotjtja e dëshmitarëve në sistemin penalo- juridik”, fq. 43.

<sup>145</sup> Neni 139 i KPP dhe Rregullorja e UNMIK- ut 2001/ 4 Mbi parandalimin e trafikimit me persona në Kosovë, neni. Duke u bazuar në statistikat nga UNMIK- u, DD, gjatë vitit 2003, dy personave iu është dhënë dënimi me kusht për trafikim, dhe pesë persona ishin dënuar për trafikim prej 6 deri 12 muaj. Të gjitha këto dënime janë nën minimalen e paraparë.

<sup>146</sup> Referoju pjesës C që vijon për mundësinë e shqiptimit të dënimeve lehtësuese.

<sup>147</sup> Mbi rigjykimin, prokurori kishte tërëzuar akuzat për shkak të mungesës së dëshmive.

<sup>148</sup> Neni 13 KEDNJ.

<sup>149</sup> Në rastet e dhunës kundër grave mospërputhja me ligjet vendore mund të paraqes shkelje të Konventës së Eleminimit të të gjitha formave të diskriminimit kundër grave, shiko nenin 2 (b) dhe (c). Duhet të theksohet se komisioni për këtë konventë kishte raportuar për situatën në Republikën e Moldavisë (UN dok. GAOR A/ 55/ 38, fq. 59 para. 102) se “për zbardhjen e rekomandimeve të përgjithëshme 19 mbi dhunën ndaj grave, komisioni thërret qeverinë që të sigurojë se shkeljet e tilla paraqesin krim i cili duhet të dënohet me ligjin penal, dhe se kjo duhet të ndiqet penalisht dhe të dënohet ashtu siç kërkohet sa më shpejt, dhe se ato gra të cilat janë viktimat të dhunës duhet të kenë menjëherë mjete juridike për mbrotjtje.”

vendimet e marra sa i përket caktimit të dënimit, pa marrë parasysh se ato, në substancë, mund të jenë korrekte. Shumica e aktgjykimeve të shkruara në mënyrë të thjeshtë i numërojnë faktorët lehtësues dhe rëndues pa ndonjë vlerësim të mëtejshëm, dhe mëpastaj bëjnë referencat standarde për qëllimin e dënimit, duke theksuar se do të përmbushen nëpërmjet formës së përzgjedhur.<sup>150</sup> Në të shumtën e rasteve nuk përfshijnë ndonjë vlerësim të rrethanave të përmendura ose të ndikimit të tyre në vendimin e gjykatave, ose ndonjë referencë të peshës së dënimit të zgjedhur në lidhje me kufinj të paraparë për krimet specifike.

Një shembull i një arsytimi të shkurtër dhe standard mund ta gjejmë në një rast para gjykatës komunale në Prizren. Në aktgjykimin me shkrim të datës 26 qershor 2003, gjykata e kishte dënuar një të akuzuar me pesë muaj burgim për veprën penale të vjedhjes. Sa i përket vendimit të saj për dënim, gjykata thjeshtë kishte përmendur rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe mëpastaj kishte përfunduar se gjykata kishte vendosur për për këtë dënim prej pesë muajëve, duke pasur bindje të thellë se kjo do të arrijë qëllimin e dënimit. Gjukata nuk kishte theksuar se si i kishte vlerësuar situatat.

Shembulli i dytë pranë gjykatës së Qarkut në Pejë/Peć është një rast i shkaktimit të lëndimeve të rënda trupore i cili kishte rezultuar me vdekje të viktimës. Më 5 maj 2004 gjykata e kishte dënuar të akuzuarin me gjashtë vite burgim për shkak se e kishte rrahur xhaxhain e tij me një shkop të drurit. Gjukata shumë shkurtë iu ishte referuar vendimit të vet për dënim, duke numëruar rrethanat lehtësuese dhe duke theksuar se nuk kishte gjetur rrethana rënduese. Dhe si në shembullin e mëparëshëm, gjykata nuk kishte dhënë ndonjë llogari të vlerësimit të rrethanave ose të bëjë vlerësimin e rëndësisë së krimit.

Në shumë raste gjykatat dështojnë që të individualizojnë arsytimet e tyre. Në rastet e procedurave të bashkuara, gjykatat tentojnë të mirren me disa të akuzuar së bashku, në vend që të bëjë vlerësim individual për secilin të akuzuar. Në rastet vijuese, gjykata ishte marrë me shumë të akuzuar të cilët kishin pasur situata të ndryshme personale pa ndonjë adresim të duhur të këtyre dallimeve.

Në një rast pranë Gjykatës komunale të Lipjan/Lipljane, në të cilën ishin përfshirë dy të akuzuar për vjedhje që ishin të moshës madhore dhe i treti ishte i mitur. Në aktvendimin e datës 14 gusht 2003, gjykata kishte dënuar dy të akuzuarit e parë me nga tetë muaj dënim me burg, me kusht për dy vite si dhe kishin shqiptuar masa edukative të mbikqyrjes së rritur nga ana e prindërve të fëmijës së mitur. Në arsytimin e saj, gjykata ishte marrë me tre personat së bashku pa bërë ndonjë referencë të posaçme për situatën e të miturit. Gjukata thjeshtë kishte dhënë rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të tre të akuzuarit së bashku.

Në një rast tjetër, gjykata si duket kishte harruar njërin person të akuzuar kur kishte vendosur për dënim. Më 29 janar 2004 Gjykata e Qarkut në Pejë/Peć kishte dënuar tre persona për vjedhje me shkaktim të lëndimeve të rënda trupore dhe kishte dënuar dy prej tyre me pesë vite e gjysëm me burg dhe tjetrin të tretin me pesë vite burgim.<sup>151</sup> I akuzuari i katërt i cili që i akuzuar për armë mbajtje pa leje ishte dënuar me një vit

---

<sup>150</sup> Shpesh, numërimi i rrethanave është një përfshirje e përgjithëshme, për shembull, si referencë marrja e rrethanave lehtësuese për personin i cili nuk e ka gjendjen ekonomike të mirë pa theksuar se a ka marrë parasysh gjykata këtë të dhënë.

<sup>151</sup> Nenet 137 dhe 138 (1) KPP.

dënim me kusht për dy vite.<sup>152</sup> Në arsyetimin e saj, gjykata kishte marrë parasysh tre të akuzuarit për vjedhje, por nuk e kishte përmendur fare të akuzuarin e katërt.<sup>153</sup>

### C. Arsyetimi jo i mjaftueshëm në rastet e zbutjes së dënimeve

Nëse gjykata gjenë se ekzistojnë rrethanat lehtësuese të veçanta të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të përmbushet nëpërmjet dënimit më të butë, gjykata mund ta zbusë dënimit edhe nën kufirin e caktuar ligjor.<sup>154</sup> Dhe në mënyrë të njejtë, në disa raste gjykata mund të shqiptojë dënime me burg për afat më të gjatë.<sup>155</sup> Në këto raste është me rëndësi të veçantë që gjykata ta arsyetojë vendimin e saj. Arsyetimet e pamjaftueshme janë bazë për paraqitjen e ankesës.<sup>156</sup>

Në praktikë, megjithatë, gjykatat shpesh i shqiptojnë dënimet më pak se minimumi i paraparë pa dhënë ndonjë vlerësim të mjaftueshëm të rrethanave relevante. Më poshtë janë disa shembuj të kësaj praktike.

Në një rast pranë Gjykatës Komunale të Lipjanit/Lipljane dy persona ishin dënuar më 5 qershor 2003 - njëri nga të akuzuarit ishte dënuar me gjashtë muaj burgim për vjedhje të rëndë, gjë që me legjislacionin e mëparshëm ishte paraparë dënim me më së paku një vit burg.<sup>157</sup> Në aktgjykimin me shkrim gjykata i kishte dhënë faktorët lehtësues dhe rëndues që kishte marrë parasysh, por nuk e kishte arsyetuar vendimin e saj për dënimin lehtësues. Në të vërtetë, gjykata kishte dështuar që edhe të përmendë se dënimi nuk ishte në përputhje me kufirin minimal të paraparë me ligj.

Më 8 korrik 2004 në gjykatën komunale në Gjilan/Gnjilane ishin dënuar tre të akuzuar për një rast të rëndë të sulmit kundër zyrtarëve përderisa ata ishin duke kryer detyrën e tyre, gjë për të cilën është paraparë dënimi minimal prej gjashtë muajve.<sup>158</sup> Edhe përkundër kësaj, gjykata i kishte akuzuar ata me një, dy dhe tre muaj burgim. Dhe në arsyetimin e saj, gjykata kishte dështuar që të vendosë për rrethanat individuale për secilin nga të akuzuarit dhe kishte dështuar të theksojë rrethanat e posaçme që do të arsyetonin dënimin minimal. Dhe si në shembullin e mëparshëm arsyetimi nuk kishte përmendur fare se dënimi i shqiptuar ishte më pak se ai minimal i paraparë me ligj.

Mungesa e arsyetimit të duhur nëpër vendimet e gjykatave nuk përbën vetëm shkelje të kërkesave formale për aktgjykimin e shkruar sipas ligjit vendës dhe standardeve ndërkombëtare, por mundet të ndikojë edhe në perceptimin e opinionit publik lidhur me sistemin gjyqësor. Kur gjykata të vendosë për dënimin i cili nuk është në përputhje me kufirin

<sup>152</sup> Neni 8 (2 dhe 6) Rregullorja e UNMIK- ut 2001/ 7 mbi autorizimin e armëve në Kosovë.

<sup>153</sup> Ky rast ishte paraqitur me ankesë në Gjykatën Supreme, e cila pjesërisht e kishte pranuar ankesën në vendimin e datës 20 maj 2004 dhe kishte zvogëluar dënimin e personave që kishin kryer vjedhje me armë. Pasiqë nuk ishte bërë ndonjë ankesë për dënimin e armë mbajtjes, Gjykata nuk e kishte shqyrtuar fare. Ia vlenë të theksohet se Gjykata Supreme nuk kishte komentuar për faktin se Gjykata e shkallës së parë nuk kishte llogaritur rrethanat lehtësuese dhe rënduese në lidhje me këtë person.

<sup>154</sup> Nenet 66 dhe 67 KPP. Këto dispozita korrespondojnë në nenet 42 dhe 43 KP RFJ- së.

<sup>155</sup> Gjykata mund të rrisë dënimin më shumë se ai maksimal nëse i akuzuari është dënuar më shumë se një vit në dy rastet e mëparshme nëse kanë kaluar më pak se pesë vite në mes datës kur i pandehuri është liruar nga burgimi i mëparshëm dhe të ditës së kryerjes së veprës penale. Shiko nenin 70 KPP. Në lidhje me legjislacionin e mëparshëm shiko 46 KP RFJ- së.

<sup>156</sup> Shih nenet 396 (8), 402 dhe 403 KPP të cilat përputhen me nenin 357 (8), 363 dhe 364 (1) të KPP RFJ- së në ligjin e mëparshëm. Shiko gjithashtu *Komentimin e Branko Petriqit*, fusnota e siperme 47, neni 357 para. VII (2).

<sup>157</sup> Neni 135 (1) KPP. I akuzuari i dytë në rastin e njejtë ishte akuzuar me katër muaj burg për ndihmesën që kishte bërë në vjedhjen e rëndë.

<sup>158</sup> Neni 317 (1 dhe 2) KPP.

minimal të paraparë me ligj, dhe pa dhënë arsyetimet specifike për këtë, kjo mund të jepë një përshtypje se bëhet fjalë për arbitrarizëm.

#### **D. Arsyetimi i pamjaftueshëm i bërë nga gjykata supreme në vendimet e saj mbi ankesat e parashtruara kundër dënimit**

Gjykata supreme është gjykata e shkallës më të lartë në Kosovë. Nëpërmjet të rasteve që kjo gjykatë i gjykon, ajo duhet të interpretojë ligjin dhe të ndërtojë një trup rastesh me të cilat i udhëzon gjykatat e ulta përkritazi me dënimin. Vendimet e gjykatës supreme që kanë të bëjnë me dënimin janë të rëndësishme në ofrimin e udhëzimeve dhe qartësisë se si duhet të zbatohen format e ndryshme të dënimeve, se si duhet të vlerësohen rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe promovimin e shfrytëzimit të masave alternative.<sup>159</sup> Në praktikë, megjithatë, gjykata supreme shumë rrallë ofron arsyetime të mjaftueshme. Në të kundërtën, në disa raste madje mundet të shërbejë edhe si arsyetim i keq.

Në një numër të madh të rasteve, gjykata supreme ka dështuar të ofrojë arsyetim dhe vetëm ka deklaruar se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese si duhet.<sup>160</sup>

Një shembull i kësaj mund të gjindet në vendimin e gjykatës supreme të datës 16 mars 2004. Në këtë rast gjykata supreme ka ndryshuar pjesërisht vendimin e gjykatës së qarkut të Pejës/Peć dhe ka zvogëluar gjobën e shqiptuar prej 900 në 500 euro, për shkak se akuzat e caktuara përkritazi me posedimin e paligjshëm të armëve janë tërhequr. Sa i përket këtij dënimi, gjykata supreme ka deklaruar vetëm se gjykata e qarkut ka vlerësuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese në mënyrë të duhur. Gjykata supreme vazhdoi të deklarojë se për shkak të tërheqjes së pjesërishtme të akuzave, gjykata kishte vendosur të ndryshojë dënimin dhe se dënimi më i ulët do të jetë në pajtim me qëllimin e dënimit. Në këtë mënyrë gjykata supreme ka dështuar të vlerësojë arsyetimet shumë të kufizuara të gjykatës së qarkut mbi dënimin e shqiptuar dhe mëtutjje ka dështuar në shpjegimin e konsideratave të këtyre faktorëve kur ka vendosur mbi ndryshimin e dënimit.<sup>161</sup>

Në një rast me fakte të ngjashme, gjykata e qarkut në Pejë/Peć kishte shqiptuar dënimin me gjobë prej 300 eurosh kundër një personi për posedim të paligjshëm të armëve.<sup>162</sup> Në vendimin e vet gjykata e qarkut kishte deklaruar se i ka marrë në konsideratë rrethanat lehtësuese të paraqitura në vazhdim: Se i akuzuari nuk ka qenë paraprakisht i dënuar; se ai ishte në gjendje të dobët ekonomike; se ishte sjellur në

<sup>159</sup> Këshilli i Evropës, Rekomandimi Nr. R (99) 22. Shtojca, paragrafi 22, deklaroi se organet kompetente duhet të përcaktojnë udhëzime të qarta për caktimin e dënimeve me qëllim të zvogëlimin të nivelit të përdorimit të dënimit me burg dhe zgjerimit të përdorimit të sanksioneve dhe masave të komunitetit. Lexo gjithashtu rekomandimin Nr. R (2000)22 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare mbi përmirësimin e zbatimit të rregullave evropiane mbi sanksionet dhe masat në kuadër të komunitetit, (shtojca 2, paragrafi 7) i cili krahas kësaj spikat rolin e organeve gjyqësore në procesin e sanimit dhe rishikimit të politikave mbi shfrytëzimin e sanksioneve dhe masave në kuadër të komunitetit.

<sup>160</sup> Gjykata e shkallës së dytë shqyrton aktgjykimin nëse kontestohet me ankesë [Neni 415(1) KPPP apo 376 (1) KPK RFJ-së]. Njëri nga arsyet se pse një aktgjykim kontestohet me ankesë është se gjykata e shkallës nuk kishte plotësuar qëllimin e dënimit nga këndvështrimi i rrethanave që janë relevante për caktimin e shkallës së dënimit, apo për shkak se gjykata kishte zbatuar apo kishte dështuar të zbatojë dispozitat që kanë të bëjnë me zbutjen e dënimit [Neni 406(1) apo 367(1) KPP i RFJ-së]. Në rast se ankesa e paraqitur në emër të të akuzuarit nuk përmban bazat për kontestimin e aktgjykimit dhe/apo argumentit që mbështet ankesën, gjykata e apelit është e obliguar që të rishikojë *ex officio*, në mes tjerash edhe vendimin për caktimin e dënimit [Neni 415(2) KPPP apo 376 (2) KPP i RFJ-së].

<sup>161</sup> Gjykata e qarkut në Pejë/Peć vetëm i kishte numëruar rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

<sup>162</sup> I akuzuari ishte shpallur fajtor për posedim të një AK 47 dhe 88 karikatorë me municion.

mënyrë korrekte para gjykatës; dhe është i moshës së vjetër – 77 vjet. Gjykata nuk ka përmendur kurrfarë rrethana rënduese. Prokurori kishte paraqitur ankesë kundër dënimit të shqiptuar mbi bazën se gjykata e qarkut i kishte dhënë më shumë rëndësi rrethanave lehtësuese. Më 11 maj 2004, gjykata supreme refuzoi ankesën si të pabazë. Në arsyetimin e vet, gjykata supreme kishte deklaruar thjeshtë se konsideron se vlerësimi i rrethanave lehtësuese në aktgjykim është bërë në mënyrë të duhur dhe në pajtim me ligjin. Edhe pse ky dënim mund të shihet si më i butë se shumë dënime tjera të shqiptuara nën akuza të ngjashme, gjykata supreme nuk ka shfrytëzuar mundësinë që të shtjellojë çështjen e vlerëzimit të rrethanave lehtësuese apo ndikimin që moshë e të akuzuarit mund t'a ketë në aktvendimin gjyqësor.

Kërkesa e shtuar për arsyetim të detajuar në rastet kur gjykata vendos mbi shqiptimin e një dënimi të caktuar që nuk është në pajtim me minimumin dhe maksimumin e dënimeve të përmendura. Fatkeqësisht, gjykata supreme në disa raste ka ulur dënimin e shqiptuar mëparë nën minimumin e dënimit të paraparë pa dhënë arsyetim të detajuar për një vendim të tillë.

Në një rast, gjykata e qarkut në Prishtinë/Priština kishte dënuar tre të akuzuar për vjedhje të rëndë të dhunshme dhe plaçkitje me gjashtë, pesë dhe pesë vjet burgim. Në aktgjykimin e vet të datës 15 prill 2004, gjykata supreme pjesërisht e ka aprovuar ankesën e paraqitur nga avokati mbrojtës dhe ka ulur dënimin e shqiptuar në pesë, katër dhe katër vjet burg, përkundër faktit se për këtë veprë penale parashihet dënimi minimal me pesë vjet burg. Gjykata supreme nuk ka përmendur faktin se, për të dy të akuzuarit, dënimi ishte më i ulët se dënimi minimal i paraparë.

Një shembull i dytë mund të shihet në aktgjykimin që përfshinte tre të akuzuar të ngarkuar për vjedhje të rëndë me dhunë dhe plaçkitje në bashkëpjesëmarrje, për të cilën veprë parashihet dënimi minimal me pesë vjet burg.<sup>163</sup> Gjykata supreme ndryshoi aktgjykimin e gjykatës së qarkut të Pejës/Peć sa i përket dënimit dhe e uli këtë dënim për të akuzuarin e parë nga pesë vjet e gjashtë muaj në vetëm katër vjet burg, për të akuzuarin e dytë nga pesë vjet e tre muaj në tre vjet e gjashtë muaj dhe për të akuzuarin e tretë nga pesë vjet e gjashtë muaj në tre vjet e gjashtë muaj. Gjykata supreme nuk dha kurrfarë shpjegimi se përse dënimi është ulur nën minimumin e dënimit të paraparë për atë veprë.

Gjykata supreme nuk e ka përmbushur rolin e vet si interpretues parësor i ligjit dhe nuk ka ofruar kurrfarë udhëzime të duhura gjykatave të shkallës më të ulët mbi shqiptimin e dënimeve.

### **E. Shfrytëzimi joadekuat i rrethanave lehtësuese dhe rënduese**

Të metat sa i përket arsyetimit të aktvendimeve nga ana e gjykatave nuk janë të kufizuara vetëm në detajizimin e arsyetimeve apo mungesën e dënimit të individualizuar. OSBE-ja ka vërejtur se shumë raste bëjnë me dije se gjyqtarëve i'u mungon një mungesë e duhur e asaj se si rrethanat e ndryshme mundën apo duhet të ndikojnë në vendimin për dënim. Edhe pse brezi i rrethanave lehtësuese dhe rënduese është mjaft i gjerë, dhe se gjykatat kanë pushtet diskrecional në atë se si t'i zbatojnë këto dënime, ekzistojnë disa faktorë të cilët qartë duhet apo nuk duhet të merren parasysh.

OSBE-ja ka monitoruar rastet në të cilat gjykatat kanë konsideruar rrethanat të cilat janë qartazi të parëndësishme. Në rastet tjera vetë konsiderimi paraqiste shkelje të ligjit. Një rrethanë lehtësuese apo rënduese duhet të jetë e rëndësishme për veprën penale apo për rrethanat personale të kryesit të veprës penale. Referimet standarde në, apo numërimi i faktorëve lehtësues apo rëndues na kanë shpjer në referimet që i'u bëhen rrethanave që nuk

<sup>163</sup> Nenet 138(1) dhe 137 KPP-së.

janë të rëndësishme për një rast të caktuar. Një rrethanë e tillë lehtësuese të cilës gjykatat shpesh i referohen është gjendja ekonomike e kryesit.

Një shembull ku rëndësia e gjendjes së dobët ekonomike të të akuzuarit si faktor lehtësues mund të vihet në pikëpyetje mund të gjindet në aktgjykimin e datës 21 mars 2003 i gjykatës së qarkut në Pejë/Pec. Në këtë rast personi ishte shpallur fajtor për posedim të paligjshëm të armëve (tre armë automatike dhe municion). Personi ishte dënuar me 8 muaj burgim. Gjatë marrjes së vendimit mbi shqiptimin e dënimit gjykata i'u ishte referuar gjendjes së dobët ekonomike të të akuzuarit si një rrethanë lehtësuese.<sup>164</sup>

Gjykata e Qarkut në Prizren shqiptoi dënimin kundër një personi me 6 vjet burg për përdhunim në bazë të aktgjykimit të shpallur më datën 12 janar 2004. Personi në fjalë kishte detyruar me forcë të bijën e tij të ketë marrëdhënie seksuale me të. Në mesin e rrethanave të konsideruara, gjykata kishte përmendur edhe gjendjen e dobët ekonomike si një rrethanë lehtësuese.

Është shumë vështirë të shihet se si gjendja ekonomike e kryesit mund të ketë ndikim lehtësues apo rëndues në vendimin e gjykatës për shqiptimin e dënimit në rastet siç janë këto. Në rastet tjera gjykatat kanë treguar një mungesë të kuptimit për atë se cilat rrethana duhet të merren parasysh.

Në një aktgjykim të datës 2 qershor 2004, gjykata komunale në Prizren kishte dënuar dy persona me nga 6 muaj burg secilin prej tyre për vjedhjen e dy këmbanave dhe një qirëmbajtësi nga një kishë. Vepra penale ndodhi gjatë trazirave të marsit dhe për këtë arsye ndodhi në një ambient politik i cili mund të ndikojë në perceptimin lidhur me krimin. Megjithatë, disa nga rrethanat të cilave i'u referohej gjykata nuk ishin me rëndësi gjatë marrjes së vendimit mbi caktimin e dënimit për veprën penale të kryer. Gjykata konsideroi, si një nga rrethanat rënduese edhe faktin se krimi kishte ndikuar në imazhin e Kosovës në sytë e botës perendimore. Si rrethanë lehtësuese gjykata, në mesin e faktorëve të tjerë, kishte konsideruar gjithashtu se i akuzuari nuk kishte qëllim (agjendë) politik. Të dyja këto rrethana si ajo lehtësuese gjithashtu edhe ajo rënduese nuk është dashur të merren parasysh. Rrethana rënduese ka karakter të përgjithshëm dhe politik dhe nuk ka lidhje të drejtpërdrejt me krimin apo të akuzuarin. Rrethana lehtësuese në anën tjetër i referohet faktit se vjedhja është kryer pa qëllim (agjendë) politike. Edhe pse agjenda politike mund të përbëjë një faktor rëndues, mungesa e saj nuk është rrethanë lehtësuese për një vepër penale siç është ajo e vjedhjes.

Ekzistojnë gjithashtu raste kur gjykata kishte konsideruar një çështje si rrethanë rënduese që në bazë të ligjit nuk mund të konsiderohet si e tillë.

Më 18 maj 2004, gjykata komunale në Kamenicë/Kamenica shpalli fajtor një person për pjesëmarrje në grup i cili kishte penguar personin zyrtar në kryerjen e detyrave të tij dhe kundër tij kishte shqiptuar dënimin me 60 ditë burg. Në arsyetimin e vet gjykata kishte cekur se e kishte konsideruar si rrethanë rënduese faktin se i akuzuari ishte objekt i hetimit penal i cili ishte në zhvillim e sipër kundër tij. Duke e marrë parasysh këtë faktor si rrethanë rënduese, gjykata kishte shkelur të drejtën e të akuzuarit për t'u konsideruar si i pafajshëm derisa të shpallet fajtor.<sup>165</sup>

<sup>164</sup> Gjykata Supreme në vendimin e vet të datës 13 mars 2004 kishte miratuar vendimin e gjykatës së shkallës më ulët për shqiptimin e dënimit pas ankesës së paraqitur kundër këtij vendimi. Gjykata supreme kishte cekur se gjykata e shkallës së parë kishte vlerësuar rrethanat ekzistuese dhe ndikimin e tyre në dënim.

<sup>165</sup> Neni 3 KPPP.

Në shembullin e dytë, gjykata komunale në Prizren shpalli fajtor një person për tentim vjedhje duke i'a shqiptuar dënimin prej një muaj burg më 20 gusht 2003. Gjkata konsideroi si rrethanë rënduese se i akuzuari kishte kryer vepër penale me qëllim të përfitimit të paligjshëm nga pasuria (prona) e dikujt tjetër. Ky fakt paraqet një rrethanë rënduese në një rast të vjedhjes për shkak se përbën një element të veprës penale.<sup>166</sup>

## F. Paqëndrueshmëria

Qëndrueshmëria në shqiptimin e dënimeve paraqet një nga parimet themelore të drejtësisë. Ky ndryshim (kontrast) i pajustificuar në dënimin e rasteve të ngjashme mund të rezultojë në një perceptim të padrejtësisë dhe mund të ndikojë në besimin e publikut të përgjithshëm në sistemin e drejtësisë. Standardet ndërkombëtare për këtë arsye janë hartuar për të ndihmuar në sigurimin e konsistencës (qëndrueshmërisë) në caktimin e dënimeve.<sup>167</sup>

Në Kosovë, megjithatë, mungesa e udëzimeve të përcaktuara mbi shqiptimin e dënimeve gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin, rezulton në mënyrë të paevitueshme në paqëndrueshmëri. Për shkak se ekziston një mundësi e kufizuar për gjyqtarët dhe prokurorët për të qenë të informuar për praktikën e dënimeve të gjyqtarëve tjerë, rastet e ngjashme rrezikojnë të jenë të trajtuara në mënyrë të ndryshme nga gjyqtarët e ndryshëm. OSBE-ja ka vërejtur se ekziston një dallim në trajtimin e rasteve të ngjashme nga gjykatat e ndryshme. Shembujt e parë tregojnë se si rastet e ngjashme të vrasjeve mund të rezultojnë në dënime dukshëm të ndryshme njëra me tjetrën.

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Pejë/Peć i akuzuari ishte shpallur fajtor për vrasje dhe posedim të paligjshëm të armëve më 11 shkurt 2004.<sup>168</sup> Në bazë të gjykatës i akuzuari kishte privuar nga jeta me qëllim një viktimë femër. I akuzuari, pas një konflikti gojor me palën e dëmtuar për disa çështje pronësore, kishte shkuar në shtëpinë e vet, kishte marrë me vete pushkën automatike AK-47 dhe kishte gjuajtur viktimën 23 herë nga një distancë prej 20 metra. Gjatë marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit, gjykata kishte cekur si faktor lehtësues se i akuzuari nuk ishte dënuar mëparë dhe se ishte i moshës së re. Si faktor rëndues gjykata kishte përmendur mënyrën se si vepra penale ishte kryer. Gjkata dënoi të akuzuarin me shtatë vjet dhe gjashtë muaj burg për vrasje dhe me dhjetë muaj për posedim të paligjshëm të armëve, duke i'a shqiptuar dënimin e përgjithshëm me gjithsejt tetë vjet.

Në një rast tjetër pranë të njëjtës gjykatë, që kishte të bëjë me gjashtë të akuzuar dhe akuza për vrasje, posedim të paligjshëm të armëve dhe pjesëmarrje në grindje, njëri nga të akuzuarit ishte shpallur fajtor për vrasje dhe posedim të paligjshëm të armëve më 29 shkurt 2003. Të gjithë të akuzuarit kishin marrë pjesë në grindje gjatë së cilës njëri nga ta kishte shkrepur në ajër dy herë. Personi i shpallur fajtor për dënim mëpastaj kishte marrë revolen, kishte gjuajtur dy herë dhe kishte vrarë palën e dëmtuar menjëherë. Sa i përket këtij personi i akuzuari nuk kishte gjetur kurrfarë rrethane rënduese dhe si rrethanë lehtësuese kishte marrur parasysh faktin se i akuzuari nuk ishte shpallur fajtor mëparë, gjendjen e tij të dobët ekonomike dhe se ai kishte shfaqur pendim gjatë gjykimit. Megjithatë, gjykata e kishte dënuar atë me një dënim më të rreptë se në shembullin e mëparshëm, me 11 vjet e dhjetë muaj për

<sup>166</sup> Lexo nenin 134 KPK.

<sup>167</sup> Këshilli i Evropës, Rekomandimi R (92) 17 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare sa i përket qëndrueshmërisë (konsistencës) në shqiptimin e dënimeve.

<sup>168</sup> I akuzuari ishte shpallur fajtor për vrasje në bazë të nenit 30(1) KPK i cili parashikon një dënim minimal me pesë vjet burg.

vrasje dhe me katër muaj për posedim të paligjshëm të armëve duke i shqiptuar atij një dënim të unifikuar prej gjithsejt 12 vjet burg.

Një fushë tjetër ku duhet të ketë huti në lidhje me dënimin dhe ndërlidhjen e tij me akuzat për posedim të paligjshëm të armëve. Këto vepra penale bartin një dënim maksimal prej tetë vjet burg për posedim të paligjshëm dhe për përdorim të tyre një dënim prej dhjetë vjet burg për kërcënim të përdorimit.<sup>169</sup> Shembujt e mëposhtëm tregojnë se si rastet e ngjashme trajtohen në mënyrë të ndryshme.

Shembulli i parë, një rast pranë gjykatës së qarkut në Gjiilan/Gnjilane i cili kishte të bëjë me një të akuzuar për posedim të paligjshëm të një AK 47 dhe 16 plumbave. Më 26 nëntor 2003, personi në fjalë ishte dënuar me 4 muaj burg.<sup>170</sup> Në arsyetimin e vet, gjykata konsideroi si rrethanë lehtësuese se i akuzuari nuk kishte dënime paraprake, se pala e dëmtuar nuk i ishte bashkuar procedurës,<sup>171</sup> se i akuzuari ishte i martuar dhe ishte në gjendje të dobët ekonomike dhe se kishte një qëndrim të favorshëm gjatë procedurës. Si rrethanë rënduese gjykata përmendi rrethanat e përgjithshme se i akuzuari nuk kishte shfrytëzuar mundësinë për të dorëzuar armën gjatë amnestisë së armëve dhe shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale.

Ky rast mund të krahasohet me një rast tjetër pranë gjykatës së qarkut në Pejë/Peç ku një person ishte shpallur fajtor për posedim të paligjshëm të një sasie më të madhe të armëve dhe municionit. Më 4 korrik 2003 i akuzuari ishte dënuar me gjobë prej 450 euro për posedim të paligjshëm të një AK 47 dhe rreth 300 plumbave. Gjykata ishte mjaft e shkurtë në arsyetimin e dhënë mirëpo deklaroi se kishte konsideruar si rrethanë lehtësuese se i akuzuari nuk kishte qenë i dënuar mëparë, se ishte në gjendje të dobët ekonomike dhe se ishte sjellur mirë para gjykatës. Asnjë rrethanë rënduese tjetër nuk ishte përmendur.<sup>172</sup>

Është vështirë të shihet se si dallimet ndërmjet veprave penale dhe rrethanat shtesë mund të rezultojnë në dënim me gjobë në një rast mirëpo edhe të justifikojnë dënimin me burg në rastin tjetër. Mungesa e arsyetimit nga gjykata e keqëson paqëndrueshmërinë në dënime.

---

<sup>169</sup> Neni 328 KPP deklaron se kushdo që mban në pronësi, kontrollon, posedon ose përdor armë pa lejen valide për mbajtjen e autorizuar të armëve për atë armë, dënohet me gjobë deri në 7.500 EUR ose me burgim prej një deri në tetë vjet dhe se kushdo që përdor apo vringëllon armët me frikësim, kërcënim ose në ndonjë mënyrë tjetër të paautorizuar apo urdhëron personin tjetër të veprojë në mënyrë të njëjtë dënohet me gjobë deri në 10.000 EUR ose me burgim prej një deri në dhjetë vjet. Dispozitat korresponduese me dispozitat e përmendura në legjislacionin paraprak mund të gjinden në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/7 mbi autorizimin e armëmbajtjes në Kosovë.

<sup>170</sup> Vendimi ishte mbështetur nga gjykata supreme në fazën e ankesës. Gjykata supreme, në vendimin e saj të datës 27 maj 2004, kishte deklaruar se dënimi i shpallur ishte në pajtim me nivelin e përgjegjësisë penale dhe shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale.

<sup>171</sup> I akuzuari, në të njëjtin rast, ishte liruar nga akuzat për tentim vrasje. Gjykata nuk është dashur të merr parasysh pikëpamjen e palës së dëmtuar për shkak se ajo ndërlidhej me akuzat për vrasje dhe nuk ishte e rëndësishme për vendimin për shqiptimin e dënimit për posedim të paligjshëm të armëve.

<sup>172</sup> Gjykata supreme mbështeti vendimin e gjykatës më të ulët, me vendimin e vet të datës 1 qershor 2004, në fazën e ankesës, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë kishte vlerësuar në mënyrë të duhur të gjitha rrethanat që kishuin ndikim në caktimin e dënimit.



## G. Përfundimet

Arsyetimi i dënimit në shumicën e rasteve nuk është në pajtim me kërkesat e parapara me ligj. Aktgjykimet nuk ofrojnë vlerësime të detajuara dhe individualizuara të rrethanave relevante sa i përket krimit dhe kryesve të tij. Krahas kësaj, disa raste tregojnë një mungesë të përgjithshme të kuptimit sa i përket faktit se si duhet të vlerësohen rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese. Këto raste përfshijnë konsiderimin e faktorëve jorelevant që shkelin në mënyrë të drejtpërdrejtë ligjin. Mangësitë e përmendura mund të vëzhgohen në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor. Për këtë arsye nevojitet trajnim për të përmirësuar praktikën e dënimeve të gjykatave dhe arsyetimet e dhëna nga to. Një pjesë e këtyre mangësive mund të shpjegohet me mungesën e udhëzimeve për shqiptimin e dënimeve. Me qëllim të korigjimit të kësaj gjendje, gjykata supreme duhet të marrë përgjegjësinë e vet jo vetëm si një gjykatë e apelacionit mirëpo edhe si një interpretues i ligjit dhe të ofrojë arsyetime të detajuara mbi shqiptimin e dënimeve. Për më tepër në bazë të praktikës gjyqësore të duhur gjykatat e shkallës më të ulët duhet të kenë qasje në aktgjykimet e gjykatës supreme.<sup>173</sup> Veprimet e tilla duhet gjithashtu të kontribuojnë në një zbatim më të qëndrueshëm të dënimeve.

## VI. LLOJET E DËNIMEVE

### A. Llojet e dënimeve në bazë të KP të RFJ-së

Llojet më elementare të dënimeve siç parashihen me KP të RFJ-së ishin dënimi me burg, gjoba dhe konfiskimi i pasurisë.<sup>174</sup> Mëparë kjo listë përfshinte edhe dënimin me vdekje i cili ishte hequr më 10 qershor 1999.<sup>175</sup>

Në vend të kësaj, është parashikuar dënimi maksimal me 40 vjet burg. Dënimet me burg sillen prej 15 ditë deri në 40 vjet.<sup>176</sup>

#### i) *Dënimet alternative ndaj burgimit*

Legjislacioni paraprak parashikonte format e ndryshme të dënimeve alternative. Në bazë të këtij ligji, dënimet me kusht<sup>177</sup> apo qortimi gjyqësor<sup>178</sup> mund të shqiptohen për vepra më pak të rrezikshme shoqërore kur një dënim me burg konsiderohet si i panevojshëm për mbrojtjen e drejtësisë penale, dhe gjykata mendon se qortimi gjyqësor me dhe pa shqiptimin e dënimit me kusht do të mjaftojë në parandalimin e kryesit të veprës nga kryerja e veprave tjera penale.<sup>179</sup>

<sup>173</sup> Qendra Juridike e Kosovës për momentin është duke e botuar një përzgjedhje të vendimeve të gjykatës supreme. Megjithatë, Ministria e Shërbimeve Publike është përgjegjëse për botimin dhe shpërndarjen e të gjitha vendimeve të gjykatës supreme.

<sup>174</sup> Neni 34 i KP të RFJ-SË.

<sup>175</sup> Dënimi me vdekje parashihej me ligj të ish Jugosllavisë mirëpo ishte hequr me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 mbi ligjin në fuqi në Kosovë, neni 1.

<sup>176</sup> Rregullorja 2000/59 mbi ndryshimin e Rregullorës së UNMIK-ut 1999/24 mbi ligjin në fuqi në Kosovë. Paragrafi i fundit i nenit 1 shton se dënimi maksimal duhet të jetë i zbatueshëm në rastet kur dënimi me vdekje zbatohet sipas ligjit paraprak.

<sup>177</sup> Dënimi me kusht nënkupton se gjykata i shqipton një personi dënimin mirëpo deklaron se ky dënim do të ekzekutohet vetëm nëse personi kryen një krim tjetër gjatë një periudhe të caktuar. Periudha e vuajtjes së dënimit me kusht duhet të përcaktohet varësisht nga rasti dhe sillen prej një deri në pesë vjet. Lexo nenin 52(1) KP i RFJ-së. Dënimi me kusht mund të shqiptohet kur kryesi është dënuar me dënim me burg me jo më shumë se dy vjet apo me gjobë. Megjithatë, dënimi me kusht nuk mund të shqiptohet për vepër penale për të cilën parashihet dënimi maksimal prej dhjetë vjet burg apo më shumë përpos nëse aktgjykimi është shpallur me dënim të zbutur në pajtim me nenin 42 KP të RFJ-së.

<sup>178</sup> Qortimi gjyqësor mund të shqiptohet për vepër penale për të cilën parashikohet dënimi maksimal prej një vjet burg nëse është kryer nën aso rrethana lehtësuese të cilat e bëjnë atë vepër penale të lehtë. Krahas kësaj qortimi gjyqësor mund të shqiptohet për vepra penale për të cilat parashikohet dënimi maksimal prej tre vjet burg, në rastet kur ligji specifikon një gjë të tillë (Neni 59 KP i RFJ-së).

<sup>179</sup> Neni 51 i KP të RFJ-SË.

Dënimi me kusht mund të kombinohet me detyrimet dhe kushtet e caktuara siç është kthimi i fitimit pasuror të fituar nëpërmjet të veprës penale në kuadër të kufirit të caktuar kohor, për të kompenzuar dëmin e shkaktuar apo për të përmbushur detyrimet tjera të parashikuara me rregulloret e drejtësisë penale.<sup>180</sup> Si një mundësi shtesë ligji lejon që gjykata të kombinojë dënimin me kusht me mbikëqyrjen e shtuar siç janë masat e ndihmës, kujdesit, mbikëqyrjes dhe mbrojtjes.<sup>181</sup>

## *ii) Gjobat*

Në bazë të KP të RFJ-së gjoba mund të shqiptohet si dënim kryesor apo plotësues.<sup>182</sup> Në rast kur kryesi i veprës penale nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të urdhërojë që ekzekutimi i gjobës të bëhet nëpërmjet të burgut, duke zëvendësuar shumën prej 15 euro me një ditë qëndrimi në burg. Kohëzgjatja e burgimit nuk duhet të tejkalojë periudhën prej gjashtë muaj.<sup>183</sup>

## *iii) Masat e sigurisë*

Masat e sigurisë përfshijnë llojet e ndryshme të trajtimit siç janë masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe trajtimi i detyrueshëm mjekësor për të varurit nga droga dhe alkoholi dhe kufizimet specifike siç janë ndalimi i kryerjes së aktiviteteve të caktuara, paraqitjeve publike apo ngasjes së automjetit.<sup>184</sup> Krahas kësaj gjykatat mundën gjithashtu të vendosin për konfiskimin e pronës.<sup>185</sup>

## **B. Format e dënimit në bazë të KPP-së**

KPP-ja përfshin disa ndryshime sa i përket dënimeve nga të cilat më të rëndësishmet janë parashikimi i masave alternative shtesë dhe krijimi i Shërbimit Sprovues. Në bazë të ligjit dënimet kryesore janë dënimi me burg,<sup>186</sup> dënimi me burg afatgjatë<sup>187</sup> dhe gjobat.<sup>188</sup>

<sup>180</sup> Neni 52(2) i KP të RFJ-SË.

<sup>181</sup> Neni 58 i KP të RFJ-SË.

<sup>182</sup> Neni 35(2) i KP të RFJ-së. Kufijtë ligjor të paraparë për gjobë janë përcaktuar me nenin 39 KP të RFJ-së janë ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/4 mbi valutën e lejuar për shfrytëzim në Kosovë (lexo gjithashtu urdhëresën administrative 1999/2, urdhëresën administrative 2000/17 mbi implementimin e Rregullorës së UNMIK-ut 1999/4, urdhëresën administrative 2001/24, mbi ndryshimin e urdhëresës administrative 1999/2). Në bazë të këtyre ndryshimeve gjoba mund të sillet prej 50 deri në 25.000 euro përpos në rastet kur vepra penale është kryer nga lakmia. Në këto raste dënimi maksimal do të jetë përafërsisht 100.000 euro.

<sup>183</sup> Neni 39(3) KP i RFJ-së dhe Urdhëresa Administrative 2000/17 neni 2(ii) dhe Urdhëresa Administrative 2001/24, neni 3.1.

<sup>184</sup> Këto masa, të cilat mund të shqiptohen vetëm kundër një personi i cili ka kryer veprë penale, kanë për qëllim të largojnë rrethanat dhe kushtet të cilat mund të ndikojnë në kryesin e veprës penale për të kryer vepra të tjera penale.

<sup>185</sup> Lexo nenin 69 KP i RFJ-SË.

<sup>186</sup> Burgimi (ku nuk duhet të ekzistojë huti me dënimin me burg afatgjatë) nuk mund të jetë më i shkurtë se 15 ditë dhe më i gjatë se 20 vjet. Dënimi me burg prej tre muaj mund të zëvendësohet nga ana e gjykatës me gjobë, apo kur kryesi i veprës penale jep pëlqimin e tij apo saj, edhe me punë në dobi të përgjithshme [Neni 38(3) KPP].

<sup>187</sup> Njëra nga ndryshimet e prezentuara në ligjin e ri është futja e dënimit me burg afatgjatë, që sillet me kohëzgjatje prej 21 deri në 40 vjet. Ky dënim mund të parashikohet për rastet veprat penale më të rënda të kryera me qëllim nën rrethana veçanërisht rënduese apo të cilat shkaktojnë pasoja të rënda (Neni 37 KPP).

<sup>188</sup> Dispozitat në ligjin e ri sa i përket gjobave korrespondojnë me dispozitat e ligjit paraprak me të njëjtën masë dhe kufinjë kohor (Neni 39 KPP). E vetmja risi është se gjoba mund të zëvendësohet me urdër për punë në dobi të përgjithshme nëse personi i shpallur faktor nuk dëshiron apo është në pamundësi të paguajë gjobën apo nëse ai apo ajo jep pëlqimin e tij apo saj për këtë. Vetëm nëse personi

Njëra nga ndryshimet kryesore në KPP është parashikimi i dënimeve alternative si një kategori e dënimeve, përfshirë këtu edhe një sërë masash të reja, siç janë mbikëqyrja nga Shërbimi Sprovues, urdhëri për punë në dobi të përgjithshme dhe ekzekutimi i dënimit me burg në gjysëm liri.<sup>189</sup> Duke e bërë këtë KPP-ja ka modernizuar sanksionet penale në Kosovë në pajtim me standardet e përcaktuara ndërkombëtare.<sup>190</sup>

Mundësia e shfrytëzimit të dënimit me kusht<sup>191</sup> është zhvilluar dukshëm në bazë të ligjit të ri dhe në bazë të legjislacionit të tanishëm mund të kombinohet me njëren nga urdhërat e paraqitura në vazhdim:

- Urdhëri i mbikëqyrjes nga Shërbimi Sprovues;<sup>192</sup>
- Urdhëri për punë në dobi të përgjithshme;<sup>193</sup>
- Urdhëri për trajtim të detyrueshëm.<sup>194</sup>

### C. Përfundim

Si ligji i vjetër ashtu edhe ai i ri parashikojnë obligimin nga ana e gjykatës të vendos mbi një dënim të individualizuar duke marrë parasysh rrethanat specifike që ndërlidhen me të akuzuarin. Format e ndryshme të dënimeve janë parashikuar. Ligji paraparak përfshin një spektër të gjerë të masave joizoluese, mirëpo përfshin edhe mundësi të caktuara për të

---

i shpallur fajtor nuk jep pëlqimin e tij apo saj gjoba mund të zëvendësohet me dënim me burg dhe atë deri në gjashtë muaj [Neni 39(3-4) PCC].

<sup>189</sup> Kjo masë lejon që gjykata të urdhërojë ekzekutimin e dënimit me burg deri në një vit, në gjysëm liri duke marrë në konsideratë detyrimet e personit të shpallur fajtor në lidhje me punën, studimet, përgjegjësitë familjare apo nevojat mjekësore (Neni 53 KPP).

<sup>190</sup> Neni 1.5 i Rregullave të Tokios deklaron se shtetet anëtare duhet të parashikojnë masa joizoluese në kuadër të sistemeve të tyre juridike për të ofruar opsione të tjera dhe me këtë të zvogëlohet shfrytëzimi i dënimit me burg.

<sup>191</sup> Për shkak se në bazë të ligjit të vjetër dënimi me kusht mund të shpallet kur gjykata shqipton dënimin me gjobë apo dënimin me burg deri në dy vjet [Neni 44(2) KPP]. Duhet të ceket se sfondi për shqiptimin e dënimit me kusht është zvogëluar me ligjin e ri dhe kufizohet në rastet kur një person shpallet fajtor për një veprë penale për të cilën parashihet dënim maksimal deri në pesë vjet burg [Neni 44(1) KPP]. Vetëm kur dispozitat që lejojnë një dënim më të butë (p.sh dënimin nën minimumin e paraparë për atë veprë penale) zbatohet atëherë gjykata mund të shqiptojë një dënim me kusht personit të shpallur fajtor për veprë penale për të cilën parashihet dënim prej pesë deri në dhjetë vjet.

<sup>192</sup> Edhe pse, në bazë të KP të RFJ-së, ekzistonte një mundësi për të kombinuar dënimin me kusht me masën e mbikëqyrjes së shtuar, kodi i ri parashikon një mundësi të re të shqiptimit të dënimit me kusht me urdhër të mbikëqyrjes nga Shërbimi Sprovues (Neni 58 KP i RFJ-së dhe 50 KPP). Mbikëqyrja duhet të ketë për qëllim integrimin e personit të dënuar dhe mund të zgjas prej gjashtë deri në tre vjet [Neni 50(1-2) KPP]. Mbikëqyrja përfshin detyrimin për të mbajtur kontakte me Shërbimin Sprovues dhe mundet gjithashtu të kombinohet me detyrime shtesë siç janë vijimi i trajtimit, pjesëmarrja në trajnim profesional, kryerja e aktiviteteve të punës. Përmbushja e detyrimeve familjare dhe përmbajtja nga sjellja e caktuar [Neni 50(2) dhe 51 KPP].

<sup>193</sup> Risia e dytë sa i përket dënimit me kusht që përfshihet në kodin e ri është edhe mundësia e kombinimit të dënimit me punën në dobi të përgjithshme. Gjykata mund të urdhërojë që një person i dënuar të kryejë punë pa pagesë në dobi të përgjithshme për një periudhë të specifikuar kohore ndërmjet 30 dhe 240 orë të punës, Brenda një afati kohor i cili nuk duhet të jetë më i gjatë se një vjet [Neni 52(2-3) KPP]. Kjo masë mund t'i shqiptohet një personi të cilit mund t'i jepet dënim me kusht dhe kur gjykata të ketë caktuar dënimin me gjobë deri në 2.500 Euro apo dënimin me burg deri në një vjet. Megjithatë masa mund të shqiptohet vetëm me pëlqimin e personit të dënuar [Neni 52(1) KPP].

<sup>194</sup> Si alternativë e tretë, dënimi me kusht mundet gjithashtu të kombinohet me urdhërin për për trajtim të detyrueshëm rehabilitues. Këto masa mund të shqiptohen në rastet kur personi i dënuar e ka shkelur ligjin për herë të parë dhe është i varur nga droga ose alkooli, nëse gjykata konsideron se faktori kryesor që ka ndikuar në kryerjen e veprës penale është alkooli ose droga. Duhet të ceket se gjatë shqiptimit të këtyre masave gjykata nuk vendos mbi kohëzgjatjen e këtyre. Gjykata konsideron dënimin të jetë vuajtur kur programi i trajtimit rehabilitues të jetë kryer me sukses (Neni 49 PCC).

individualizuar këto masa nëpërmjet të detyrimeve përkatëse. Megjithatë, korniza strukturore dhe udhëzimet për implementimin e këtyre detyrimeve mungon.

Ligji i ri spikat dhe parashikon një sërë masash joizoluese në dispozicion të gjykatave. Kur ligji i vjetër i referohej në mënyrë të përgjithshme masave të ndryshme, ligji i ri përkufizon në mënyrë të qarta, që duhet t'u jep gjykatave udhëzime të qarta sa i përket implementimit të këtyre masave.

## **VII. SHFRYTËZIMI I FORMAVE TË NDRYSHME TË DËNIMIT**

Në vitin 2003, 6.282 persona ishin dënuar për vepra penale në gjykatat komunale dhe të qarkut në Kosovë.<sup>195</sup> Nga këto, 1.862 persona ishin dënuar me burg përderisa 4.420 ishin dënuar me qortim gjyqësor, dënim me kusht apo me gjobë.<sup>196</sup> Nga masat joizoluese, dënimet me kusht janë zbatuar në mënyrë të zakonshme. Duhet të ceket se gati gjysma e të gjitha dënimeve në gjykatat komunale dhe përafërsisht një e treta e rasteve në gjykatat e qarkut janë dënime me kusht.<sup>197</sup> Sa i përket shfrytëzimit të dënimit me burg, 25 përqind e dënimeve nga gjykatat komunale dhe gati gjysma e dënimeve nga gjykatat e qarkut përbëhen nga dënimet izoluese.<sup>198</sup> Një studim më i përafërt i aktgjykimeve bën me dije se një e treta e personave të shpallur fajtor për kryerjen e veprave penale kundër jetës dhe trupit ishin dënuar me burg,<sup>199</sup> krahasuar me përafërsisht dy të tretat<sup>200</sup> e personave të dënuar për vepra penale kundër pronës.

Monitorimi i dënimeve ka vënë në pah dy fusha kryesore të shqetësimeve:

- Mungesa e kapacitetit institucional e cila kufizon në mënyrë serioze brezin e masave alternative në dispozicion; dhe,
- preferimi për shqiptimin e masave izoluese që shfaqet në shumë raste.

### **A. Mungesa e kapacitetit institucional**

Pa një kapacitet institucional për të implementuar masat e parashikuara me ligj, këto masa nuk paraqesin një alternativë reale për gjykatat. Edhe pse përpjekjet janë bërë për të vendosur një kapacitet të nevojshëm institucional, me themelimin e Shërbimit Sprovues, vakumet institucionale ende kufizojnë mundësitë e gjykatave për të zbatuar dënimet e ndryshme. Ky problem është veçanërisht serioz sa i përket kryesve të mitur.

---

<sup>195</sup> Nga numri i gjithëmbarshtëm prej 6.282, 4.870 persona janë dënuar nga gjykatat komunale përderisa 1.412 nga ato të qarkut. Kurtoazi e DAGj-së.

<sup>196</sup> Kurtoazi e DAGj-së.

<sup>197</sup> Në gjykatat komunale 2.394 nga 4.870 dënime ishin dënime me kusht në vitin 2003. Gjatë të njëjtit vit 481 nga gjithsejt 1.412 dënime të shqiptuara nga gjykatat e qarkut ishin dënime me kusht. Kurtoazi e DAGj-së.

<sup>198</sup> Nga gjithsejt 4.870 persona të shpallur fajtor nga gjykatat komunale, 1.200 ishin dënuar me burg. Nga gjithsejt 1.412 persona të shpallur fajtor nga gjykatat e qarkut, 662 ishin dënuar me burg. Kurtoazi e DAGj-së.

<sup>199</sup> Nga gjithsejt 423 persona të cilët kishin kryer vepra penale kundër jetës dhe trupit, 127 kishin marrë dënime izoluese. Kurtoazi e DAGj-së.

<sup>200</sup> Nga gjithsejt 904 persona të cilët kishin kryer vepra penale kundër pronës, 556 kishin marrë dënime izoluese. Kurtoazi e DAGj-së.

*i) Mungesa e institucioneve të duhura*

Masat e trajtimit të detyrueshëm rehabilitues për të varurit nga droga dhe alkoholi kanë ekzistuar në bazë të ligjit paraprak si një formë e masave të sigurisë.<sup>201</sup> Në ligjin e ri këto masa mund të shqiptohen në mënyrë teorike si në mënyrë të pavarur gjithashtu edhe në kombinim me dënimin me kusht.<sup>202</sup> Në praktikë, megjithatë, për shkak të mungesës së institucioneve të cilat ofrojnë një trajtim të tillë, këto masa për momentin nuk mund të ekzekutohen.<sup>203</sup>

Krahas kësaj, nuk ekziston ndonjë kapacitet për ekzekutimin e një urdhëri të gjykatës për gjysëm liri për shkak se nuk janë bërë kurrfarë përgatitje gjer më tani nga Divizioni i Menaxhimit Penal për t'u përgatitur për këtë masë të re. Përderisa qendrat përmirësuese të mos kenë kapacitet për të siguruar që kryesit të plotësojnë kushtet për shqiptimin e gjysëm lirisë, kjo masë nuk mundet të zbatohet në mënyrë efikase.

*ii) Shërbimi Sprovues*

Njëra nga ndryshimet kryesore të përfshira në ligjin e ri është edhe krijimi i një sërë detyrimesh dhe detyrash për Shërbimin Sprovues, institucion ky i cili kishte filluar me punë në vitin 2002. Shërbimi Sprovues ishte rritur dukshëm që nga atëherë dhe për momentin punëson 48 oficerë në tërë Kosovën.<sup>204</sup>

Shërbimi Sprovues i Kosovës përballet me një vështirësi siç është mungesa e kuptimit për rëndësinë e punës së tij në kuadër të Departamentit të Drejtësisë mirëpo edhe mungesa e resurseve.<sup>205</sup> Shërbimit Sprovues nuk i është miratuar buxheti i vet deri në mars 2004. Para kësaj periudhe Shërbimi është dashur të mbështetet kryesisht në mbështetjen e drejtpërdrejtë financiare nga donatorët. Trazirat në burgun e Dubravës dhe nevojat e identifikuar nga Komisioni i Dubravës rezultuan në kanalizimin e resurseve ekzistuese drejt burgjeve në vend të derdhjes së tyre në Shërbimin Sprovues.

Në të trija rajonet ku ata janë të pranishëm, oficerët sprovues kanë përqëndruar kryesisht punën e vet në përgatitjen e hetimeve sociale për rastet e kryesve të mitur. Shërbimi nuk ka qenë i përfshirë në rastet e kryesve të rritur të dënuar me masa alternative edhe pse kontaktet dhe përgatitjet janë bërë për të lejuar masat e mbikëqyrjes dhe punës në dobi të përgjithshme kur rastet e tilla lindin në praktikë. Ligji gjithashtu parasheh që Shërbimi Sprovues të mbikëqyr urdhërat e gjykatës për pjesëmarrje në trajtimin e detyrueshëm rehabilitues, trajnim profesional, në përmbushjen e detyrimeve në punë dhe atyre familjare dhe në përmbajtjen nga sjellja e caktuar. Nën rrethanat e caktuara Shërbimi Sprovues nuk ka kapacitet për të kryer këto detyra nëse dhe kur të urdhërohen nga gjykata si të tilla.

<sup>201</sup> Neni 65 KP i RFJ-së.

<sup>202</sup> Nenet 49 and 77 KPP.

<sup>203</sup> Shqetësime të ngashme mund të ngriten edhe sa i përket trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe mungesës së një institucioni të sigurtë spitalor për zbatimin e këtyre masave. Këto masa nuk do të konsiderohen për shkak se ato nuk paraqesin dënim. Megjithatë, OSBE-ja ka raportuar mbi to në raportet e kaluara, për këtë lexo Shqyrtimin e Sistemit të Drejtësisë Penale (mars 2002 – prill 2003) "Mbrojtja e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale" faqe 34.

<sup>204</sup> Në tetor 2004 Shërbimi Sprovues kishte një zyre në Prizren me tre oficerë, një zyre në Prishtinë/Priština me dhjetë oficerë, dhe një zyre në Mitrovicë/Mitrovica me gjashtë oficerë sprovues. Krahas kësaj tre persona jnë punësuar për të punuar në selinë e këtij shërbimi në Prishtinë/Priština. Nga 1 nëntori 2004, 28 oficerë të rinj do të rekrutohen për të punuar në zyret regjionale në Gjiilan/Gnjilane dhe Pejë/Peć, dhe për të rritur numrin e stafit në zyret ekzistuese. Pas kësaj, Shërbimi Sprovues duhet të ketë kapacitet për të mbuluar tërë rajonin e Kosovës.

<sup>205</sup> Intervistë me oficerët sprovues ndërkombëtar të KB-ve 20 korrik 2004.

## B. Shfrytëzimi i tepruar i dënimit me burg

Shfrytëzimi i dënimit me burg si formë kryesore e dënimit është mjaft i përhapur në Kosovë.<sup>206</sup> Siç u tha më lartë, një studim i aktgjykimeve tregon shumë pak konsideratë për rrethanat e posaçme të secilit kryes, ndikimin që dënimi mund t'a ketë në kryesin dhe mundësinë e marrjes së masave joizoluese.

Rastet e paraqitura në vazhdim janë shembuj të mirë ku gjykata me sa duket ka dështuar të marrë në konsideratë shfrytëzimin e masave alternative siç është dënimi me kusht apo gjoja.

Në një rast pranë gjykatës komunale në Prishtinë/Priština, dy të akuzuar ishin shpallur fajtor më 3 tetor 2003 për kryerjen e veprës penale vjedhje në bashkëpjesëmarrje dhe ishin dënuar me nga tre muaj burg secili.<sup>207</sup> Dy të akuzuarit kishin vjedhur para nga një burri i moshuar dhe kishin ikur nga vendi i ngjarjes. Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata kishte konsideruar në mesin e faktorëve lehtësues dhe atë se të akuzuarit ishin të rinjë, se nuk kishin qenë të dënuar mëparë dhe se njëri nga ta kishte familje. Si rrethanë rënduese gjykata i kishte konsideruar rrethanat në të cilat ishte kryer vepra penale përfshirë këtu edhe moshën e palës së dëmtuar. Edhe pse dënimi nga gjykata bie kryesisht në kuadër të kornizës ligjore të krimit, është e vlefshme të përmendet se në arsyetimin e gjykatës mund të shihet se ajo nuk e ka konsideruar fare shqiptimin e masave joizoluese.

Gjykata e qarkut në Prizren, më 18 gusht 2004, dënoi dy meshkuj me nga gjashtë muaj burg për blerje të paligjshme, posedim dhe distribuim të narkotikëve. Njëri nga të akuzuarit kishte blerë 175g të marihuanës me qëllim të rishitjes së saj. I akuzuari i dytë kishte njohuri për këtë dhe kishte përdorur personalisht 11 gramë të marihuanës. I akuzuari i tretë ishte liruar. Gjykata deklaroi se kishte marrë në konsideratë moshën e re të të pandehurve, sjelljen e tyre të mirë para gjykatës dhe faktin se ata nuk ishin dënuar mëparë dhe se kishin premtuar se nuk do të kryejnë më krime në të ardhmen. Faktori i vetëm rëndues i marrë parasysh nga gjykata ishte shtimi i numrit të krimeve të ngjashme në Kosovë. Gjykata nuk i'u kishte referuar zbatueshmërisë së masave alternative dhe as nuk kishte arsyetuar se përse kishte vendosur në favor të dënimit me burg.

Në rastet e tilla, të akuzuarit kishin kryer vepër penale për herë të parë dhe se krimet e tyre nuk përfshinin në veti dhunën. Në rastet e tilla shquhet se si gjykata kishte dështuar të marrë parasysh zbatimin e masave alternative pra atyre joizoluese.

Në shumë raste, gjykatat duket t'i japin shumë pak konsideratë zbatimit të masave alternative joizoluese, kur masat e tilla do të mund të tregoheshin si adekuate. Masat alternative që janë duke u shfrytëzuar janë qortimi gjyqësor, gjobat dhe dënimi me kusht. Në bazë të ligjit paraprak, gjykatat shumë rrallë kishin kombinuar dënimin me kusht me detyrimet e posaçme apo mbikëqyrjen mbrojtëse për shkak të mungesës së materialeve të nevojshme dhe organizatave për ekzekutimin e këtyre masave.<sup>208</sup> Si rrjedhojë e kësaj këto masa u harruan dhe nuk u vënë re.

<sup>206</sup> Riza Loci, *Zbatimi i sanksioneve dhe masave alternative në rastet pranë gjykatave në Kosovë*, Studimet ligjore në Kosovë, Vol.4, 2003, (Prishtinë/Priština, Qendra Juridike e Kosovës, 2003) faqe 15.

<sup>207</sup> Neni 134(1) KPK-së dhe Neni 22 KP i RFJ-SË.

<sup>208</sup> Lexo Riza Loci, *Zbatimi i sanksioneve dhe masave alternative në rastet pranë gjykatave në Kosovë*, Studimet ligjore në Kosovë, Vol.4, 2003, (Prishtinë/Priština, Qendra Juridike e Kosovës, 2003) faqe 16.

## C. Mungesa e mirëpritjes së masave të reja

Përkundër parashikimit me ligjin e ri të një sërë masave alternative ndaj dënimit me burg, gjykatat gjer më tani (deri në kohën e përpilimit të këtij raporti) kanë treguar një hezitim të madh sa i përket zbatimit të këtyre masave. Gjer më tani nuk kemi hasur në ndonjë rast ku është caktuar dënimi me kusht dhe mbikëqyrja e tij nga Shërbimi Sprovues i Kosovës; në asnjë rast të dënimit me kusht të kombinuar me urdhërin për punë në dobi të përgjithshme për të rriturit; dhe në asnjë rast ku është bërë zëvendësimi i dënimit me burg me punën në dobi të përgjithshme. Duhet të ceket se me hyrjen në fuqi të KPP-së dizpozitat mbi dënimet dhe masat alternative janë bërë menjëherë të zbatueshme në rastet kur ato konsiderohen më të favorshme për të akuzuarit.<sup>209</sup>

Arsyeja pas këtij hezitimi të gjykatave për të zbatuar këto masa të reja mund t'i atribuohet një sërë faktorëve përkatës përfshirë këtu edhe mungesën e njohjes së ligjit të ri dhe mungesën e kuptimit të qëllimit të masave të tilla alternative.

## D. Ekzekutimi i dënimit me burg

Në pajtim me parimin e intervenimit minimal, standardet ndërkombëtare kërkojnë nga organet kompetente të marrin parasysh një brez të gjerë të alternativave pas dënimit kundrejt burgimit.<sup>210</sup> Lirimi i kryesit të veprës penale nga institucioni dhe vendosja e tij në një program jondëshkues duhet të konsiderohet në një fazë sa më të hershme që është e mundur.<sup>211</sup>

Krahas sanksionit të gjysëm lirisë, ekzistojnë dy forma të liritit të hershëm në Kosovë. Sistemi i liritit diskrecionar (lirimi me kusht) dhe sistemi i liritit të detyrueshëm (lirimi i hershëm).<sup>212</sup>

### i) *Shfrytëzimi në praktikë i liritit me kusht*

Që nga fillimi i vitit 2002, Komisioni për Lirim me Kusht ka shtuar gradualisht punën e vet. Që nga tetori i vitit 2004, përafërsisht 240 raste janë shqyrtuar. Në bazë të Politikës së Përkohshme mbi Lirimin me Kusht për Personat e Dënuar, komisioni do të konsiderojë në mënyrë sistematike të gjithë të burgosurit dhe të miturit që përmbushin kushtet për lirim me kusht.<sup>213</sup>

Problemi kryesor me të cilin është përballur komisioni gjer më tani, janë rastet e pazgjidhura të akumuluar. Në tetor 2004, ishin përafërsisht rreth 90 raste të cilat pritnin shqyrtimin nga

<sup>209</sup> Neni 2 KPP.

<sup>210</sup> Neni 9.1 Rregullat e Tokios. Lexo Rekomandimin Nr. R (99) 22. Shtojcën, paragrafet 10 dhe 23 të Këshillit të Evropës.

<sup>211</sup> Neni 9.4 Rregullat e Tokios.

<sup>212</sup> Ligji lejon lirim me kusht të të burgosurve të cilët kanë vuajtur gjysmën e dënimit të tyre me burg [lexo nenin 80 KPPP, përkitazi me ligjin paraprak lexo nenet 38(6) KP i RFJ-së dhe 9 KPK]. Procedura për lirim me kusht është përshkruar në qarkoren e drejtësisë 2002/7 mbi politikën e liritit me kusht të miratuar nga Divizioni i Menaxhimit Penal/Shërbimi Korrektues i Kosovës, 24 shtator 2002, i ndryshuar me qarkoren e drejtësisë 2003/6, 10 tetor 2003. Qarkorja e drejtësisë krijoi një komision të liritit me kusht i cili mund të vendos mbi lirim me kusht në rastet individuale.

Sa i përket liritit të hershëm drejtorit institucional i burgut mund të lirojë një të burgosur i cili ka vuajtur tre të katërtat e dënimit të tij me burg gjer në tre muaj para skadimit të dënimit të shqyrtuar (lexo nenin 169 të ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, i cili është shtjelluar më tutje në Qarkoren e Drejtësisë 2001/25 politika e liritit të hershëm për personat e dënuar, 28 nëntor 2001).

<sup>213</sup> Qarkorja e Drejtësisë 2003/6 mbi ndryshimin e Qarkores së Drejtësisë Nr. 2002/7 mbi politikën e liritit me kusht të miratuar nga Divizioni i Menaxhimit Penal/Shërbimi Korrektues i Kosovës, 10 tetor 2003. OSBE-ja ka pasur vështirësi në vërtetimin se a është duke i konsideruar rastet komisioni sipas detyrës zyrtare apo në bazë të kërkesës të vet të burgosurit.

ana e Komisionit për Lirim me Kusht.<sup>214</sup> Për të korigjuar këtë, komisioni është takuar dy deri në tre herë në muaj duke shqyrtuar përafërsisht dhjetë aplikacione për çdo seancë. Janë bërë përpjekje të mëdha për përmirësimin e efikasitetit të punës së komisionit dhe shqyrtimit më ekspeditiv të kërkesave të personave të sëmurë. OSBE-ja mirëpret këto përpjekje për të siguruar që të gjithë të burgosurit që përmbushin kushtet për lirim me kusht të merren parasysh për lirim nga komisioni pa vonesë.

## E. Përfundimet

Edhe pse një sërë masash që janë përfshirë në ligj nuk janë në dispozicion praktikisht për shkak të mungesës së kapacitetit institucional, kufizimi kryesor në zbatimin e masave alternative jondëshkuese është hezitimi i gjykatave për të implementuar këto masa. Gjykatat deri më tani kanë preferuar që të mbesin pranë masave burgimore, e cila praktike nuk do të ndihmojë problemin e numrit të madh të personave në burgje.

## VIII. DËNIMI I TË MITURVE DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Të miturit të cilët bijnë në kundërshtim me ligjin kanë të drejtë për mbrojtje speciale. Procedura penale dhe në veçanti privimi nga liria mund të kenë ndikim në edukimin e të miturit dhe zhvillimin psikik të tij. Masat mbrojtëse speciale janë krijuar për mbrojtjen e të miturve në sistemin e drejtësisë penale. Një pjesë e këtyre masave mbrojtëse ndërlihen me dënimin e kryesve të mitur, që rregullohet ndaras nga masat që vlejné për të rriturit.<sup>215</sup>

Instrumenti më i rëndësishëm për mbrojtjen e të miturve është Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmiut (KMDF).<sup>216</sup> KMDF përcakton një sërë parimesh themelore që duhet të udhëzojnë procedurën penale dhe shfrytëzimin e paraburgimit dhe dënimin me burg. Më e rëndësishmja nga gjithë këto është parimi i *interesit më të mirë të fëmiut* që deklaron se: Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me një fëmijë, qoftë ato të ndërmarrë nga institucionet publike apo ato private të mirëqenies, gjyqet, organet administrative dhe ato legjislative, konsideratë parësore duhet t'i jepet interesit më të mirë të fëmiut.<sup>217</sup> Së këndejmi gjykata është e detyruar të jap një konsideratë të duhur interesit të fëmiut në të gjitha fazat e procedurës penale.

Krahas kësaj KMDF-ja i referohet qëllimit të drejtësisë për të mitur duke deklaruar se drejtësia për të mitur duhet të veprojë për të promovuar “reintegrimitin e fëmiut dhe luajtjen e një roli konstruktiv nga ana e fëmiut në shoqëri.”<sup>218</sup> Në bazë të rregullave të Pekingut, “sistemi i drejtësisë për të mitur duhet të theksojë mirëqenien e të miturit dhe të sigurojë se

<sup>214</sup> Një pjesë e këtij grumbullimi të rasteve të pazgjidhura ishte krijuar si rrjedhojë e pezullimit të mbajtjes së mbledhjeve të komisionit në periudhën ndërmjet majit dhe qershorit 2004.

<sup>215</sup> Në bazë të legjislacionit paraprak shfrytëzoheshin disa terme të ndryshme për t’ju referuar kryesve të moshës nën 18 vjet (fëmi, i mitur, i mitur i ri dhe i mitur i vjetër). Disa terme të ngjashme shfrytëzohen nga kodi i ri (fëmi, të mitur dhe të rritur të rinjë). Në bazë të kodit të ri këto terme mund të përfshijnë kryesit e moshës deri në 21 vjet [Lexo nenin 2 të Rregullorës së UNMIK-ut 2004/8 mbi Ligjin Penal për të Mitur në Kosovë (LPM)]. Për t’ju shmangur hutisë në kemi zgjedhur që t’ju referohemi të miturve si çdo personi i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë më i vjetër se 14 vjet, dhe në këtë mënyrë përgjegjës për veprimet e tij, dhe më i ri se 18 vjet.

<sup>216</sup> Konventa mbi të Drejtat e Fëmiut, e miratuar me Rezolutën e Asemblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 44/25 të nëntorit 1989 (KDF).

<sup>217</sup> Neni 3(1) KDF. Lexo gjithashtu Rregullat Minimale të Standardeve të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur (Rregullat e Pekingut), të miratuara me Rezolutën e Asemblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 40/33 të 29 nëntorit 29 1985 paragrafi 14.2, i cili thotë se “Procedurat mbahen në favor me interesin më të mirë të të miturit dhe në një atmosferë të mirëkuptimit i cili i’u mundëson të miturve të marrin pjesë në to dhe të shprehin lirisht gjatë zhvillimit të tyre.”

<sup>218</sup> Neni 40(1) KDF.



çfarëdo reagimi ndaj kryesve të mitur duhet të jetë në proporcion me rrethanat e të miturit dhe veprës penale.”

Asnjë dënim nuk duhet të përcaktohet duke i’u referuar kryesisht peshës së krimit. Vlerësimi i dënimit të duhur duhet të shqyrtojë rrethanat individuale të kryesit dhe ndikimin që ky sanksion mund të ketë në të miturin.<sup>219</sup>

Në pajtim me këto parime të përgjithshme, shfrytëzimi i masave izoluese që do të jenë në pajtim me ligjin vendës, do të kufizohen vetëm në ato raste ku nuk ka mundësi tjetër të arsyeshme dhe do të kufizohen në një kohë sa më të shkurtë.<sup>220</sup> Më tutje masat ndëshkuese izoluese duhet të shfrytëzohen vetëm nëse i mituri ka kryer veprë penale të rëndë ku përfshihet ushtrimi i dhunës kundër personit tjetër, apo në disa vepra penale të caktuara që përfshijnë veprat penale ku nuk ekziston mundësi për ndonjë masë tjetër të duhur.<sup>221</sup>

Pjesët e paraqitura në vazhdim do të trajtojnë çështjen se si legjislacioni vendës në Kosovë është në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe se si këto dispozita zbatohen në praktikë.

## **IX. MASAT NË FUQI KUNDËR KRYESVE TË MITUR**

### **A. Masat në fuqi në bazë të KP të RFJ-së**

Në bazë të KP të RFJ-së një kryes i mitur i cili ka qenë i moshës prej 14 deri në 16 vjet në kohën e kryerjes së veprës penale nuk mundet të dënohet formalisht mirëpo vetëm mundet t’i nënshtrohet masave edukuese. Një i mitur mbi moshën 16 vjeçare, mirëpo i cili ende nuk i ka mbushur 18 vjet mund t’i nënshtrohet vetëm masave edukuese dhe përjashtimisht mund të dënohet me burg për të mitur.<sup>222</sup> Qartazi, dënimi me kusht nuk mund të shqiptohet kundër një të mituri.<sup>223</sup>

#### *i) Masat edukuese*

Ligji paraprak parashikonte tre forma të masave edukuese, disiplinore, të mbikëqyrjes intenzive dhe masave institucionale.<sup>224</sup> Masa më së paku rigoroze ishte masa disiplinore e cila përfshinte qortimin dhe dërgimin në qendrën disiplinore.<sup>225</sup> Mbikëqyrja intenzive ishte e zbatueshme kur ishin të nevojshme masat e edukimit, rehabilitimit apo trajtimit me mbikëqyrje adekuate.<sup>226</sup> Ligji parashikonte që mbikëqyrja të kryhet vetëm nga prindërit,

<sup>219</sup> Lexo Rregullat e Pekingut paragrafi 5.1.

<sup>220</sup> Neni 37(b) KDF.

<sup>221</sup> Rregullat e Pekingut paragrafi 17.1.

<sup>222</sup> Neni 73 KP i RFJ-së. Masat edukuese dhe burgimi për të mitur, në bazë të KP të RFJ-së, kishin për qëllim të posaçëm edukimin, rehabilitimin dhe zhvillimin e duhur të kryesve të mitur nëpërmjet të mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes së shtuar për ta, duke i’u siguruar trajnim nga ekspertët dhe duke zhvilluar përgjegjësinë personale të tyre. Krahas kësaj, qëllimi i burgimit për të mitur është të ushtrohet ndikim i posaçëm në kryesit e mitur me qëllim të parandalimit të tyre nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe frenimi i të miturve të tjerë nga kryerja e veprave penale (Neni 74 KP i RFJ-së).

<sup>223</sup> Lexo nenin 73(4) KP i RFJ-së. Ky nen gjithashtu deklaroi se qortimi gjyqësor nuk mund t’i shqiptohet një të mituri, megjithatë në bazë të nenit 12 të KPK-së gjykata mund të qortojë të miturin duke spikatur karakterin dëmtues të veprimeve të tij/saj. Sa i përket dënimit me kusht të kryesve të mitur të moshës mbi 21 vjet në kohën e mbajtjes së gjykit lexo nenin 81(4) KP të RFJ-së.

<sup>224</sup> Neni 75(2) KP i RFJ-së. Lexo gjithashtu nenin 13 – 21 KPK.

<sup>225</sup> Dërgimi mund të bëhet qoftë për disa orë të caktuara gjatë ditës apo për një qëndrim të vazhdueshëm në atë institucion për një periudhë kohore maksimale prej 20 ditësh. Gjatë kësaj periudhe i mituri nuk duhet të lejohet që të ngec në ndjekjen e mësimëve. Lexo nenin 13 KPK dhe nenet 267 – 273 të ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale.

<sup>226</sup> Neni 75 KP i RFJ-së.

familja e caktuar apo organi i kujdestarisë.<sup>227</sup> Mbikëqyrja mund të zgjas prej një deri në tre vjet.<sup>228</sup>

Masat institucionale duhet të shqiptohen kur është e nevojshme që i mituri të shkëputet komplet nga mjedisi i tij apo saj.<sup>229</sup> Këto masa përfshijnë referimin në një ent edukues (për shembull ndërmjet gjashtë muaj dhe tre vjet) apo në një institucion edukues-korrektues (ndërmjet një dhe pesë vjet).<sup>230</sup> Për më tepër, ligji parashikon mundësinë e lirimit me kusht nga institucioni edukues korrektues.

## ii) *Dënimi me burg për të mitur*

Dënimi me burg për të mitur vlen vetëm për kryesit që kanë qenë të moshës ndërmjet 16 dhe 18 vjet në kohën e kryerjes së veprës, kur i mituri ka kryer një vepër penale të dënueshme me më shumë se 5 vjet burg, dhe kur masat edukuese konsiderohen si të pamjaftueshme për shkak të pasojave të rënda të veprës dhe shkallës së lartë të përgjegjësisë.<sup>231</sup> Edhe pse burgu për të mitur nuk duhet të tejkalojë maksimumin e dënimit me burg të paraparë për atë krim, gjykata nuk është e lidhur nga minimumi i përcaktuar me ligj i dënimit.<sup>232</sup> Kohëzgjatja maksimale për dënimin me burg për të mitur ishte 10 vjet.<sup>233</sup>

## **B. Masat e zbatueshme në bazë të Ligjit Penal për të Mitur**

Gjatë reformimit të ligjit penal gati të gjitha dispozitat që kanë të bëjnë me kryesit e mitur ishin konsoliduar në kuadër të Rregullores së UNMIK-ut 2004/8 mbi Ligjin Penal për të Mitur në Kosovë duke i'u lehtësuar të gjitha palëve që të gjejnë dhe zbatojnë dispozitat gjegjëse.<sup>234</sup> Ligji i ri potencon se gjykatat duhet të shqiptojnë dënimin më të duhur duke marrë parasysh veprën penale dhe rrethanat që rrethojnë kryesin. Moshë, zhvillimi psikik, karakteri, zotësia, motivet, arsimi, mjedisi, dënimet e kaluara dhe rrethanat tjera që mund të ndikojnë në

---

<sup>227</sup> Sipas kodit paraprak gjykata mund të kombinojë masën e mbikëqyrjes së shtuar me një sërë detyrimesh të cilat duhet t'i përmbush i mituri siç janë kërkimi i faljes palës së dëmtuar, vijimi i rregullt i shkollës, pranimi i punësimit, paraqitja në institucionet mjekësore, pjesëmarrja në punën e komunitetit etj.

<sup>228</sup> Nenet 14 – 17 KPK. Kohëzgjatja e masës nuk vendoset në kohën e caktimit fillestar të dënimit mirëpo varet nga zhvillimi i të miturit. Gjykata e cila i shqipton këto masa vendos mbi përfundimin e saj.

<sup>229</sup> Neni 75 KP i RFJ-së.

<sup>230</sup> Ligji gjithashtu parashihet dërgimin në një institucion të posaçëm i cili dërgim duhet të zgjas aq sa është e nevojshme për t'u realizuar trajtimi dhe rehabilitimi mjekësor, lexo nenin 21 KPK. KPK-ja nuk i referohet mëtejse se cilit institucion i mituri duhet t'i dërgohet, mirëpo megjithatë duket se qëndrimi institucional duhet të jetë më shumë i ndërlidhur me nevojat mjekësore të të miturit sesa me sanksionin penal (lexo gjithashtu nenet 285, 319 – 323 të ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale të cilat flasin për institucionet e të miturve të hendikepuar). Këto masa nuk janë të përfshira në këtë raport. Ligji i referohet entit edukativ si një institucion i mbrojtjes sociale për edukimin e fëmijëve dhe të rinjëve, përdërisa institucioni edukues-korrektues duhet të themelohet vetëm për këtë qëllim dhe mund të jetë i llojit të hapur, gjysëm të hapur dhe të mbyllur. Lexo nenet 299, 300 dhe 303 të ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale.

<sup>231</sup> Neni 77 KP i RFJ-së.

<sup>232</sup> Neni 25(2) KPK. Ligji i vjetër nuk ishte i qartë sa i përket kohëzgjatjes minimale të burgimit të të miturit. Neni 78 KP i RFJ-së deklaroi se burgimi për të mitur nuk duhet të jetë më i shkurtë se një vjet dhe më i gjatë se dhjetë vjet. Megjithatë, kjo dispozitë nuk përfshihet në KPK dhe siç do të mund të shihet mëposhtë, në praktikë gjykatat në atë kohë kishin shqiptuar dënime me burgim për të mitur që ishin më shkurta se një vjet.

<sup>233</sup> Neni 78 KP i RFJ-së.

<sup>234</sup> LPM-ja përkufizon të miturin si një person deri në moshën 21 vjeçare (lexo nenet 9 dhe 10 LPM). LPM-ja për këtë arsye është e zbatueshme, në raste të caktuara, edhe për kryesit deri në moshën 21 dhe përjashtimisht edhe të atyre deri në moshën 23 vjeçare.

efikasitetin e këtyre masave janë të gjithë faktorë që duhet të merren parasysh.<sup>235</sup> Ligji penal për të mitur përfshin parimin e interesit më të mirë të fëmiut si një nga parimet udhëzuese gjatë vendosjes së çfarëdo mase apo dënimi.<sup>236</sup> Në dritën e shfrytëzimit të sanksioneve joizoluese, Ligji Penal për të Mitur thekson se privimi nga liria duhet të shqiptohet vetëm si masë e fundit dhe duhet të jetë i kufizuar në një periudhë sa më të shkurtë kohore. Sanksionet dhe masat e përfshira në LPM janë; masat e diversitetit; masat edukuese; gjobat; urdhëri për punë në dobi të përgjithshme dhe dënimi me burg për të mitur.<sup>237</sup>

Nëse kryesi i veprës penale është i moshës nën 16 vjet në kohën e kryerjes së krimit, atëherë gjykata mund të shqiptojë masat e diversitetit apo ato edukuese. Një ndryshim i rëndësishëm në kodin e ri është gjithashtu se gjykata duhet të vendos mbi kohëzgjatjes e secilës masë apo për dënimin përkatës në vendimin e vet fillestar.<sup>238</sup> Më tutje, gjykata mund të urdhërojë pezullimin e dënimit izolues gjatë shqiptimit të dënimit me burg për të mitur apo masës së dërgimit në institucionin edukativ apo edukativo-korrektues deri në dy vjet.<sup>239</sup>

#### *i) Masat e diversitetit*

LPM-ja për herë të parë fut në legjislacionin penal të Kosovës termin “masat e diversitetit”. Këto masa të cilat mund të shqiptohen nga prokurori apo gjyqtari për të mitur, përfshijnë ndërmjetësimin ndërmjet kryesit dhe palës së dëmtuar apo kryesit dhe familjes së tij apo saj, kompenzimit të palës së dëmtuar, vijimit të rregullt në shkollë, punësimit dhe aftësimin profesional, punës në dobi të përgjithshme, edukimit në rregullat e trafikut dhe këshillimit psikologjik. Duhet të ceket se këto masa mund të shqiptohen vetëm pasi i mituri të ketë pranuar përgjegjësinë e tij/saj për krimin dhe pasi të ketë shprehur gatishmërinë për t’u pajtuar me palën e dëmtuar dhe kryerjen e këtyre masave.<sup>240</sup> Këto masa kanë për qëllim të kufizojnë efektet negative të procedurës penale në të miturin dhe mund të shqiptohen kundër një të mituri i cili ka kryer veprë penale për të cilën është paraparë dënim me gjobë apo me burgim me tri vjet ose më pak.

#### *ii) Masat edukative*

Brezi i masave edukative nuk ka ndryshuar dukshëm nga ai i paraparë me regjimin juridik të kaluar.<sup>241</sup> Këto masa përfshijnë:

- Masat disiplinore, siç është qortimi gjyqësor dhe dërgimi i të miturit në qendër disiplinore;
- Masat e mbikëqyrjes së shtuar janë mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, nga prindi adoptues ose kujdestarit të të miturit,
- Masat institucionale edukative janë dërgimi i të miturit në institucion edukues, në institucion edukues korrektues dhe në institucionin e kujdesit të posaçëm.

Kohëzgjatja e masave edukative mund të mos tejkalojë kohëzgjatjen maksimale të burgimit të paraparë për atë veprë penale, përderisa masat e mbikëqyrjes së shtuar duhet të zgjasin ndërmjet tre muaj dhe dy vjet (gjë që paraqet një zvogëlim në krahasim me legjislacionin e kaluar). Megjithatë kohëzgjatja e masave edukative do të caktohet nga gjykata gjatë

<sup>235</sup>Neni 7 LPM.

<sup>236</sup> Neni 7(1) LPM.

<sup>237</sup> Neni 6 LPM.

<sup>238</sup> Neni 6(4) LPM.

<sup>239</sup> Neni 6(5) LPM.

<sup>240</sup> Neni 14 LPM.

<sup>241</sup> Neni 17 LPM.

shqiptimit të masës duke eliminuar disa nga paqartësitë e kaluara të ndërlidhura me masat edukative.

### *iii) Urdhërat për punë në dobi të përgjithshme*

Tani ekziston edhe mundësia e zëvendësimit të masave edukuese institucionale apo burgimit për të mitur me urdhërin për punë në dobi të përgjithshme. Nëse i mituri jep pëlqimin e tij apo saj gjykata mund të jap urdhër për punë në dobi të përgjithshme në vend të urdhërit të masës edukative deri në tre vjet, burgimit për të mitur deri në dy vjet dhe gjobës. Puna në dobi të përgjithshme duhet të zgjas për një periudhë të caktuar kohore ndërmjet 30 dhe 120 orë. Caktimi i llojit dhe kushteve të punës bie në përgjegjësi të Shërbimit Sprovues.<sup>242</sup>

### *iv) Burgimi për të mitur*

Përderisa legjislacioni paraprak nuk ka qenë i qartë sa i përket kohëzgjatjes minimale të burgimit për të mitur, LPM-ja thekson se burgimi për të mitur nuk mundet të jetë më pak se 6 muaj. Në përgjithësi, burgimi për të mitur nuk mundet të tejkalojë dënimin maksimal të paraparë për atë vepër penale dhe nuk duhet të tejkalojë kohëzgjatjen prej pesë vjet. Vetëm në rast të veprave penale të rënda kohëzgjatja e burgimit për të mitur mund të jetë deri në dhjetë vjet. E njëjta vlen edhe për rastet kur i mituri kryen dy vepra penale në të njëjtën kohë ku për secilën nga to ligji parasheh dënimin me më shumë se dhjetë vjet burg.<sup>243</sup>

## **C. Përfundimet**

Edhe pse legjislacioni paraprak ofronte një sërë masash alternative joizoluese, ai nuk vënte në pah në mënyrë të mjaftueshme se masat izoluese duhet të zbatohen si masë e fundit. Kjo gjë është korrigjuar nëpërmjet të LPM-së e cila në mënyrë të qartë thekson se shfrytëzimi i dënitimit me burg duhet të mbahet deri në minimum dhe se interesi më i mirë i të miturit duhet të shërbejë si udhërrëfyes gjatë caktimit të masës dhe në këtë mënyrë të respektohen standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Për më tepër spektri i gjerë i masave alternative i cili përfshihet në LPM i ofron gjykatave mundësinë që të shqiptojnë masa të individualizuara duke marrë parasysh gjendjen specifike në të cilën gjendet i mituri.

## **X. ZBATIMI I SANKSIONEVE DHE DËNIMEVE KUNDËR TË MITURVE**

Në vitin 2003 përafërsisht 365 të mitur ishin shpallur fajtor për vepra penale në Kosovë. Nga 367, rreth 307 kishin pranuar urdhëra për mbikëqyrje dhe 14 kishin marrë qortim. Kundër 41 të miturve ishte caktuar dënimi përfshirë këtu masat izoluese.<sup>244</sup> Shifrat e paraqitura në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2004 janë të ngjashme me këto të përmendura. Gjatë kësaj periudhe 116 të mitur ishin shpallur fajtor për vepra penale dhe nga ky numër kundër 11 prej tyre ishin shqiptuar masa izoluese.<sup>245</sup>

OSBE-ja ka qenë në gjendje të regjistrojë një sërë të metash përkitazi me praktikën e caktimit të dënimeve dhe shfrytëzimin e masave izoluese dhe atyre alternative, përfshirë këtu edhe:

- Mangësitë institucionale;

<sup>242</sup> Nëse pas kalimit të periudhës së caktuar i mituri nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme, gjykata urdhëron ekzekutimin e masës institucionale edukative ose burgimin për të mitur në kohëzgjatje proporcionale, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e punës në dobi të përgjithshme që është kryer (Neni 28 LPM).

<sup>243</sup> Neni 31 LPM.

<sup>244</sup> Statistikat janë kurtoazi e DAGJ-së.

<sup>245</sup> Ibid.

- Mungesa e diferencimit të ekzekutimit të masave edukativo-përmirësuese dhe burgimit për të mitur;
- Shfrytëzimi i panevojshëm i masave izoluese për të ndarë të miturin nga mjedisi i tij apo saj;
- Mungesa e konsiderimit të masave joizoluese;
- arsyetimi i pamjaftueshëm; dhe,
- dështimi për të përcaktuar kohëzgjatjen e masës edukuese.

## A. Mangësitë institucionale

Ekzekutimi i sanksioneve pengohet nga mungesa e institucioneve adekuate për të mitur që shpallen fajtor për kryerjen e veprave penale. Nga institucionet që parashihen me ligj, Kosovës i mungojnë qendrat disiplinore, institucionet edukative dhe institucionet e kujdesit të posaçëm. Krahas kësaj nuk ka kapacitet për të ofruar shtëpi ushqyese.<sup>246</sup> Sa i përket masave të diversitetit të sapo futura në ligj, nuk janë ndërmarrë kurrfarë hapa për të siguruar implementimin e tyre dhe është e paqartë se kush ka përgjegjësi administrative për të lehtësuar implementimin e tyre.

Mëtutje, masat edukuese-përmirësuese ekzekutohen në Qendrën Përmirësuese në Lipjan/Lipljan që është në kundërshtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. Ligji parashih që këto masa duhet të ekzekutohen në një institucion të ndarë të themeluar enkas për këtë qëllim,<sup>247</sup> dhe është shumë i qartë në qëllimin e vet për të ndarë dhe diferencuar masat edukuese nga dënimi me burg për të mitur. Në bazë të Qendrës Përmirësuese në Lipjan/Lipljan, të miturit meshkuj të cilët janë objekt i masave edukuese dhe të miturit e dënuar me burg duhet të mbahen ndaras nga njëri tjetri përpos faktit se të dyja palët duhet të gëzojnë qasje të njëjtë në edukim dhe të mbështeten me përkrahje dhe aktivitete të njëjta.<sup>248</sup> Realiteti, së këndejmi nuk pasqyron dallimin ndërmjet dy llojeve të sanksioneve që parashihen me ligj. Sa i përket të miturve femra dallimi është edhe më i vogël, për shkak se të miturit e dënuar me burg për të mitur dhe të miturit që i'u nënshtrohen masave edukuese dhe përmirësuese mbahen bashkë dhe pranojnë të njëjtin trajtim.<sup>249</sup> Për më tepër, ato mbahen bashkë madje edhe më të burgosurit e rritur femra.<sup>250</sup>

<sup>246</sup> Përgjegjësinë për të siguruar familjen tjetër e mban kryesisht organi i kujdestarisë mirëpo sipas ligjit të ri kjo përgjegjësi i është dhënë Shërbimit Sprovues (Nenet 90 dhe 91 LPM).

<sup>247</sup> Neni 109 LPM dhe Neni 303 Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale.

<sup>248</sup> Drejtori i Qendrës Përmirësuese në Lipjan/Lipljan deklaroi gjatë një intervistë të mbajtur me të më 14 shtator 2004 se janë duke u ndërmarrë hapa për të ofruar më shumë aktivitete për të miturit mbi masat edukuese dhe në këtë mënyrë të krijohet një dallim më i madh në trajtimin e dy formave të ndryshme të sanksioneve, megjithatë gjer më tani trajtimi ka mbetur po ai i njëjti. Për më tepër janë duke u bërë përpjekje për të përmirësuar arsimimin që i'u ofrohet të miturve si atyre që janë objekt i masave edukative gjithashtu edhe atyre të dënuar me burg. Gjer më tani ky arsimim nuk ka qenë në pajtim me planprogramin e përcaktuar dhe së këndejmi nuk ka lejuar që të miturit të diplomojnë. Në raste të këtilla të miturit të cilët janë objekt i masave edukuese-përmirësuese mund të lejohen që të ndjekin mësimet jashtë institucionit (lexo neni 115 LPM). Përkundër fushëveprimit të kufizuar të arsimimit të ofruar në Qendrën Përmirësuese në Lipjan/Lipljan të miturve gjer më tani nuk i'u është lejuar që të ndjekin mësimet jashtë Qendrës Përmirësuese.

<sup>249</sup> Më 6 tetor 2004, 42 të mitur ishin vendosur në Qendrën Përmirësuese në Lipjan/Lipljan. Nga ky numër, 39 ishin të mitur meshkuj, 11 prej tyre në paraburgim, 15 të dënuar me burg dhe 13 të dënuar me masë edukuese, përdërisa tre prej të miturve ishin femra, një prej tyre e dënuar me burg dhe dy të tjera në paraburgim.

<sup>250</sup> Si një rregull e përgjithshme, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nuk lejojnë që kryesit e mitur dhe ata të rritur të mbahen bashkë. Neni 10(2)(b) PNDPC thotë se kryesit e mitur duhet të ndahen nga të rriturit dhe të trajtohen në bazë të moshës dhe statusit ligjor të tyre. Sidoqoftë, KDF-ja përfshin një dispozitë e cila thotë se “çdo fëmijë i privuar nga liria do të ndahet nga të rriturit përpos

Një aspekt shtesë që ndikon në ekzekutimin dhe shfrytëzimin e dënimeve të ndryshme është kapaciteti institucional për të ndërmarrë aktivitete përcjellëse pas shqiptimit të këtyre masave. Në bazë të ligjit të ri përgjegjësia kryesore e ka Shërbimi Sprovues që është përgjegjës për marrjen e aktiviteteve përcjellëse sa i përket masave të diversitetit,<sup>251</sup> masave të mbikëqyrjes së shtuar nga prindi, kujdestari apo familja ushqyese,<sup>252</sup> punës në dobi të përgjithshme,<sup>253</sup> trajtimit të detyrueshëm<sup>254</sup>, masave edukuese institucionale dhe dënimit me burg për të mitur<sup>255</sup> dhe për mbajtjen e kontakteve me të miturit pas lirimit të tyre.<sup>256</sup> Nën rrethanat e tanishme Shërbimi Sprovues nuk ka kapacitet për të kryer këto detyra deri në masën e paraparë me ligj.

Duke marrë parasysh kufizimet e imponuara nga mungesa e institucioneve adekuate, brezi i sanksioneve së këndejmi është i kufizuar në:

- Mbikëqyrjen e shtuar nga prindi;
- Mbikëqyrjen e shtuar nga organi i kujdestarisë;
- punën në dobi të përgjithshme; apo
- burgimin për të mitur.

Ky brez i kufizuar i masave alternative u jep gjyqtarëve një mundësi tejet të kufizuar për të shqiptuar sanksionin më të duhur që do të jetë në interesin më të mirë të të miturit. Kjo është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilat theksojnë se “një sërë rregullimesh juridike siç është kujdesi, udhëzimi dhe urdhërat për mbikëqyrje; këshillimet, sprovimi, edukimi dhe kujdesi nga një familje ushqyese dhe programet e trajnimit profesional dhe alternativat tjera siç janë kujdesi institucional do të jenë në dispozicion për të siguruar që fëmijët trajtohen në mënyrë të duhur për mirëqenien e tyre dhe i cili trajtim është proporcional me rrethanat dhe veprën penale të kryer nga ta.”<sup>257</sup>

## **B. Mungesa e diferencimit të ekzekutimit të masave edukative-përmirësuese dhe burgimit për të mitur**

Përderisa masat edukative-përmirësuese ekzekutohen në të njëjtin institucion me gati të njëjtin trajtim si burgimi për të mitur, dallimi ndërmjet këtyre dyjave është mjegulluar. Burgimi për të mitur ka për qëllim të jetë një dënim më i rëndë i cili është i zbatueshëm vetëm nëse i akuzuari ka kryer një vepër penale të rëndë, dhe kur shqiptimi i masave edukative nuk është adekuat për shkak të peshës së veprës penale.<sup>258</sup> Fatkeqësisht, në praktikë, masat edukative-përmirësuese mund të rezultojnë që të jenë më të rënda se të dyja masat e sipërpërmendura, e cila gjë mund të ketë si rrjedhojë shqiptimin e dënimeve më të rënda për

---

nëse konsiderohet se është në interesin e fëmiut të veprohet kështu” [Neni 37(c) KDF]. Në këtë drejtim mund të mbështetet fakti se për shkak të numrit të kufizuar të tyre, është në interes të të miturve që të mos ndahen nga të rriturit krejtësisht. Megjithatë, gjatë vendosjes mbi nivelin e ndarjes së të miturve nga të rriturit interesi më i mirë i fëmiut duhet të merret parasysh në secilin rast dhe çështjet praktike si mungesa e hapësirës nuk duhet kurrsesi të luajë rol vendimtar gjatë marrjes së vendimit. Duhet gjithashtu të sigurohet që të miturve të gjinisë femërore t’ju ofrohet i njëjti spektër i mundësive për arsimim dhe edukim si të miturit e gjinisë mashkullore.

<sup>251</sup> Neni 79(3) LPM.

<sup>252</sup> Nenet 20(3), 21(3), 88, 89 dhe 123 LPM.

<sup>253</sup> Neni 28(2) dhe 129(2) LPM.

<sup>254</sup> Nenet 120-122 LPM.

<sup>255</sup> Neni 137 LPM.

<sup>256</sup> Neni 138 LPM.

<sup>257</sup> Neni 40(4) KDF. Lexo gjithashtu Rregullat e Pekingut paragrafi 18.1.

<sup>258</sup> Nenet 73, 77 KP i RFJ-së dhe neni 30 LPM.

kryesit e veprave të lehta penale. Përse masat edukative-përmirësuese mund të jenë më të rënda gjatë zbatimit të tyre në praktikë? Së pari, në bazë të ligjit të vjetër masat edukative nuk bartin një kohëzgjatje të përcaktuar (varet nga zhvillimi social dhe psikik i të miturit) përderisa kohëzgjatja e burgimit për të mitur është përcaktuar në momentin e caktimit të dënimit;<sup>259</sup> së këndejmi ka ekzistuar një paqartësi më e madhe sa i përket masave edukative.<sup>260</sup> Së dyti, për shkak se masat edukative-përmirësuese mund të shqiptohen me një kohëzgjatje minimale prej një viti, përderisa burgimi për të mitur mund të ketë kohëzgjatje të shkurtë, veçanërisht nëse konsiderohet lirimi me kusht.<sup>261</sup> Për këtë arsye, të miturve me qëllim i'u shqiptohet dënimi më i lehtë në formë të masave edukative-përmirësuese, dhe në mënyrë ironike ata mund të përfundojnë së qendruari në të njëjtin institucion më gjatë nën të njëjtat kushte si ata të mitur të cilëve i'u është shqiptuar dënimi më i rëndë me burgim për të mitur. Mangësitë institucionale për këtë arsye na kanë shpjer në një gjendje ku masat edukative-përmirësuese kanë mundësi që të humbin karakterin e tyre edukues dhe rehabilitues.

### **C. Shfrytëzimi i panevojshëm i masave izoluese për të ndarë të miturit nga mjedisi i tyre**

Për shkak të metave institucionale, masat edukuese-përmirësuese shqiptohen për të ndarë të miturin nga mjedisi i tij apo saj. Në këto raste – kur vendosja e të miturit në familjen tjetër apo dërgimi i tij apo saj në institucionin edukues do të përmbushte këtë qëllim – gjykatat prapëprapë e gjejnë vetën të detyruara që të shqiptojnë masat izoluese. Rastet e paraqitura në vazhdim janë disa shembuj të mirë që ilustrojnë këtë gjendje.

Në shembullin e parë, në një rast pranë gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, një e mitur femër ishte shpallur fajtor për vrasje të foshnjës dhe ishte dënuar më datën 12 mars 2003. Në arsyetimin e vet, gjykata vë theks të shquar në faktin se e mitura ende ishte duke jetuar në të njëjtën shtëpi me të atin e foshnjës, kunatin e saj dhe se familja e të miturës nuk kishte mjete financiare t'a dërgoj të miturën diku tjetër. Gjykata për këtë arsye ceku se duke marrë parasysh rrethanat në të cilat jeton e mitura, ajo konsideron se është e nevojshme që të ndahet e mitura nga mjedisi familjar me qëllim të resocializimit dhe edukimit të saj. Gjykata për këtë arsye shqiptoi masa edukuese-përmirësuese.

Shembulli i dytë është një rast pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë/Priština. Në këtë rast, i mituri i cili ishte 14 vjeçar në kohën e kryerjes së veprës penale ishte shpallur fajtor për kryerjen e tetë veprave penale të vjedhjes me dhunë, plaçkitjes dhe vjedhjes së rëndë. Gjykata shqiptoi masa edukuese-përmirësuese. Në aktgjykimin e datës 2 mars 2004, gjykata i referohet gjendjes së tij familjare dhe deklaroi se i mituri e kishte lënë shkollën, dhe kishte filluar të sorollatet nëpër rrugë; se familja e tij jetonte në kushte shumë të vështira ekonomike dhe se femiu kishte kryer disa vepra penale me natyrë të ngjashme. Ai ishte në kontakt me Qendrën për Punë Sociale por pa sukses. Gjykata shqiptoi masën edukuese që do të ndante të miturin nga rrethi i tij. Duke konsideruar personalitetin e të miturit, gjendjen e tij familjare dhe faktin se prindërit e tij nuk kanë mundësi të shtojnë mbikëqyrjen ndaj tij gjykata vendosi të shqiptojë masë edukuese-përmirësuese. Mungesa e masave alternative që do të

<sup>259</sup> Punëtorët social përgatisin një raport mbi të miturin i cili i dërgohet gjykatës çdo gjashtë muaj apo me kërkesë të vetë gjykatës. Edhe pse masat edukuese mund të zgjasin prej një në pesë vjet, në shumicën e rasteve të miturit lirohen pas dy apo tre vjetëve. Në raste shumë të rralla masat zgjasin më shumë se katër vjet.

<sup>260</sup> Në bazë të ligjit të ri gjykatat duhet të përcaktojnë kohëzgjatjen e masës së shqiptuar [lexo nenin 6(4) LPM]. Megjithatë, praktika tregon se gjer më tani gjykatat kanë dështuar t'a bëjnë këtë (lexo mëposhtë pjesën F me titull "dështimi për të përcaktuar kohëzgjatjen e masave të shqiptuara edukuese).

<sup>261</sup> Kjo është e vlefshme si në bazë të ligjit të vjetër ashtu edhe të atij të ri [lexo nenet 25(3) dhe 31 LPM dhe nenin 19 dhe 25 KPK-së].

mundësonte vendosjen e të miturit në një shtëpi tjetër e ka shtyer gjykatën të merr vendim për të shqiptuar masë izoluese.

Në të dyja këto raste, gjykata theksoi nevojën e largimit të të miturit nga mjedisi i tij apo saj familjar. Megjithatë, largimi nga mjedisi familjar nuk kërkon që i mituri të mbahet në burg; një familje tjetër ushqyese apo një institucion i hapur mund të përmbush qëllimin e dënimit pa ndikuar negativisht siç ndikon burgimi në zhvillimin shoqëror, mental dhe edukativ të të miturit.<sup>262</sup>

#### **D. Mungesa e konsiderimit të masave joizoluese**

Standardet ndërkombëtare e bëjnë shumë të qartë se masat izoluese duhet të shfrytëzohen vetëm si masë e fundit nëse nuk ekzistojnë masa tjera të zbatueshme adekuate.<sup>263</sup> Kjo kërkon që gjykata të konsiderojë zbatimin e masave alternative në çdo rast para se të vendos mbi shqiptimin e masave izoluese. Megjithatë, në praktikë, OSBE-ja ka vërejtur se ky parim nuk respektohet gjithnjë, veçanërisht sa i përket të miturve kundër të cilëve është shqiptuar masa edukuese. Në këto raste gjykatat kanë tendencë të zbatojnë masat izoluese pa një vlerësim të hollësishëm të pasojave apo të përcaktimit nëse masat alternative mund të përmbushin qëllimin e dënimit. Gjykata rëndom duket të zbatojë politikën, se keqberësit që përsërisin veprat penale duhet medoemos të dënohen me masa izoluese. Rastet e paraqitura në vazhdim janë disa shembuj të mirë të një arsytimi të tillë.

Një shembull i tillë mund të shihet në vendimin për dënim të datës 4 prill 2003 në gjykatën komunale në Pejë/Peć, me të cilin gjykata shqiptoi masë edukuese-përmirësuese. Në këtë rast i mituri kishte kryer vepër penale të lëndimit të lehtë trupor, tentim vjedhjes së rëndë dhe vjedhjes së rëndë. Gjykata theksoi se e ka bazuar vendimin e vet në këto baza; rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, faktin se i mituri ishte recidivist dhe se masa edukuese e mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë nuk është treguar si e suksesshme mëparë. Nuk është bërë asnjë vlerësim tjetër se a do të mund të zbatoheshin masa të tjera shtesë joizoluese.

Shembulli i dytë ka të bëjë me një rast pranë gjykatës komunale në Mitrovicë/Mitrovica. Gjykata vendosi më 21 gusht 2003 të shqiptojë masën edukuese-përmirësuese kundër të miturit që kishte kryer vepër penale të vjedhjes së rëndë.<sup>264</sup> I mituri, i cili ishte 14 vjeçar në kohën e kryerjes së veprës penale edhe mëparë kishte vuajtur masën edukuese të mbikëqyrjes së shtuar. Gjatë marrjes së vendimit mbi caktimin e dënimit, gjykata konsideroi rrethanat e krimit dhe gjendjen e familjes së të miturit dhe erdhi në përfundim se masa izoluese ishte adekuate. Megjithatë, gjykata dështoi të konsideroi zbatueshmërinë e masave joizoluese në këtë rast dhe kufizoi arsytimin e vet duke deklaruar se kishte marrë parasysh faktin se masat e shqiptuara në të kaluarën nuk ishin treguar si të suksesshme.

Në rastet e sipërpërmendura gjykata kishte dështuar që të konsideroi nëse masat joizoluese do të përmbushnin qëllimin e dënimit (për shembull mbikëqyrja e shtuar nga organi i

<sup>262</sup> Duhet gjithashtu të ceket se në të dyja rastet gjykata i referohet gjendjes ekonomike të familjes gjatë marrjes së vendimit për caktimin e dënimit. Gjendja ekonomike e familjes së të miturit nuk duhet të përbëjë një justifikim për caktimin e masave izoluese të cilat e kufizojnë lirinë e të miturit.

<sup>263</sup> Lexo nenin 37(b) KDF dhe Rregullat e Pekingut paragrafi 17.1.

<sup>264</sup> Fakti se avokati mbrojtës dhe Qendra për Punë Sociale ishin pajtuar me masat e shqiptuara nuk ndikon në obligimin e gjykatës që të marrë në konsideratë edhe mundësinë e shqiptimit të masave joizoluese.



kujdestarisë e kombinuar me punë në dobi të përgjithshme).<sup>265</sup> Për këtë arsye është e diskutueshme nëse masat edukuese-përmirësuese janë masat e vetme adekuate të zbatueshme.

## E. Arsyetimi i pamjaftueshëm

Gjykatat duhet të ofrojnë arsye të plota dhe të duhura gjatë marrjes së vendimit mbi caktimin e dënimit.<sup>266</sup> Për shkak se shfrytëzimi i masave izoluese duhet të jetë më i kufizuar kur kemi të bëjmë me rastet me të mitur, është me rëndësi që gjykatat të shpjegojnë rrethanat faktike dhe të përcaktojnë nëse masa izoluese është e vetmja masë që mund të zbatohet. Edhe pse duhet të ceket se arsyetimi i gjykatave në rastet me të mitur është më i detajuar se në rastet me të rritur, OSBE-ja gjithashtu ka vërejtur disa mangësi serioze edhe në rastet me të mitur.

Për të kufizuar shfrytëzimin e papërshtatshëm të burgimit, si ligji i tanishëm gjithashtu edhe ai i vjetri theksojnë se burgimi për të mitur është i zbatueshëm vetëm në rastet nëse vepra penale është e dënueshme me më shumë se pesë vjet burg dhe se shqiptimi i masës edukuese nuk do të ishte një zgjidhje e duhur për shkak të peshës së veprës penale, pasojave që rezultojnë dhe shkallës së fajësisë së të akuzuarit.<sup>267</sup> Arsyetimi i gjykatave në rastet e caktimit të burgimit për të mitur duhet të nënvizojë në mënyrë të qartë faktet dhe rrethanat në të cilat ky arsyetim është i bazuar. Megjithatë, në shumë raste, gjykatat kanë shqiptuar burgimin për të mitur pa dhënë kurrfarë arsyetimi se përse masat tjera edukuese nuk janë konsideruar si një alternativë e duhur. Shembujt në vazhdim ilustrjnë këtë problem:

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Pejë/Peć ku përfshiheshin pesë të akuzuar të rritur dhe një i mitur, gjykata dënoi të miturin me 9 muaj burgim për posedim të paligjshëm të armëve. Në aktgjykimin e vet të datës 29 tetor 2003, gjykata nuk jepte kurrfarë arsyetimi se përse kishte zgjedhur të shqiptoi dënimin me burgim për të mitur.

Rasti i dytë është një rast pranë gjykatës së qarkut në Prizren. Ky rast përfshinte katër të akuzuar dhe një të mitur.<sup>268</sup> Në vendimin e vet për caktimin e dënimit, të datës 18 dhjetor 2003, gjykata kishte urdhëruar që i mituri të vuajë dënimin me burgim për të mitur prej 1 vjet e 6 muaj për shkak të kryerjes së veprës penale të shkakimit të lëndimit të rëndë trupor. Në arsyetimin e vet gjykata nuk jep kurrfarë shpjegime për mundësinë e shqiptimit të masës edukuese përkundër faktit se një masë e tillë ishte propozuar nga Qendra për Punë Sociale.

---

<sup>265</sup> Në bashkëpunim me gjyqtarët për të mitur OJQ-ja “*Terres des hommes*” ka punuar mjaft me të miturit të cilëve u është shqiptuar masa e punës në dobi të përgjithshme që nga viti 2002. Gjykatat kanë shfrytëzuar mundësinë për të kombinuar masën edukuese të mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë me detyrimet gjegjëse dhe kanë shqiptuar kundër të miturve masën e punës në dobi të përgjithshme me kohëzgjatje prej 40 deri në 120 orë. Organizimi dhe administrimi i ekzekutimit të masës së punës në dobi të përgjithshme është bërë nga *Terres des hommes*, e cila organizatë gjithashtu kishte zhvilluar aktivitete tjera përcjellëse të dërgimit të raporteve gjykatës dhe Qendrës për Punë Sociale mbi të miturin.

<sup>266</sup> Neni 74 LPM thekson në mënyrë të qartë se pjesa katër e KPPP është e zbatueshme edhe në rastet e të miturve.

<sup>267</sup> Neni 30 LPM. Sa i përket legjisllacionit paraprak lexo nenin 77 të KP të RFJ-së.

<sup>268</sup> Tre të akuzuarit ishin shpallur fajtor për pjesëmarrje në një grindje përderisa i katërti ishte shpallur fajtor për posedim të paligjshëm të armëve.

## F. Dështimi për të përcaktuar kohëzgjatjen e masave të shqiptuara edukuese

Shqyrtimi periodik i dënimit dhe mundësia që gjykata të përfundojë ekzekutimin e një mase para se ajo të kompletohet parashihet me kodin e ri.<sup>269</sup> Megjithatë, sipas kodit të ri gjykata duhet të përcaktojë shprehimisht kohëzgjatjen maksimale të masës gjatë caktimit të dënimit.<sup>270</sup> Kjo lejon që gjykata të sigurojë që masa të jetë proporcionale me veprën penale të kryer.<sup>271</sup> Paraprakisht, gjykata do të kishte mundur të vendos mbi llojin e masës së shqiptuar gjatë caktimit të dënimit.

Megjithatë, gjer më tani, në dënimet e shqiptuara që nga hyrja në fuqi e LPM-së gjykatat në shumë raste kanë dështuar që të përcaktojnë kohëzgjatjen e masave në baza individuale. Në vend të kësaj, gjykatat kanë vazhduar me praktikën e tyre të vjetër të referimit në kufijtë e masës të paraparë me ligj.<sup>272</sup> Rastet e paraqitura në vazhdim janë disa shembuj të mirë të kësaj çka u tha.<sup>273</sup>

Në një aktgjykim të gjykatës së qarkut në Prizren, të datës 1 korrik 2004, gjykata shpalli fajtor një të mitur për posedim të paligjshëm të armëve. Gjykata shqiptoi masën edukuese të mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë me 120 orë të punës në dobi të përgjithshme që duhet të kryhen me nga jo më shumë se dy orë në ditë brenda periudhës tremujore. Gjykata dështoi që të përcaktojë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes së shtuar duke deklaruar se duhet të zgjas ndërmjet një dhe tre vjet. Ky brez kohor i referohet ligjit të vjetër dhe nuk është në pajtim me kufijtë e parashikuar me ligjin e ri të cilët sillen ndërmjet tre muaj dhe dy vjet.<sup>274</sup>

Në një aktgjykim të datës 29 shtator 2004, gjykata komunale në Mitrovicë/Mitrovica dënoi të miturin me mbikëqyrje të shtuar nga organi i kujdestarisë për shkak të kryerjes së veprës penale të vjedhjes së rëndë. Në vendimin e vet, gjykata deklaroi se masa nuk duhet të jetë më e shkurtë se tre muaj dhe jo më e gjatë se dy vjet dhe se gjykata duhet të përcaktojë në mënyrë të saktë kohëzgjatjen e masës. Gjykata së këndejmi i'u referua kufijve kohor të paraparë me ligj për këtë masë dhe dështoi të vendos mbi caktimin e kohëzgjatjes së masës.<sup>275</sup>

---

<sup>269</sup> Çdo gjashtë muaj, apo me kërkesë të të miturit, përfaqësuesit të tij apo saj apo institucionit, gjykata që ka shqiptuar masën edukuese duhet të shqyrtojë ekzekutimin e kësaj mase dhe të vendos se a të vazhdojë apo të përfundojë ekzekutimin e kësaj mase, apo t'a zëvendësojë atë me një masë më të butë (lexo nenin 124 LPM).

<sup>270</sup> Neni 6(4) LPM.

<sup>271</sup> Lexo Rregullat e Pekingut paragrafi 5.1.

<sup>272</sup> LPM-ja hyri në fuqi më 20 prill 2004. Kodi i ri nuk përfshin dispozitat e përkohshme të cilat rregullojnë implementimin e këtij ligji në rastet e inicuar para hyrjes në fuqi të tij. Kur kemi të bëjmë me të drejtën penale substanciale, përfshirë këtu edhe dispozitat mbi dënimet, parimet e përgjithshme penale deklarohen se duhet të zbatohet ligji cili është më i favorshëm për të akuzuarin. Ky parim është përfshirë në nenin 2 të LPM-së. Në pajtim me këtë parim dispozitat mbi masat dhe dënimet e zbatueshme në LPM duhet të zbatohen në të gjitha rastet të cilat kanë përfunduar pas 20 prillit 2004.

<sup>273</sup> Sipas Qendrës Përmirësuese në Lipjan/Lipljan asnjë i mitur nuk ka vuajtur masën edukuese-përmirësuese gjatë periudhës 20 prill – 6 tetor 2004. OSBE-ja nuk ka qenë në gjendje të monitorojë se a janë duke e trajtuar çështjen e dënimeve izoluese në të njëjtën mënyrë.

<sup>274</sup> Lexo nenin 16(1) KPK dhe neni 17(3) LPM.

<sup>275</sup> Neni 17(3) deklaroi se masat e mbikëqyrjes së shtuar nuk duhet të zgjasin më pak se tre muaj dhe më shumë se dy vjet.

## **G. Përfundimet**

Edhe pse LPM ngërthen disa ndryshime të rëndësishme dhe përmirësime në kornizën legislative, shqetësimet kryesore sa i përket caktimit të dënimit për kryesit e mitur mbeten të njëjta. Mungesa e institucioneve të nevojshme kufizon në mënyrë të rreptë numrin e masave alternative që janë në dispozicion të gjykatave, pavarësisht nga shumëllojshmëria e masave në teori. Si rrjedhojë e kësaj, kryesit e mitur nuk pranojnë mbështetje dhe trajtim të individualizuar në të cilën gjë kanë të drejtë.

Gjendja është keqësuar edhe më tutje nga hezitimi i gjykatave për të shfrytëzuar masat alternative në dispozicion. Si rrjedhojë të këtij hezitimi kemi shfrytëzimin e tepruar të masave të paraburgimit që janë në shkelje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe interesin më të mirë të fëmiut.

## **XI. REKOMANDIMET**

### **Dënimi i të rriturve**

- Gjykatat ankimore dhe posaqërisht Gjykata Supreme duhet në mënyrë të qëndrueshme të japin vendime me të cilat i udhëzojnë gjykatat e ulta se të gjitha aktgjykimet dhe vendimet përkitazi me dënimin duhet të përfshijnë një arsyetim të detajuar dhe individualizuar. Në veçanti gjykata duhet:
  - Të vendos mbi dënimin e individualizuar në kuadër të kufijve të përcaktuar me ligj;
  - Të jap arsyetim të plotë të detajuar gjatë vendosjes për një dënim më të butë, përfshirë këtu edhe ekzistimin e një rrethane të tillë të veçantë e cila bën me dije se qëllimi i dënimit mund të arrihet nëpërmjet të një dënimi më të ulët;
  - Të zbatojë në mënyrë adekuate rrethanat lehtësuese dhe rënduese në pajtim me ligjin; dhe,
  - Të konsiderojë zbatimin e masave alternative ndaj dënimit me burg në të gjitha rastet.
- Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet të ofrojë trajnim mbi shqiptimin e dënimeve, duke spikatur nevojën për një arsyetim të detajuar dhe individualizuar sikurse edhe një shfrytëzim më të drejtë të rrethanave lehtësuese dhe rënduese.
- Departamenti i Administratës Gjyqësore duhet të sigurojë që të gjitha aktgjykimet e gjykatës supreme të publikohen dhe të vihen në dispozicion të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha instancave.
- Departamenti i Drejtësisë duhet të sigurojë vendosjen dhe ruajtjen e kapacitetit të nevojshëm institucional për implementimin e masave dhe sanksioneve të parashikuara me ligj. Kjo përfshin:
  - Themelimin e institutit për trajtim të detyrueshëm rehabilitues për të varurit nga droga dhe alkoholi; dhe,
  - Përgatitjet për ekzekutimin e dënimit me burg në formë të gjysëm lirisë.
- Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet t'i ofrojë të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve trajnim mbi masat e reja alternative për të siguruar që ata të fitojnë njohuri dhe vetëbesim në shfrytëzimin e këtyre masave.
- Zyret rajonale të Shërbimit Sprovues duhet të inkurajohen në vendosjen e kontakteve me gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave komunale dhe atyre të qarkut për të promovuar një kuptim më të madh në mesin e gjyqësisë për shërbimet që ofrohen nga Shërbimi Sprovues

dhe shfrytëzimin e masave alternative. (Ky rekomandim vlen gjithashtu edhe për dënimin e të miturve.)

### **Dënimi i të miturve**

- Departamenti i Drejtësisë duhet të sigurojë vendosjen e një kapaciteti të nevojshëm institucional që do të jetë në pajtim me LPM-në. Kjo përfshin edhe krijimin e institucioneve si në vijim:
  - Qendrës disiplinore;
  - Një institucioni edukues;
  - Një enti të kujdesit të posaçëm; dhe,
  - Një institucioni edukues-korrektues të llojit gjysmë të mbyllur.
- Departamenti i Drejtësisë duhet të shfrytëzojë përpjekjet e veta më të mira për të ndarë të burgosurit e mitur dhe ata të rritur, dhe për të ndarë të paraburgosurit e mitur nga të miturit dhe të rriturit që vuajnë dënimin.
- Departamenti i Drejtësisë duhet të sigurojë që masat edukuese-përmirësuese janë në pajtim me kushtet e përcaktuara me ligj; p.sh masat edukuese paraqesin një alternativë reale ndaj dënimit me burg, duke i'u ofruar të miturve mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje, përderisa në anën tjetër krijojnë kushte për zhvillimin edukativ, shoqëror dhe mental të tyre.
- Gjykatësit për të mitur dhe prokurorët relevant apo autoritetet kompetente duhet të zhvillojnë një sistem për implementimin e masave të diversionit.
- Shërbimi Sprovues duhet të ndër marrë hapa të menjëhershëm për të identifikuar familjet ushqyese për zbatimin e masave edukuese të mbikëqyrjes së shtuar dhe vendosjes së tyre në familjet ushqyese.
- Departamenti i Drejtësisë duhet të sigurojë që Shërbimi Sprovues ka kapacitet për të marrë masa përcjellëse në vazhden e zbatimit të masave të diversitetit, ekzekutimit të masave të ndryshme edukuese dhe lirim të të miturve të dënuar me burg për të mitur, anëmbanë Kosovës.
- Për të përmirësuar zbatimin e këtyre masave të parashikuara me ligj dhe lehtësuar koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet akterëve të ndryshëm të përfshirë në dënimin e të miturit, duhet të themelohet një grup punues i nivelit qendror të përbërë nga përfaqësuesit e Divizionit të Menaxhimit Penal (përfshirë këtu edhe një përfaqësues të Shërbimit Sprovues), Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë.
- Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet të vazhdojë të ofrojë trajnim për gjyqtarët për të mitur mbi kodin e drejtësisë për të mitur, standardeve ndërkombëtare mbi drejtësinë për të mitur dhe shfrytëzimin e masave alternative.
- Agjencite përgjegjëse trajnuese siq është Instituti Gjyqësor i Kosovës, Qendra Burimore për Mbrojtjen Penale dhe Qendra Juridike e Kosovës duhet të organizojë tryeza të rrumbullakëta për diskutimin dhe komentimin e zbatimit të Ligjit Penal për të Mitur. Gjyqtarët për të mitur, prokurorët, avokatët mbrojtës, përfaqësuesit e Shërbimit Sprovues, ekspertët ndërkombëtar dhe të tjerët duhet të ftohen të marrin pjesë nëpër tryeza të rrumbullakëta, të cilat tryeza si rrjedhojë do të kenë botimin e një sërë përfundimeve të cilat duhet t'u jipen në dispozicion të gjitha palëve të përfshira në drejtësinë për të mitur.

## KREU 6

### RASTET QË NDËRLIDHEN ME NGJARJET E MARSIT 2004

#### I. HYRJE

Një nga ngjarjet që vlejnë të përmenden gjatë periudhës raportuese të këtij shqyrtimi ishin ngjarjet që kishin ndodhur ndërmjet 17 dhe 19 marsit 2004. Dhuna ilustroi paqëndrueshmërinë e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë dhe procedurat penale që ishin inicuar pas dhunës së marsit shërbyen si një test i vullnetit dhe efektivitetit të sistemit gjyqësor për t'u përgjegjur në dhunën e shpërndarë etnike. OSBE-ja kishte monitoruar ngushtë ndjekjet penale të inicuar lidhur me dhunën e marsit dhe në veçanti përgjigjen e gjyqësisë vendëse – dedikimin dhe aftësinë e saj për t'u marrë me këto raste.<sup>276</sup> Kreu pasues ofron një pasqyrë të procedurave penale të cilat ishin monitoruar gjer në fund të periudhës raportuese. OSBE-ja do të publikojë një raport më të mëvonshëm mbi adresimin e rasteve që ndërlidhen me trazirat nga ana e gjykatave.

#### II. LLOJET E RASTEVE

Rastet penale të cilat kanë buruar si rezultat i dhunës së marsit sillen nga veprat penale të vjedhjes së lehtë e deri te veprat penale të rënda siç janë shkatërrimi i gjerë i pronës, sulmet mbi KFOR-in dhe policinë dhe vrasjet. Gjatë dhe pas trazirave ishin bërë rreth 500 arrestime përderisa rreth 350 raste kundër personave gjegjës ishin inicuar në kuadër të sistemit gjyqësor. Siç vërehet këto procedura nuk janë të shpërndara në mënyrë të barabartë në tërë rajonet edhe pse të gjitha rajonet kishin qenë të prekura nga trazirat. Rajoni i Prizrenit, i cili kishte përjetuar shkatërrime më mëdha pronësore, ka raste kundër 120 personave, por shumicën prej tyre në gjykatën për kundërvajtje. Rajoni i Gjilanit/Gnjilane ka raste kundër 113 personave; Prishtina/Priština vie pas me 96; Mitrovicë/Mitrovica ka vetëm 9 raste përkundër faktit se kjo ishte një zonë ku ishin zhvilluar grindje të rrepta dhe Peja/Peç me raste kundër 10 personave.<sup>277</sup>

#### III. PËRGJIGJA E POLICISË

Policia e UNMIK-ut ka themeluar disa ekupe hetuese si në kuadër të selisë së vet gjithashtu edhe në nivel rajonal që i dedikohen hetimit të veprave penale të cilat ishin kryer në periudhën ndërmjet 17 dhe 19 marsit. Në tetor 2004 Departamenti i Drejtësisë raportoi se një njësi speciale policore me emrin e kodifikuar “Operacioni Thor” është dedikuar që të regjistrojë të gjitha veprat penale të kryera gjatë dhunës së marsit në një bazë të shënimeve me qëllim të zgjidhjes së rasteve për nga pesha e tyre dhe të ndihmojë në përpilimin e listës së prioritetëve hetimore. Hetuesit nga Operacioni Thor janë duke punuar në secilin rajon dhe shtabi qëndror i policisë veçanërisht në rastet që kanë buruar nga trazirat e marsit. OSBE-ja mirëpret këtë përpjekje.

Megjithatë, përkundër kësaj nisme, numri i personave të arrestuar është relativisht i vogël në krahasim me nivelin e ngjarjeve. Policia e UNMIK-ut numëroi 33 trazira të mëdha gjatë

<sup>276</sup> OSBE-ja kishte raportuar fillimisht mbi efektet e trazirave dhe rasteve që kanë buruar nga këto ngjarje të përshkuara në raportin e vet me titull “Sfidat e të drejtave të njeriut pas trazirave të marsit”, të publikuar nga Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e së Drejtës më 25 maj 2004.

<sup>277</sup> Këto numra në këtë kapitull përfshijnë rastet deri me 9 dhjetor 2004.

periudhës 17 – 18 mars, ku sipas vlerësimeve ishin të përfshirë 51.000 pjesëmarrës.<sup>278</sup> Operacioni Thor për momentin është duke zhvilluar hetime për rreth 1.380 incidente penale.<sup>279</sup> Gjer më tani janë bërë rreth 500 arrestime për rastet në lidhje me trazirat apo rastet të cilat Operacioni Thor i'a kishte dorëzuar prokurorëve.<sup>280</sup> Numri i personave që për momentin janë nën hetime nuk i janë bërë me dije OSBE-së, mirëpo OSBE-ja ka dijeni se hetimet në lidhje me këto raste ende janë në zhvillim e sipër.

Për më tepër shumica e krimeve të rënda mbesin të pazgjidhura; vetëm katër persona janë akuzuar për udhëheqje të trazirave dhe nga 19 raste të hetimeve për vrasje, vetëm dy nga to janë duke u procesuar (një nga këto raste përfshinte pesë të akuzuar).<sup>281</sup> Shumica e personave të arrestuar ishin vetëm pjesëmarrës dhe plaçkitës.

#### **IV. PËRGJIGJA E GJYQËSISË**

Gjer më tani, 348 persona janë pruar para gjykatës për vepra penale të ndërlidhura me trazirat. Nga ky numër, 98 prej tyre janë nën hetime, 79 persona janë akuzuar dhe presin gjykimin, përderisa rastet kundër 171 personave kanë përfunduar. OSBE-ja ka monitoruar një sërë rastesh të zgjedhura për kundërvajtje dhe vepra penale në kuadër të gjykatave komunale dhe shumica e 44 rasteve nga gjykata e qarkut. Në këtë mënyrë, OSBE-ja ka vëzhguar një numër të shqetësimeve që ndërlidhen me fazën e hetimeve. Megjithatë, OSBE-ja gjer më tani ka vëzhguar se gjatë fazës së gjykimit nuk janë vërejtur shqetësime të mëdha procedurale në kuadër të gjyqësisë e cila është marrë me këto raste.

##### **A. Faza e hetimeve**

Kjo paqëndrueshmëri në numër ndërmjet numrit të pjesëmarrësve dhe numrit të personave të arrestuar mund të jetë pjesërisht për shkak të hezitimit të dëshmitarëve për të ardhur në gjyq dhe për të dëshmuar apo për shkak të faktit se ata nuk kishin dhënë dëshmi të plotë dhe të drejtpërdrejt gjatë paraqitjes në gjykatë; qoftë për shkak të simpatisë ndaj të dyshuarve apo frikës nga kërcënimi.<sup>282</sup>

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Pejë/Peç kundër dy të akuzuarve të akuzuar për pjesëmarrje në grup për kryerje të dhunës dhe nxitjes së urrejtjes, mosmarrëveshjeve dhe jotolerancës nacionale, racore, religjioze apo etnike dhe posedim të paligjshëm të armëve. Gjatë hetimeve, OSBE-ja ka vërejtur se madje edhe oficerët e SHPK-së kishin dhënë dëshmi të dykuptimta dhe kontradiktore duke lënë përshtypje se nuk kanë vullnet për të bashkëpunuar me organin e ndjekjes penale.

Një problem është vështirësia për të gjetur palët e dëmtuara apo dëshmitarët. Gjatë dhe menjëherë pas dhunës shumë serbë të Kosovës kishin lëshuar shtëpitë e tyre për në enklava më të mëdha apo Serbi, e cila gjë shkaktonte edhe më shumë vështirësi për gjyqësinë që të gjejë dhe t'i thërras ata në gjyq për të dëshmuar.

<sup>278</sup> Raporti VIP i lajmeve ditore, 23 mars 2004, “zëdhënësi i policisë së UNMIK-ut [...] tha se policia supozon që rreth 51,000 njerëz ishin të përfshirë në 33 trazira”. Gjithashtu lexo “Kollapsi në Kosovë – Raporti i ICG-së për Evropë Nr. 155,” 22 prill 2004, faqe 15.

<sup>279</sup> Intervista me shefin e Operacionit Thor, 3 nëntor 2004.

<sup>280</sup> Ibid.

<sup>281</sup> Ibid.

<sup>282</sup> Sipas shefit të Operacionit Thor, njëra nga vështirësitë kryesore në zhvillimin e hetimeve për trazirat e marsit ishte frika e dëshmitarëve nga kërcënimi dhe hakmarrja nëse japin dëshmi kundër kryesve të veprave penale. Në shumë raste, dëshmitarët kanë identifikuar kryesin e veprës penale në mënyrë gojore, mirëpo hezitoni të bëjnë deklarata me shkrim, duke dhënë dëshmi të përsëritura. Ky problem është ngritur sa i përket dëshmitarëve si nga komuniteti serb gjithashtu edhe ai shqiptar. Shih diskutimet e mëtuajtshme në lidhje me këtë shqetësim në Kreun 8.

Në një rast pranë gjykatës komunale në Prishtinë/Priština kundër katër të pandehurve të akuzuar për vjedhje të rëndë, gjykata nuk ka qenë në gjendje të gjejë palën e dëmtuar, një serb të Kosovës,<sup>283</sup> dhe edhe sot e kësaj dite hetimet janë në zhvillim e sipër që nga 23 marsi 2004.

Për më tepër duket se në një numër të rasteve gjykatat apo prokurorët hezitonin që të vazhdonin në mënyrë të zellshme hetimet, për arsye të panjohura. Shembujt e paraqitur mëposhtë ilustronë një vëzhgim më të gjerë të gjithë kësaj:

Dy raste të ngjashme pranë gjykatës komunale në Gjilan/Gnjilane vlejné të përmenden: Në rastin e parë, më 22 mars 2004 prokurori paraqiti kërkesë për zhvillimin e hetimeve kundër të pandehurve për tentim vjedhje të rëndë në bashkëpjesëmarrje; në rastin e dytë, prokurori paraqiti një kërkesë të tillë më 25 mars 2004 për vepër penale të sulmit kundër personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave të tij.

Për të dyja rastet ishte caktuar mbajtja e seancave dëgjuese më 13 dhe 27 shtator. Megjithatë në të dyja rastet seancat dëgjimore ishin shtyer për shkak se sipas gjyqtarit, dëshmitarët, oficerët e SHPK-së nuk ishin paraqitur në gjykatë.<sup>284</sup> Asnjë veprim tjetër nuk ishte ndërmarrë në asnjërin nga rastet gjatë periudhës raportuese.

Dy rastet tjera pranë gjykatës komunale në Gjilan/Gnjilane janë gjithashtu me interes të posaçëm: Në njërin nga këto raste prokurori kërkoi më 22 mars 2004 që të hetohen të dyshuarit për vepër penale të vjedhjes së rëndë në bashkëpjesëmarrje; në rastin tjetër, prokurori kërkoi më 23 mars 2004 që të hetohen të dyshuarit për tentim të vjedhjes së rëndë në bashkëpjesëmarrje. Në të dyja këto raste nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim tjetër hetimor gjatë periudhës raportuese.

## **B. Faza e gjykimit**

Gjer më tani, nga relativisht disa raste të cilat kishin arritur në fazën e gjykimit, gjykatat kishin mbajtur gjykimet në mënyrë të drejtë dhe korrekte. Megjithatë, OSBE-ja kishte vërejtur se në disa raste gjykatat kishin dënuar të akuzuarin me dënim nën minimumin e parashikuar me ligj, pa dhënë kurrfarë arsytimi.<sup>285</sup>

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Gjilan/Gnjilane më 2 qershor 2004, dy të akuzuarit ishin akuzuar me vepër penale të shkakimit të dëmit të përgjithshëm në një vend të tubimit të madh (duke djegur një veturë me regjistrim serb), duke pranuar një dënim me burg prej pesë muaj i cili dënim bie nën minimumin e parashikuar me

---

<sup>283</sup> Sipas gjyqtarit hetues të këtij rasti, ai i dërgoi kërkesë policisë më 28 prill 2004 për të gjetur palën e dëmtuar.

<sup>284</sup> OSBE-ja ka vërejtur se në shkresat e lëndës nuk ekzistonin kurrfarë thirrje për gjyq; gjyqtari hetues shpjegoi se për shkak se këta dëshmitarë ishin "persona zyrtar", ata thirreshin në gjyq ndryshe: Nëse këta persona nuk gjenden apo nuk nënshkruajnë fletëthirrjet për gjyq, atëherë këto fletëthirrje kthehen në gjykatë. Gjyqtari hetues shtoi se kur policët dështojnë të paraqiten në gjykatë, gjyqtari mund të dërgojë një informatë eprorit të vet; në rastet në fjalë gjyqtari hetues pohoi se kishte kontaktuar eprorët e vet gojariht. Vlen të përmendet se sipas informatave të pranuar nga Kryetari i Gjykatës Komunale në Gjilan/Gnjilane i vetmi dallim në thirrjen në gjyq të oficerëve të policisë, krahasuar me procedurën e rregullt për thirrjen e dëshmitarëve, është se thirrjet në gjyq për oficerë të policisë dorëzohen në vendin e tyre të punës në vend të vendbanimit, pavarësisht nga pranimi i tyre thirrjet duhet të nënshkruhen dhe kthehen në gjykatë.

<sup>285</sup> Lexo diskutimet e mëtutjeshme mbi këtë temë në KREUn 5 të shqyrtimit të tanishëm.

ligj.<sup>286</sup> Gjykata nuk shpjegoi në mënyrë adekuate arsyet për këtë devijim nga minimumi.

Në një rast pranë të njëjtës gjykatë, më 8 qershor 2004, dy të akuzuarit ishin shpallur fajtor për vepër penale të vjedhjes së rëndë dhe ishin dënuar me burg prej katër muaj, i cili dënim bie nën minimumin e parashikuar me ligj.<sup>287</sup> Gjykata nuk dha arsyetim adekuat për këtë.

Në përfundim, numri relativisht i vogël i rasteve penale që kanë hyrë në sistemin e drejtësisë mund të burojë pjesërisht për shkak të hezitimit të dëshmitarëve, madje edhe të oficerëve të policisë, për t'u paraqitur para gjykatës kur të thirren në gjykatë, si dhe hezitimi për të dëshmuar në mënyrë të saktë kur të paraqiten në gjykatë. Më tutje, kjo mund t'i ngarkohet vështirësive me të cilat organet hetimore përballen në gjetjen e dëshmitarëve, palëve të dëmtuara apo dyshuarve për paraqitjen e tyre në procedurat gjyqësore. Krahas kësaj, në një numër të rasteve të cilat mbesin të pazgjidhura, duket se gjyqtarët dhe prokurorët nuk janë duke çuar përpara në mënyrë të zellshme çështjen e vazhdimit të procedurave. Përfundimisht, sa i përket fazës së gjykimit, nuk janë vërejtur gjer më tani kurrfarë problemesh, me përjashtim të disa rasteve në të cilat gjykatat kanë shqiptuar dënime që bijnë nën minimumin e parashikuar me ligj pa ofruar kurrfarë arsytimi adekuat për një caktim të tillë të dënimeve në aktgjykim.

---

<sup>286</sup> Dënimi minimal për vepër penale të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm në vendin e tubimit të përgjithshëm është gjashtë muaj burg. Lexo nenin 291 (3) të KPP-së.

<sup>287</sup> Për vjedhje të rëndë parashihet dënimi minimal prej gjashtë muaj burg. Lexo nenin 253 (1) KPP-së.



## KREU 7

### E DREJTA PËR MBROJTJE EFEKTIVE

#### I. HYRJE

E drejta për mbrojtje efektive dhe e drejta për t'u përfaqësuar nga një avokat parashihet edhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.<sup>288</sup> Sa i përket këtyre të drejtave avokati mbrojtës ka për detyrë që të veprojë në interesin më të mirë të klientit të tij/saj. Në Kosovë, standardet ndërkombëtare parashihen edhe me ligjin vendës dhe Kodin e Kosovës për Etikën Profesionale të Juristëve.<sup>289</sup> Këto dispozita obligojnë avokatin mbrojtës të luajë një rol tejet aktiv gjatë tërë procedurës në mënyrë që të sigurojë që të drejtat dhe interesat e klientëve të tyre mbrohen në mënyrë të duhur.

Në bazë të kodit të ri të procedurës penale, roli i avokatit mbrojtës për nga natyra është më kundërshtues si palë në kontest dhe kërkon një qasje më proaktive, hollësishme kundrejt shqyrtimit të lëndës se që ka qenë në bazë të kodit të kaluar të procedurës penale. Në masë të madhe, këto zhvillime kërkojnë që avokati mbrojtës të jetë më kategorik, të mbajë kontakte të ngushta me klientin, të marrë veprime të hollësishme hetimore dhe të jap argumente specifike dhe mbështetëse duke i mundësuar të akuzuarit dhe avokatit të tij të përgatisin dhe prezantojnë mbrojtjen më të mirë të mundshme.

#### II. E DREJTA PËR MBROJTJE EFEKTIVE NË PRAKTIKË

Gjatë periudhës raportuese, OSBE-ja ka identifikuar një sërë rastesh kur e drejta për mbrojtje efektive e të akuzuarit është shkelur. Avokatët mbrojtës kanë dështuar në mënyrë rutinore që t'ju përmbahen procedurave të dizajnuara për të garantuar të drejtën e klientëve të tyre për gjykim të drejtë. Dështimet që i ka vërejtur OSBE-ja gjatë periudhës raportuese përbëjnë një mangësi të vazhdueshme të sistemit.

Çështjet më të zakonshme që shqetësojnë janë:

- Dështimi për të marrë pjesë në seancë;
- Dështimi për të kërkuar kohë për të përgatitur mbrojtjen;
- Dështimi për të kërkuar alternativa ndaj paraburgimit;
- Dështimi për të deklaruar rrethanën lehtësuese dhe për të kërkuar dënime alternative;
- Problemet në lidhje me sjelljen e avokatit mbrojtës *ex officio*.

---

<sup>288</sup> Nenet 14(3) PNDPC dhe 6(3) KEDNJ deklarojnë se çdo i akuzuar ka të drejtë të mbrojtë vetën personalisht apo nëpërmjet të përfaqësuesit ligjor të cilitin e zgjedh vet dhe në rastet kur interesi i drejtësisë kërkon që ky i akuzuar të ketë ndihmë juridike ajo ndihmë juridike duhet t'i ofrohet nga gjykata pa pagesë. Si pjesë e kësaj të drejte, i akuzuari gjithashtu ka të drejtë për kohë dhe mjete adekuate për përgatitjen e mbrojtjes së tij apo saj.

<sup>289</sup> Nenet 12 dhe 69-77 KPPP; nenet 11 dhe 67 -75 KPP RFJ-së; nenet 2(d) dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/28 mbi të drejtat e personave të arrestuar nga organet për zbatimin e ligjit. Vëreni se ligji mbi avokaturën Nr. 2004/40 është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 8 shtator 2004, dhe në kohën kur jemi duke e përpiluar kët raport ky ligj pret shpalljen e tij nga ana e PSSP-së.

## **A. Dështimi për të marrë pjesë (E drejta për t'u përfaqësuar nga avokati)**

Në bazë të legjislacionit vendës dhe ndërkombëtar, një i akuzuar ka të drejtë të caktojë avokatin e tij mbrojtës gjatë cilësdo fazë të procedurës.<sup>290</sup> Në bazë të ligjit të ri i akuzuari ka të drejtë për avokat mbrojtës gjatë tërë procedurës penale.<sup>291</sup> Ligji gjithashtu cek se policia, prokurori publik, gjyqtari i procedurës paraprake apo kryetari i trupit gjykues udhëzojnë të dyshuarin apo të pandehurin se ai apo ajo ka të drejtë për avokat dhe se avokati mund të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje të të akuzuarit.<sup>292</sup> Një një numër të rasteve të monitoruara nga OSBE-ja gjatë fazave të ndryshme të procedurës, avokati mbrojtës megjithatë nuk ka qenë i pranishëm gjatë procedurës që zhvillohej kundër klientit të tij. Dy shembuj janë paraqitur mëposhtë:

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Gjilan/Gnjilane që kishte të bëjë me akuza për posedim të paligjshëm të armëve, seanca ishte shtyer më 26 tetor 2004 për shkak të mungesës së avokatit mbrojtës. Gjykata kishte thirrur avokatin mbrojtës i cili kishte dështuar t'a informojë gjykatën se ishte në pushim vjetor.

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Gjilan/Gnjilane, që kishte të bëjë me akuzat për vjedhje me dhunë, plaçkitje dhe vjedhje të rëndë, OSBE-ja ka vërejtur një mungesë të përsëritur të avokatit mbrojtës. Avokatët mbrojtës në mënyrë konsistente kishin anashkalluar detyrat e tyre duke i'a bartur autorizimin për përfaqësim njëri tjetrit gjatë seancave të ndryshme gjyqësore. Për shembull, në disa raste një avokat mbrojtës i përfaqësonte prej tetë deri në nëntë të akuzuar. Një sjellje e tillë vazhdoi deri kur njëri nga avokatët mbrojtës, gjatë një seance gjyqësore të mbajtur më 14 maj 2003, u ankua se ai nuk mund të vazhdoi të zëvendësoi kolegët e tij. Të pandehurit deri në atë moment kishin duruar një mbrojtje jo të qëndrueshme dhe të përgatitur keq.

OSBE-ja është e mendimit se dështimi i avokatit mbrojtës të marrë pjesë gjatë seancave mund të rrezikojë seriozisht të drejtën e një personi për gjykim të drejtë. Avokatët mbrojtës nuk mund të mbrojnë në mënyrë efikase klientët e tyre nëse nuk marrin pjesë gjatë seancave hetimore dhe atyre të fazës së gjykimit. Në rastet kur avokati mbrojtës dështon të marrë pjesë në seanca, dëshmitë nga këndvështrimi i të akuzuarit mund të mos shqyrtohen në mënyrë të hollësishme, paqëndrueshmëritë në dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët e prokurorisë mund të shkojnë ashtu të pakundërshtuara nga pala tjetër dhe aspektet procedurale që ndërlidhen me lëndën, siç është kërkesa për dëgjimin e më shumë dëshmitarëve kur informatat e reja dalin në pah, mund të injorohen. Kur dëshmitë nuk testohen në mënyrë të duhur, dëshmitë shfajësuese mund të mos zbulohen fare dhe rrethanat lehtësuese të mos potencohen në mënyrë të duhur.

## **B. Dështimi për të kërkuar kohë për të përgatitur mbrojtjen**

Si ligji vendës ashtu edhe ai ndërkombëtar parashikojnë që të akuzuarit duhet t'i jepet kohë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij apo saj.<sup>293</sup> Përkundër kësaj të drejte tejet të qartë, OSBE-ja ka vërejtur shumë shpesh gjatë monitorimit të procedurave gjyqësore, dështimin e avokatit mbrojtës për të kërkuar kohë të mjaftueshme për të mundësuar një përgatitje të hollësishme të mbrojtjes. Për më tepër është vërejtur se shumë gjykatore nuk kanë një dhomë të ndarë për avokatin mbrojtës që të konsultohet privatisht me të pandehurin.

<sup>290</sup> Neni 6(3)(b) dhe (c) KEDNJ.

<sup>291</sup> Neni 69 KPPP.

<sup>292</sup> Neni 69(2) KPPP. Lexo gjithashtu Rregulloren e UNMIK-ut 2001/28 mbi të drejtat e personave të arrestuar nga organet për zbatimin e ligjit.

<sup>293</sup> Neni 12(1) KPPP dhe neni 6(3) KEDNJ.

Në gjykatën komunale në Gjilan/Gnjilane, tre persona ishin dënuar më 13 tetor 2003 për vepër penale të shkakimit të lëndimit të rëndë trupor. Dy nga të pandehurit nuk kishin avokat. Në fillim të seancës kryesore kryetari i trupit gjykues emëroi një avokat mbrojtës shtesë që të përfaqësojë dy të akuzuarit tjerë. Gjykimi vazhdoi menjëherë dhe avokati mbrojtës nuk kërkoi kohë për të përgatitur mbrojtjen e tij. Të gjithë të pandehurit u shpallën fajtor dhe kundër tyre u shqiptua dënimi me tre muaj burg për secilin.

Në një rast tjetër pranë gjykatës së qarkut në Gjilan/Gnjilane, ku një person u akuzua për vjedhje në nëntor 2003, avokati i caktuar nga gjykata lëshoi seancën vetëm disa minuta pas fillimit të saj duke deklaruar se ishte i angazhuar në një gjykim tjetër. Kryetari i trupit gjykues mëpastaj emëroi një avokat tjetër mbrojtës i cili nuk kërkoi kohë për të lexuar aktakuzën apo të konsultohet me të akuzuarin. Avokati nuk parashtroi kurrfarë pyetjesh për dëshmitarët gjatë gjykimit dhe e lëshoi seancën menjëherë pas dhënies së fjalimit përfundimtar duke mos pritur as përfundimin e gjykimit.

Në mënyrë që të mbrohet një person në mënyrë efikase, është me rëndësi thelbësore që avokatët mbrojtës të marrin udhëzime të detajuara nga klientët e tyre. Mu për këtë arsye e drejta për kohë adekuate për të përgatitur mbrojtjen parashihet edhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.<sup>294</sup> Avokati mbrojtës duhet të kërkojë në mënyrë aktive më shumë kohë për t'u konsultuar me klientët e tyre veçanërisht para mbajtjes së seancave gjyqësore.

Për më tepër, gjykata duhet të ofrojë më shumë hapësirë, madje edhe një dhomë të ndarë në gjykatore për të pandehurin në mënyrë që ai të konsultohet me avokatin e tij privatisht.

### **C. Dështimi për të kërkuar alternativa të paraburgimit**

OSBE-ja është e shqetësuar se avokatët mbrojtës në shumë raste nuk janë aktiv sa mjafton në mbrojtjen e të drejtave të klientëve të tyre. Një çështje në të cilën avokatët mbrojtës dështojnë rregullisht të veprojnë ka të bëjë me kundërshtimin efikas të propozimeve për paraburgim dhe sugjerimin e alternativave tjera të zbatueshme.

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Pejë/Peç një i akuzuar ishte i ngarkuar me akuzat si në vijim: pjesëmarrje në turmë në kryerjen e dhunës, pengimin e personit zyrtar në kryerjen e detyrave të tij, shantazh dhe posedim të paligjshëm të armëve. Gjatë seancës për caktimin e paraburgimit më 6 maj 2004, avokati mbrojtës kundërshtoi propozimin për paraburgim mirëpo nuk ofroi kurrfarë alternative të paraburgimit. Gjyqtari i procedurës paraprake urdhëroi paraburgimin për një muaj. Avokati paraqiti ankesë kundër këtij vendimi më 10 maj 2004, ku demonstroi gatishmëri për të paguar kaucionin.<sup>295</sup> Ankesa u hodh poshtë. Përkundër propozimit në përmbledhjen e ankesës, është e paqartë se përse avokati nuk kishte propozuar në mënyrë specifike ndonjë alternativë, siç është kaucioni gjatë seancës fillestare për caktimin e paraburgimit.

Në një seancë gjyqësore në gjykatën e qarkut në Gjilan/Gnjilane më 10 maj 2004, një avokat mbrojtës i caktuar privatisht bëri një parashtresë gojore për lirimin e klientit të tij. Arsyetimi i dhënë ishte paksa i pazakonshëm: Përpos garancave që priten zakonisht kur një i akuzuar kërkon lirimin, avokati mbrojtës në këtë rast sugjeroi se për shkak se dy

<sup>294</sup> Neni 14(3)(b) PNDPC dhe neni 6(3)(b) KEDNJ.

<sup>295</sup> Përmbledhja e ankesës theksonte "...për të dyshuarin ne kërkojmë që të mbrohet në liri. Në këtë drejtim, si garancë ne ofrojmë të gjitha kërkesat ligjore ashtu që i dyshuari të ketë mundësi të mbrohet në liri. Ne jemi të gatshëm të paguajmë kaucionin siç përcaktohet nga gjykata si një provë dhe garancë se i dyshuari do t'i përgjigjet thirrjeve të gjykatës." (përkthimi zyrtar).

klientët e tij janë vëllezër ndërmjet veti njëri mund të mbahet në paraburgim përderisa tjetri të lirohet. Aq sa OSBE-ja ka pasur mundësi të kuptojë, ai në paraburgim do të mbahet si “peng” dhe do të jetë garancë që vëllau tjetër do të paraqitet gjatë gjykimit. Kryetari i trupit gjykues refuzoi të përfshijë këtë parashtrësë absurde në procesverbal.

Kodi i ri i procedurës penale parashikon tetë mjete nëpërmjet të cilave mund të sigurohet prania e të auzuarit në gjykatë në mënyrë që procedura të zhvillohet në mënyrë të suksesshme. Shtatë nga to janë alternativa të paraburgimit; thirrja; urdhërarresti; premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin; ndalimi për t’iu afruar vendit ose personit të caktuar; paraqitja në stacionin policor; dorëzania; paraburgimi.<sup>296</sup> Duke nënvizuar të drejtën e të dyshuarve për liri në të gjitha rastet përpos në ato të jashtëzakonshme, OSBE-ja inkurajon që avokatët mbrojtës t’a kundërshtojnë sa më shumë në mënyrë aktive dhe proaktive paraburgimin. Në këtë drejtim, OSBE-ja mbështet programet shtesë trajnuese për të pasuruar shkathësitë mbrojtëse të avokatëve vendës dhe për të promovuar shfrytëzimin e spektrit të plotë të ligjit.

#### **D. Dështimi i deklarimit të rrethanës lehtësuese dhe kërkimi i dënimeve alternative**

Sa i përket fazës së fundit të procedurës penale, vendimit për caktimin e dënimit, dy probleme kryesore janë vërejtur: dështimi i avokatit për të prezentuar në mënyrë efektive faktorët relevant lehtësues dhe dështimi për të kërkuar alternativa ndaj dënimit me burg.

Në shumicën e rasteve të vëzhguara nga OSBE-ja, avokatët mbrojtës kanë tendencë të kufizojnë fjalimet e tyre përmblyllëse në çështjen e fajësisë apo pafajësisë, duke propozuar shumë rrallë metoda alternative të dënimit madje edhe në rastet e krimeve që nuk përfshijnë dhunë. Për më tepër, avokatët mbrojtës shpeshherë dështojnë të potencojnë rrethanat lehtësuese të cilat mund të bindin gjykatën të marrë parasysh dënime më të buta dhe alternative. Disa shembuj që ilustronë këtë problem shumë mirë janë paraqitur mëposhtë:

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Pejë/Peć, një i akuzuar që ishte i ngarkuar me vepër penale të shkaktimit të lëndimit të rëndë trupor që rezultoi në vdekje, pas një grindje ndërmjet të të akuzuarit dhe axhës së tij. Gjatë fjalimit përmblyllës avokati mbrojtës mbështeti faktin se gjykata duhet t’a lirojë të akuzuarin për shkak se ai ka vepruar në mbrojtje të domosdoshme dhe se duhet t’a shpall fajtor për ndonjë akuzë tjetër. Avokati mbrojtës ka dështuar të përmend rrethanat lehtësuese. Më 5 maj 2004 i akuzuari ishte shpallur fajtor dhe dënuar me 6 vjet burg.

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Prizren, një femër ishte shpallur fajtor për vrasjen e bashkëshortit të saj. Gruaja ishte shpallur fajtor për gjuajtjen me armë në burrin e saj pas shumë viteve që i kishte përjetuar si viktimë e dhunës familjare. Përkundër faktit se avokati mbrojtës i’u referohet këtyre rrethanave në fjalimin e tij përmblyllës, ai kishte dështuar të prezentojë rrethanat lehtësuese. Në vend të kësaj avokati mbrojtës deklaroi se i akuzuari duhet të lirohet për shkak se kishte vepruar në vetëmbrojtje. Më 21 maj 2004 gruaja në fjalë ishte dënuar me një dënim të unifikuar prej nëntë vjet e pesë muaj burg.

Dështimi i avokatëve mbrojtës në mbrojtjen efektive të interesave të klientëve të tyre mund të na shpiejë drejt një praktike jo të duhur të caktimit të dënimeve dhe nuk është në pajtim me të drejtën e të pandehurit për mbrojtje efektive. Duhet të përmendet se praktika e gjykatave për të përmendur në mënyrë rutinore rrethanat lehtësuese dhe rënduese pa ndonjë vlerësim dhe dështimi i tyre i përgjithshëm për të konsideruar masat alternative ndaj atij me burg mund të

---

<sup>296</sup> Nenet 268 – 281 KPPP.

diskurajojnë avokatin mbrojtës për të parashtruar propozime të tilla. Megjithatë, kjo nuk mund të përdoret si arsyetim nga ana e avokatëve mbrojtës për dështim në mbrojtjen e interesave të klientëve të tyre.

### **E. Problemet përkitazi me sjelljen e avokatit mbrojtës të caktuar *Ex Officio***

OSBE-ja ka vërejtur se problemet e vërejtura mëlartë janë veçanërisht të zakonshme në mesin e avokatit mbrojtës të caktuar nga gjykata. Shembujt e paraqitur mëposhtë ilustrojnë këtë vëzhgim:

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, një i mitur ishte akuzuar për trafikim të personave nën moshën 18 vjeçare dhe ndërmjetësim në ushtrimin e prostitucionit. Avokati mbrojtës ishte caktuar *sipas detyrës zyrtare* për të përfaqësuar të miturin. Avokati mbrojtës nuk morri pjesë në seancat dëgjimore për të cilat ishte thirrur me kohë nga gjykata, duke dhënë një arsyetim të varfër apo duke mos dhënë kurrfarë arsytimi fare përkitazi me mungesën e pranisë së tij në ato seanca; madje edhe në ato seanca në të cilat kishte marrë pjesë ai kishte dështuar që të marrë në pyetje dëshmitarët e propozuar nga prokuroria apo të propozojë dëshmitarë të mbrojtjes; pas dëgjimit avokati i kishte thënë OSBE-së se nuk ishte duke e kryer punën e tij si avokat mirëpo vetëm po merrte pjesë në ato seanca për shkak se është i caktuar *sipas detyrës zyrtare* dhe për shkak se nuk është duke u paguar për shërbimet e ofruara dhe se prindërit e të miturit nuk janë të interesuar t'a paguajnë; duke shtuar se kishte dijeni për 80% të shkresave të lëndës. Gjykata emëroi të njëjtin avokat mbrojtës për të përfaqësuar të miturin gjatë gjykimit i cili filloi në qershor 2003. OSBE-ja kishte vërejtur se avokati ishte ngjashëm pasiv edhe gjatë seancës kryesore përdërisa kontributi i tij kryesor ishte dhënia e fjalimit përmbyllës të shkurtë në përfundim të gjykimit. Të miturit i ishte shqiptuar masa edukuese-përmirësuese.

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica i akuzuari ishte paraburgosur më 7 gusht 2002 dhe ishte akuzuar me tentim vrasje dhe posedim të paligjshëm të armëve. Sipas kryetarit të trupit gjykues, avokati mbrojtës i caktuar nga gjykata i cili përfaqësoi të akuzuarin gjatë hetimeve refuzoi të përfaqësojë atë gjatë gjykimit për shkak se emërimi i tij *ex officio* do të thotë se ai nuk do të pranojë kompenzim financiar për të akuzuarin. Kryetari i trupit gjykues është dashur të emërojë një avokat tjetër për të përfaqësuar të pandehurin gjatë gjykimit i cili filloi më 23 prill 2003.

Avokatët mbrojtës shumë shpesh i kishin shprehur shqetësimet e tyre si gjykatave ashtu edhe OSBE-së për faktin se ishin të angazhuar në raste *sipas detyrës zyrtare* duke nënkuptuar me këtë apo duke deklaruar në mënyrë të sigurtë se kompenzimi i përcaktuar për shërbimet e tyre *ex officio* nuk është adekuat dhe se nuk kanë kurrfarë stimulimi për të punuar në rastet e tilla.<sup>297</sup> Sidoqoftë, duhet të përsëritet se avokatët mbrojtës kanë për obligim të mbrojnë

---

<sup>297</sup> Lexo Qarkoren e Drejtësisë 2001/21 kërkesat për pagesa/kompenzim për gjyqtarët porotë, avokatët e caktuar nga gjykata, ekspertët, përkthyesit, vlerësuesit e gjyqit dhe profesionistët e tjerë që marrin pjesë në procedurat gjyqësore dhe shtojcat e saj si dhe qarkorja e drejtësisë 2001/22 mbi kompenzimin e avokatëve mbrojtës të financiar nga fondet publike në pajtim me urdhëresën administrative UNMIK/DIR/2001/15, dhe shtojcat e saj. Në veçanti lexo Udhëzimin e DAGj-së mbi pagesat e avokatëve të caktuar nga gjykata, 31 janar 2000; në bazë të këtij udhëzimi dhe pas konvertimit zyrtar të markës gjermane në euro, avokati mbrojtës i caktuar nga gjykata pranon, për shembull, bazuar në ndëshkimin e pashmangshëm, prej 20,45 dhe 30,68 euro për orën e parë të paraqitjes së tij në gjykatë dhe përfaqësimit të të pandehurit në gjykatë. Çdo orë tjetër paguhet vetëm sa 30% e shumës së pagesës për orën fillestare. Shuma maksimale e pagesës së një avokati mbrojtës për përfaqësimet e tij *ex officio* gjatë një muaji është 255,65 euro.

klientët e tyre në mënyrën më të mirë të mundur pavarësisht tarifave të përcaktuara të kompenzimit.

### **III. REKOMANDIME**

OSBE-ja këshillon që:

- Avokatët mbrojtës duhet të marrin pjesë në të gjitha seancat dëgjimore në të cilat klienti i tyre kërkon avokat mbrojtës, nëse nuk mundën të marrin pjesë duhet të informojnë gjykatën me kohë;
- Avokatët mbrojtës duhet të sigurojnë se marrin udhëzime të qarta nga klientët e tyre dhe sipas nevojës duhet të kërkojnë kohë shtesë për t'u përgatitur për seanca.
- Avokatët mbrojtës duhet, sipas nevojës të nxisin gjykatën që të merr parasysh masat alternative ndaj paraburgimit;
- Avokatët mbrojtës duhet, sipas nevojës, të nxisin gjykatën që të marrë parasysh masat alternative ndaj dënimit me burg në rast të pruarjes së aktgjykimit dënues dhe të prezentojnë rrethanat gjegjëse lehtësuese;
- Avokatët mbrojtës duhet të veprojnë në interesin më të mirë të klientëve të tyre, pavarësisht se a angazhohen ata privatisht apo janë të caktuar nga gjykata;
- Oda e Avokatëve të Kosovës duhet të jetë e hapur për ankesa dhe duhet të marrë veprime disiplinore kundër anëtarëve të vet të cilët dështojnë të përmbushin detyrimet e tyre profesionale ndaj klientëve të tyre, veçanërisht ata avokat mbrojtës të cilët dështojnë të përfaqësojnë klientët e tyre pa justifikim të duhur.

Më tutje, OSBE-ja konsideron se, deri në një masë, problemet e përsëritura dhe të paraqitura më lartë mund të zbuten nëse anëtarëve të Odës së Avokatëve u jipet mbështetje më e madhe duke përfshirë çështjet si në vijim:

- Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm duhet të shpall ligjin mbi avokaturën sa më shpejtë ashtuqë arsimimi i vazhdueshëm ligjor të bëhet obligativ për avokatët mbrojtës.
- Oda e Avokatëve të Kosovës duhet të sigurojë që arsimimi i vazhdueshëm ligjor adreson çështjet e ngritura në këtë shqyrtim;
- Departamenti i Drejtësisë duhet të shpërndajë qarkoret e sapo nxjerra të drejtësisë Odës së Avokatëve të Kosovës në mënyrë që ajo t'ua shpërndajë ato anëtarëve të vet mëpastaj;
- Duhet të nxjerret një qarkore e drejtësisë me të cilën informohen gjykatat mbi detyrimet e tyre që të vënë në dispozicion të avokatëve mbrojtës vendimet dhe aktgjykimet e tyre me shkrim;
- Departamenti i Administratës Gjyqësore duhet të sigurojë që së paku një dhomë për këshillim të vihet në dispozicion për avokatin mbrojtës në secilën gjykatë; dhe,
- Departamenti për Administratën Gjyqësore duhet të rishqyrtojë sistemin e pagesave për avokatët e caktuar nga gjykata.

## KREU 8

### MBROJTJA E DËSHMITARËVE NË SISTEMIN E DREJTËSISË PENALE

#### I. HYRJE

Dëshmitarët janë me rëndësi thelbësore për të pasur një ndjekje penale të suksesshme. Nëse dëshmitarët frikësohen nga i akuzuari apo bashkëpjesëmarrësit e tij/saj, ata mund të frikësohen shumë për të ofruar dëshmi për ndjekjen; kërcënimet dhe dhuna kundër dëshmitarëve minojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor në tërësi përderisa dëshmitarët e rëndësishëm mund të refuzojnë që t’ju ndihmojnë autoriteteve për shkak të frikës nga dhuna. Përfundimisht, ndjekjet penale të mëdha mund të bijnë në ujë. Shqyrtimi i pestë nënvizoi shkallën e frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë. Më tutje, ky shqyrtim inkurajon autoritetet që të adresojnë problemet duke ofruar një sistem më efikas të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe nxjerr një sërë rekomandimesh në këtë drejtim.<sup>298</sup> Ky kapitull shqyrtton problemin e vazhdueshëm të frikësimit të dëshmitarëve dhe mangësitë në sistemin e mbrojtjes së dëshmitarëve.

#### II. SISTEMI I MBROJTJES SË DËSHMITARËVE

Si informatë vlen të ceket se dy metoda të ndërlidhura njëra me tjetrën për ofrimin e mbrojtjes së dëshmitarëve gjatë procedurës penale veç ekzistojnë në Kosovë. Së pari mbrojtja fizike e dëshmitarëve ofrohet para, gjatë dhe pas gjykimit nga një njësi policore e specializuar e njohur me emrin Njësia për Mbrojtjen e Dëshmitarëve (NjMD). Së dyti, masat për fshehjen e identitetit të dëshmitarëve gjatë dhënies së dëshmisë administrohen nga gjykatat në pajtim me kornizën ligjore. Rregullorja e UNMIK-ut 2001/20 mbi mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve gjatë procedurës penale e shtatorit 2001<sup>299</sup> (rregullorja për mbrojtjen e dëshmitarit) tani është inkorporuar në kodin e ri. Së bashku këto dy metoda kryesore të ofrimit të mbrojtjes mund të emërohen me termin “sistemi i mbrojtjes së dëshmitarëve.”

#### III. INCIDENTET E FRIKËSIMIT

Shumë probleme ende mbesin që nga publikimi i shqyrtimit të fundit të OSBE-së mbi sistemin e drejtësisë penale; dhe në bazë të shefit të operacionit Thor,<sup>300</sup> vështirësia më e madhe në zhvillimin e hetimeve për trazirat e marsit është frika e dëshmitarëve nga dhuna nëse dëshmojnë kundër kryesve të këtyre veprave.<sup>301</sup> Më tutje, kah fundi i vitit 2003 dhe fillimi i vitit 2004, kishim një numër të incidenteve të cilat për rrjedhojë kishin vdekjen dhe lëndimin e personave të cilët ishin të përfshirë në hetimin e rasteve të profilit të lartë. Sulmet kundër dëshmitarëve të fazës së gjykimit ende vazhdojnë.

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Gjilan/Gnjilane në gusht 2003, një dëshmitar dëshmoi se kishte gënjyer gjatë seancës së kaluar si rrjedhojë e kërcënimeve nga i akuzuari dhe miqtë e tij.<sup>302</sup>

<sup>298</sup> Shqyrtimi i pestë në faqet 26-27.

<sup>299</sup> Lexo gjithashtu Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/1 mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/20 mbi mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve në procedurën penale, e datës 24 janar 2002, e cila zgjaste zbatueshmërinë e përkohshme të Rregullores 2001/20; dhe Urdhëresës Administrative 2002/25 për implementimin e Rregullorës së UNMIK-ut 2001/20 mbi mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve gjatë procedurës penale, e datës 13 nëntor 2002.

<sup>300</sup> Për më tepër informata për Operacionin Thor shiko në faqen 70.

<sup>301</sup> Lexo Kreun 6 më lartë 6.

<sup>302</sup> Raporti javor i DD-së (07-14 gusht 2003).

Në një incident në tetor 2003, njëri nga dëshmitarët e gjykimit të grupit Dukagjini mbijetoi një tentim vrasje kundër tij nga një numër i personave të panjohur.<sup>303</sup> Ky dëshmitar është vendosur në “programin e mbrojtjes shtëpiake”, dhe është ruajtur nga njësia për mbrojtje speciale.

Në një gjykim për veprë penale të përdhunimit në gjykatën e qarkut në Prishtinë/Priština gjatë tetorit dhe nëntorit 2003, nëna e viktimës gjatë dhënies së dëshmisë deklaroi se një person i pranishëm në gjykatë (duke bërë me gisht kah avokati i të akuzuarit), erdhi në shtëpinë e saj në një rast të mëparshëm dhe e prezantoi vetën si një person nga gjykata e qarkut. Si duket avokati i kishte thënë viktimës të mos dëshmojë kundër të akuzuarit dhe të fal atë ashtuqë e bija e saj (viktima) të mund të martohet me vëllaun e të akuzuarit.

Gjatë një hetimi të një rasti për kidnapim dhe krim të organizuar në gjykatën e qarkut në Gjiilan/Gnjilane në tetor 2003, një dëshmitar dëshmoi se ishte i kërcënuar në 17 raste të ndara. Dëshmitari deklaroi se para se të dinte për thirrjen që gjyqi do të duhet t’ja dërgonte, personi i cili e kishte kërcënuar i’ka kishte treguar atij listën e personave të cilët gjykata pretendonte t’i thërras. Gjyqtari hetues i rastit mohoi se lista i ishte dhënë dikujt tjetër përpos avokatit të cilit i është urdhëruar në mënyrë të qartë që të zbulojë detajet dikujt tjetër.

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Pejë/Peć, pala e dëmtuar, e cila e kishte denoncuar të akuzuarin e akuzuar për veprë penale të terrorizmit i cili ishte përpjekur që të nxjerr para nga ai dhe të kërcënojë biznesin e tij, kishte përjetuar një sërë kërcënimesh / sulmesh, siç është hudoja e granatës në lokalit e palës së dëmtuar dhe gjuajtja me armë në palën e dëmtuar menjëherë pas shpalljes së aktgjykimit më 20 gusht 2004. Kjo është bërë pavarësisht nga fakti se kishte marrëveshje për deklarimin e fajësisë të lidhur ndërmjet ndjekjes penale dhe mbrojtjes me pëlqimin e palës së dëmtuar.

Në një rast tjetër pranë gjykatës së qarkut në Pejë/Peć më 24 gusht 2004, që kishte të bëjë me një veprë penale të kidnapimit të kryer në bashkëpjesëmarrje, akuzat ishin zvogëluar në pajtim me marrëveshjen nëpërmjet të së cilës i akuzuari kishte dhënë pëlqimin të deklarohet fajtor për veprë penale të privimit të paligjshëm nga liria të personit tjetër. Në këtë rast, prokurori kishte për qëllim të mbrojtje palën e dëmtuar dhe familjen e tij nga frikësimet e mëtutjeshme nga ana e grupit të përfshirë në kryerjen e këtyre veprave penale (ku disa anëtarë të këtij grupi janë ende në liri), duke arritur kompromis ndërmjet palëve nëpërmjet të marrëveshjes për deklarimin e fajësisë. Megjithatë edhe njëherë këto qëllime ishin tejet frustruese për shkak se përkundër përfitimeve që ajo marrëveshje i sillte të akuzuarit, familja e palës së dëmtuar vazhdonte të kërcënohej vazhdimisht si rrjedhojë e shpalljes fajtor të të akuzuarit.

Në shtator 2004, njëri nga dëshmitarët e gjykimit të grupit Llapi ishte sulmuar nga një person i armatosur në prag të shtëpisë së tij në Prishtinë/Priština.<sup>304</sup> Dëshmitari morri lëndime gjatë këtij sulmi.

Është me rëndësi të ceket se incidentet e frikësimit të dëshmitarëve të monitoruara nga OSBE-ja paraqesin vetëm një pjesë të rasteve aktuale. Dëshmitarët të cilët janë kërcënuar shpeshherë janë tejet të frikësuar që të raportojnë çështjen në polici. Mëtutjue, për nga natyra e vet, efekti i

<sup>303</sup> Ky ishte një gjykim i njohur si gjykimi i grupit Dukagjini që përfshinte disa ish pjesëtarë të rangut të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilët ishin akuzuar dhe shpallur fajtor për parburgim të paligjshëm të personave që kishte rezultuar me vdekjen e tyre.

<sup>304</sup> Ky ishte një gjykim i njohur si gjykimi i grupit Llapi që përfshinte disa ish pjesëtarë të rangut të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilët ishin akuzuar dhe shpallur fajtor për krime të luftës.



plotë i frikës së publikut nga frikësimi i mundshëm nuk mund të matet; është e pamundshme të dihet se sa dëshmitarë të mundshëm zgjedhin që të mos raportojnë atë çka dijnë në polici për shkak të frikës nga ndëshkimi (hakmarrja).

#### **IV. TË METAT E SISTEMIT PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE**

Duket se NjMD-ja vazhdon të përballet me vështirësi të mëdha logjistike dhe financiare.<sup>305</sup> Hapësira në shtëpinë e sigurtë është e kufizuar dhe kjo gjë ka rezultuar në refuzimin e disa dëshmitarëve të cilët kishin nevojë për mbrojtje që të vendosen në atë strehimore. Në shqyrtimin e pestë, OSBE-ja rekomandoi se policia e UNMIK-ut dhe shtylla e drejtësisë duhet t'i ofrojnë NjMD-së resurset e nevojshme financiare për të krijuar një program më të zgjeruar të mbrojtjes së dëshmitarit për një numër më të madh të dëshmitarëve. Resurset e tilla ende kërkohen.

Edhe pse gjykatat kanë pushtet të gjerë për të fshehur identitetin e dëshmitarëve, ato shfrytëzohen shumë rrallë në praktikë përkundër një sërë incidenteve të frikësimit. Arsyeja për shfrytëzimin e rrallë të tyre qëndron në mungesën e mirëprirjes së mundësisë së shfrytëzimit të masave mbrojtëse në mesin e policisë, prokurorëve dhe gjykatave, e cila dyfishohet edhe me mungesën e pajisjeve teknike në gjykata. Në rast të paraqitjes së frikësimit të dëshmitarëve është me rëndësi thelbësore që këta dëshmitarë të pranojnë mbrojtjen e duhur sa i përket fshehjes së identitetit që në fazat e hershme të procedurës. Për këtë arsye OSBE-ja në shqyrtimin e pestë të vet rekomandoi që gjykata apo prokurori, në mundësinë e parë të mundshme të informojnë dëshmitarët që mund të jenë të kërcënuar, për masat për mbrojtjen e dëshmitarit që janë në dispozicion të tyre në bazë të rregullores për mbrojtjen e dëshmitarit. Duket se kjo ende nuk është duke ndodhur.

Edhe me një sistem efektiv të mbrojtjes së dëshmitarëve është me rëndësi të bindet publiku. Frikësimet dhe vrasjet shkaktojnë një frikë mjaft të madhe të një pjesë e madhe e publikut se edhe ata do të frikësohen nëse japin deklarata policisë apo nëse dëshmojnë në gjyq. Kjo veçanërisht është e vërtetë në rastet e profilit të lartë. Do të nevojiten mjaft përpjekje për të rikthyer besimin e publikut se autoritetet janë të afta t'i mbrojnë ata. Për këtë arsye, OSBE-ja rekomandoi të lansohet një fushatë e informimit publik për të risiguruar publikun se ekzistojnë mjete nëpërmjet të cilave autoritetet mund të mbrojnë dëshmitarët në Kosovë. Gjer më tani nuk ka ndodhur një fushatë e tillë.

#### **V. ZHVILLIMET POZITIVE QË NGA SHQYRTIMI I PESTË**

Në raportin e kaluar OSBE-ja ka bërë një sërë rekomandimesh mbi atë se si duhet të përmirësohet sistemi për mbrojtjen e dëshmitarit. Ato përfshijnë masat siç janë trajnimi shtesë dhe udëzimet për praktikantët dhe policinë, fondet shtesë dhe mbështetja për NjMD-në dhe shoshitja efikase e oficerëve policor që konsiderohen për poste në kuadër të njëjësive për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve. Zhvillimet e paraqitura në vazhdim janë implementuar.

Departamenti i Drejtësisë lëshoi një qarkore të drejtësisë 2003/5 mbi programet për mbrojtjen e dëshmitarit, të cilat sqarojnë procedurën që duhet të ndjeket nga NjMD-ja sa i përket Programit për Mbrojtjen e Dëshmitarit. Qarkorja përshkruan detyrat dhe detyrimet e NjMD-së dhe cek se NjMD-ja mund të miratojë një alternativë sa i përket regjistrimit në kuadër të programit me iniciativë të prokurorit apo gjyqtarit. Qarkorja përcakton një marrëdhënie të strukturuar dhe koordinuar ndërmjet NjMD-së, prokurorëve dhe gjykatave dhe mirëpritet nga OSBE-ja si një mjet për lehtësimin e disa nga paqartësitë paraprake dhe paqëndrueshmërive procedurale.

<sup>305</sup> Intervista me NjMD-në, 6 shtator 2004.

Për më tepër, OSBE-ja kishte identifikuar rastet e trafikimit me njerëz si veçanërisht sensitive sa i përket ndërhyrjes së viktimave dhe dëshmitarëve.<sup>306</sup> Megjithatë, që nga publikimi i shqyrtimit të pestë, policia e UNMIK-ut dhe shtylla e drejtësisë hapën një strehimore për viktimat e trafikimit.<sup>307</sup> Nëpërmjet të kësaj strehimore, të hapur në qershor 2003, UNMIK-u është në gjendje të ofrojë siguri, anonimitet dhe një spektër të gjerë të shërbimeve përkrahëse për viktimat e trafikimit. Jo vetëm kjo që do të shkojë në dobi të viktimave mirëpo ky objekt do të ndihmojë në qasjen e gjykatave në viktimat dhe do të kontribuojë në rikthimin e besimit në sistemin e drejtësisë si nga ana e viktimave ashtu edhe nga vetë publiku.

Përfundimisht, më 17 dhe 18 tetor 2003, si përgjigje e rekomandimeve të dala nga raporti i OSBE-së, Instituti Gjyqësor i Kosovës mbajti një seminar mbi terrorizmin, krimin e organizuar dhe mbrojtjen e dëshmitarëve. Përafërisht rreth 30 gjyqtarë dhe prokurorë si të vendit ashtu edhe ndërkombëtar morrën pjesë në këtë seminar. Trajnimi ishte organizuar në bashkëpunim me DD-në, Tribunalin Ndërkombëtar Penal për Ish Jugosllavinë (ICTY). Trajnimi ishte kombinim i ligjërimit, diskutimit dhe rasteve të studimit. Ky trajnim ishte mirëpritur dhe duhet të përsëritet rregullisht për të përfshirë më shumë gjyqtarë dhe prokurorë vendës si dhe gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtar të sapoardhur.

Megjithatë, shumica e rekomandimeve të sugjeruara në shqyrtimin e pestë ende nuk janë implementuar nga organet relevante dhe së këndejmi edhe njëherë janë përsëritur mëposhtë:

## **VI. REKOMANDIMET**

- Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm duhet të nxjerrë një urdhëresë administrative për të futur në fuqi obligimin e detyrueshëm të gjykatës dhe prokurorit, që në mundësinë e parë të informojë cilindo dëshmitar i cili mund të jetë i kanosur, për mundësinë e masave për mbrojtjen e dëshmitarit që janë në dispozicion në bazë të kodeve të reja.
- Policia e UNMIK-ut dhe shtylla e drejtësisë duhet t'i sigurojnë njësisë për mbrojtjen e dëshmitarit resurse më të mëdha financiare ashtu që ky njësit të jetë në gjendje të realizojë programe më të gjera për mbrojtjen e dëshmitarit që do të mbulonin një numër më të madh të dëshmitarëve.
- Policia e UNMIK-ut dhe shtylla e drejtësisë duhet të vazhdojnë me përpjekjet e shtuara për identifikimin e vendeve që shprehin dëshirë të pranojnë dëshmitarët e mbrojtur të cilët kërkojnë vendosje në një vend tjetër jashtë Kosovës, dhe të arrijnë marrëveshje.
- Policia e UNMIK-ut dhe shtylla e drejtësisë duhet t'i ofrojë gjykatave të qarkut mjete praktike dhe teknologjike për fshehjen e dëshmitarëve, siç janë ekranet, pajisjet për ndryshimin e zërit, televizionin e qarkut të mbyllur apo pajisjet tjera video.
- Ligji duhet të ndryshohet për të parashikuar në mënyrë shprehimore se është vepër penale shkelja e urdhërit për masa mbrojtëse, apo zbulimi i informatave të fshehta nga një zyrtar i cili punon në lidhje me masat mbrojtëse. Dënime të rrepta duhet t'ju shqiptohen zyrtarëve dhe praktikantëve gjyqësor të cilët nuk përfillin këto rregulla.

---

<sup>306</sup> Ndjekja penale e një numri të trafikuesve me qenie njerëzore është vështirësuar për shkak të mungesës së bashkëpunimit nga ana e vetë viktimave dhe dëshmitarëve të krimit për shkak të frikësimit që trafikuesit u'a bëjnë atyre. Në një numër të rasteve, ku frikësimi serioz është i dukshëm, viktimat ishin riadhesuar menjëherë para përfundimit të procedurave gjyqësore duke qenë jashtë brezit të arritjes nga ana e policisë dhe gjykatave vendëse.

<sup>307</sup> Strehimorja ishte themeluar me ndihmën financiare nga OSBE përmes një donacioni vullnetar dhënë OSBE nga qeveria e SHBA, dhe donacioneve nga individët dhe organizatat në Kosovë.

- Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe Qendra Burimore për Mbrojtje Penalo-Juridike në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës duhet të vazhdojnë të ofrojnë trajnime për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët mbi rolin dhe veprimin e njësisë për mbrojtjen e dëshmitarit dhe shfrytëzimi i masave mbrojtëse në gjykatë.
- Policia e UNMIK-ut dhe shtylla e drejtësisë duhet të lansojnë një fushatë informative publike për të siguruar publikun se ka mjete nëpërmjet të cilave autoritetet mund të mbrojnë dëshmitarët në Kosovë.
- Në vazhden e bartjes së kompetencave nga policia e UNMIK-ut në Shërbimin Policor të Kosovës, duhet të vendoset një procedurë e hollësishme e shoshitjes për zgjedhjen e oficerëve të Shërbimit Policor të Kosovës në kuadër të njësisë për mbrojtjen e dëshmitarit.
- Policia duhet të fillojë të ofrojë informata dëshmitarëve mbi sistemin e mbrojtjes së dëshmitarit në Kosovë, në mënyrë sa më reale dhe të ndershme, menjëherë posa ata të kenë raportuar krimin në polici.

## KREU 9

### ZHVILLIMET E RËNDËSISHME NË SISTEMIN JURIDIK

#### I. DISPOZITAT LIGJORE

Që nga shqyrtimi i fundit i OSBE-së për sistemin e drejtësisë penale, janë bërë disa zhvillime të rëndësishme sa i përket dispozitave të reja, sidomos nxjerrja e ligjeve të reja penale. Këto zhvillime janë numëruar mëposhtë:

#### II. RREGULLORET

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/12 mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje, e hyrë në fuqi më 9 maj 2003.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/25 mbi Kodin e përkohshëm penal të Kosovës, e shpallur më 6 korrik 2003. Kodi hyri në fuqi më 6 prill 2004.<sup>308</sup>

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/26 mbi Kodin e përkohshëm të procedurës penale të Kosovës, e shpallur më 6 korrik 2003. Kodi hyri në fuqi më 6 prill 2004.<sup>309</sup>

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/34 mbi ndryshimin e ligjit në fuqi mbi procedurën për dorëzimin e banorëve të Kosovës në shtetet e huaja, e hyrë në fuqi më 14 nëntor 2003.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/36 mbi ndryshimin e Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2000/64, mbi caktimin e gjyqtarëve/prokurorëve ndërkombëtar dhe/apo ndryshimi i vendit të gjykimit, e hyrë në fuqi më 14 dhjetor 2003.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/2 mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale, e hyrë në fuqi më 5 shkurt 2004.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/8 mbi ligjin penal për të mitur, e hyrë në fuqi më 20 prill 2004.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/10 mbi ndryshimin e Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2004/2 mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale, e hyrë në fuqi më 29 prill 2004.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/19 mbi ndryshimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës, e hyrë në fuqi më 16 qershor 2004.

Rregullorja e UNMIK-ut 2004/29 mbi mbrojtjen nga rrëmbimi ndërkombëtar i fëmijëve, e hyrë në fuqi më 5 gusht 2004.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/34 mbi procedurën penale kundër kryesve të veprave penale me çrregullime mentale, e hyrë në fuqi më 24 gusht 2004.

---

<sup>308</sup> Neni 357 i KPP-së.

<sup>309</sup> Neni 557 i KPPP-së.

### **III. URDHËRESAT ADMINISTRATIVE**

Urdhëresa administrative Nr. 2003/9 zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/12 për ndalimin e terrorizmit dhe krimeve të tjera të ngjashme, e hyrë në fuqi më 17 prill 2003.

Urdhëresa administrative Nr. 2003/16 zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24 mbi ligjin e zbatueshëm në Kosovë, e hyrë në fuqi më 24 korrik 2003.

Urdhëresa administrative Nr. 2003/18 mbi ndryshimin e Urdhëresës administrative Nr. 2001/15 mbi zbatimin e Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2001/10 për ndalimin e kalimit të paautorizuar të kufirit shtetëror/administrativ, e hyrë në fuqi më 30 korrik 2003.

Urdhëresa administrative Nr. 2003/31 mbi zbatimin e Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2001/8 për themelimin e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës, shpallur më 30 dhjetor 2003.

### **IV. LIGJET E KUVENDIT TË KOSOVËS**

Ligji mbi shëndetësinë Nr. 2004/4, i miratuar nga kuvendi më 19 shkurt 2004, i shpallur nëpërmjet të Rregullores së UNMIK-ut 2004/31, i hyrë në fuqi më 20 gusht 2004.

Ligji mbi bashkëpunimin me tribunalin e Hagës, miratuar nga kuvendi më 19 shkurt 2004, në pritje të shpalljes nga ana e PSSP-së.

Ligji kundër korrupsionit Nr. 2004/34, i miratuar nga kuvendi më 8 shtator 2004, në pritje të shpalljes nga ana e PSSP-së.

Ligji mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve nën kujdes shëndetësor Nr. 2004/38, i miratuar nga kuvendi më 8 shtator 2004, në pritje të shpalljes nga ana e PSSP-së.

Ligji mbi avokaturën Nr. 2004/40, i miratuar nga kuvendi më 8 shtator 2004, në pritje të shpalljes nga ana e PSSP-së.